




2024

# VLERËSIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM NË SHQIPËRI

NXITËSIT, FORMAT DHE RREZIQET





**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania



Institute  
for Democracy  
and Mediation

Ky studim u përgatit në kuadër të projektit: “Forcimi i qëndresës në komunitet nëpërmjet modelit Shkolla Qendër Komunitare (SHQK) dhe hulumtimit të bazuar në evidencë në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Zyrës së Çështjeve Publike të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë. Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në të janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit të Shteteve të Bashkuara.

**Autorë:**

Sara Kelmendi  
Romario Shehu

**Dizajni dhe faqosja:**


Eduart Cani

# Tabela e përmbajtjes

<b>1. Gjetjet kryesore</b>	<b>8</b>
Nxitësit social-ekonomikë	8
Nxitësit politikë	8
Nxitësit kulturorë	9
Tendencat e reja të ekstremizmit të dhunshëm	9
<b>2. Hyrje</b>	<b>11</b>
<b>3. Metodologjia</b>	<b>14</b>
<b>4. Profili i të anketuarve</b>	<b>16</b>
Demografia e kampionit	16
Përkatësia dhe praktikat fetare	19
<b>5. Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri</b>	<b>24</b>
5.1 Nxitësit social-ekonomikë	24
5.2 Nxitësit politikë	44
5.3 Nxitësit kulturorë	71
<b>6. Tendencat e reja të ekstremizmit të dhunshëm: tendencat politike dhe etno-nacionaliste në Shqipëri</b>	<b>87</b>
<b>7. Përfundime dhe rekomandime</b>	<b>107</b>
<b>8. Shtojcat</b>	<b>111</b>
8.1 Shpërndarja e kampionit të sondazhit	111
8.2 Instrumenti i pyetësorit	112

## Lista e grafikëve

Grafiku 1: Përbërja gjinore e të anketuarve (N=1600)	16
Grafiku 2: Moshja e të anketuarve (N=1600)	17
Grafiku 3: Niveli arsimor i të anketuarve (N=1600)	17
Grafiku 4: Statusi i punësimit i të anketuarve (N=1600)	18
Grafiku 5: Mbështetja për partitë politike nga të anketuarit	19
Grafiku 6: Përkatësia fetare e të anketuarve	19
Grafiku 7: Origjina fetare e të anketuarve	20
Grafiku 8: Praktikimi i riteve fetare nga të anketuarit (N=1600)	21
Grafiku 9: Praktikimi i lutjes/faljes tek të anketuarit (N=1600)	22
Grafiku 10: Mbështetja e të anketuarve për martesën ndërfaqetare të një anëtari të familjes (N=1600)	23
Grafiku 11. Mbështetja për pohimin se mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumarit, alkoolit, drogës etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (N=1600)	27
Grafiku 12. Përqindja e të anketuarve të shqetësuar mbi ekstremizmin politik/ etno-nacionalist/fetar në Shqipëri (N=1600) dhe të anketuarit që janë dakord se ka individë/grupe që nxisin ekstremizmin politik/etno-nacionalist/fetar në zonën ku ata banojnë (N=1600).	29
Grafiku 13. Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social (N=1600)	32
Grafiku 14. Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë (N=1600)	33
Grafiku 15. Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore. (N=1600)	34
Grafiku 16. Në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune. (N=1600)	36
Grafiku 17. Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme. (N=1600)	37
Grafiku 18. Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime. (N=1600)	39
Grafiku 19. Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre. (N=1600)	40
Grafiku 20. Mbështetja për justifikimin e çdo aktiviteti ekonomik, përfshirë atë të paligjshëm dhe se pasurimi i shpejtë nuk është gabim. (N=1600)	42
Grafiku 21. Të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore (N=1600)	47
Grafiku 22. Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja (N=1600)	48
Grafiku 23. Institucionet ligjzbatuese janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë (N=1600)	49



Grafiku 24. Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore (N=1600)	50
Grafiku 25. Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura nuk duhet lejuar. (N=1600)	51
Grafiku 26. Përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët. (N=1600)	52
Grafiku 27. Çdo qytetar duhet të mbrojë ideologjinë e tij/saj me çdo mjet dhe çmim. (N=1600)	53
Grafiku 28. Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht. (N=1600)	54
Grafiku 29. Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime, në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi. (N=1600)	56
Grafiku 30. Vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara. (N=1600)	57
Grafiku 31. Pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi. (N=1600)	58
Grafiku 32. Prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët (N=1600)	59
Grafiku 33. Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti. (N=1600)	60
Grafiku 34. Aktorë qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike. (N=1600)	62
Grafiku 35. Disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe u shërbejnë interesave të njëri-tjetrit. (N=1600)	63
Grafiku 36. Opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje. (N=1600)	63
Grafiku 37. Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare. (N=1600)	65
Grafiku 38. Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame. (N=1600)	67
Grafiku 39. Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare. (N=1600)	68
Grafiku 40. Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut). (N=1600)	68
Grafiku 41. SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut). (N=1600)	69
Grafiku 42: Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman (N=1600) përkundër besimtar praktikat i krishterë (N=1600)	74
Grafiku 43: Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator. (N=1600)	76
Grafiku 44: Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm. (N=1600)	76
Grafiku 45: Shqetësimi për ekstremizmin fetar në Shqipëri (N=1600)	78



Grafiku 46: Në zonën ku banoj ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar. (N=1600)	79
Grafiku 47: Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku banoj. (N=1600)	83
Grafiku 48. Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët. (N=1600)	83
Grafiku 49. Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare. (N=1600)	84
Grafiku 50: Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar. (N=1600)	85
Grafiku 51. Shqetësimet për ekstremizmin politik përkundër ekstremizmin etno-nacionalist (N=1600)	89
Grafiku 52. Në zonën ku unë banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin politik. (N=1600)	92
Grafiku 53. Në zonën ku unë banoj, votimi për partinë në pushtet është i domosdoshëm për të mbajtur një vend pune në administratën publike. (N=1600)	95
Grafiku 54. Në zonën ku unë banoj ka politikanë që shprehimisht bëjnë thirrje për dhunë ndaj kundërshtarëve politike. (N=1600)	95
Grafiku 55. Disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe u shërbejnë interesave të njëri-tjetrit. (N=1600)	96
Grafiku 56. Pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi. (N=1600)	97
Grafiku 57. Opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje (N=1600)	97
Grafiku 58. Aktorë qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike (N=1600)	98
Grafiku 59. Në zonën ku banoj, nepotizmi po e bën të vështirë gjetjen e mundësive të mira të punës. (N=1600)	99
Grafiku 60. Në zonën ku unë banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin etno-nacionalist. (N=1600)	100
Grafiku 61. Përqindja e të anketuarve që do të mbështesnin një anëtar të familjes po të martohej me një person të një përkatësie tjetër etnike (N=1600)	102
Grafiku 62. Ka një komplot të madh për të shpopulluar Shqipërinë dhe për të zëvendësuar qytetarët e saj me emigrantë të huaj. (N=1600)	102
Grafiku 63. Shqiptarët nuk duhet të përzihen me raca të tjera. (N=1600)	103
Grafiku 64. Në zonën ku unë banoj, të jesh minoritar sjell përfitime të shumta sociale dhe ekonomike. (N=1600)	104
Grafiku 65. Forma të tjera të diskriminimit apo gjuhës së urrejtjes kundër një individi (N=1600)	104



## Lista e tabelave

Tabela 1. Matrica e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM 2015, 2018, 2021	14
Tabela 2: Nxitësit social-ekonomikë	24
Tabela 3: Nxitësit politikë sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018, 2021	44
Tabela 4: Nxitësit kulturorë sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018, 2021	72
Tabela 5. Përqindja e të anketuarve që i përshkruajnë veprimet si ekstremizëm të dhunshëm (N=1600)	90
Tabela 6. Përqindja e të anketuarve që tregojnë për pasojat më shqetësues të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri (N=1600)	91
Tabela 7. Sjellje, veprime apo qëndrime të raportuara si ekstremizëm politik (N=242)	93
Tabela 8. Format e diskriminimit që kanë parë të anketuarit (N=114)	106



# 1. Gjetjet kryesore

- 📈 43.4% e të anketuarve janë dakord se ekstremizmi politik në Shqipëri është shqetësues.
- 📉 16.3% raportojnë se ka individë apo grupe që nxisin ekstremizmin politik, në zonën ku ata banojnë.
- 📉 30.6% e të anketuarve shprehen të shqetësuar për ekstremizmin fetar në Shqipëri.
- 📉 6.6% raportojnë se në zonën ku ata banojnë, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar.
- 📈 27% e të anketuarve janë të shqetësuar për ekstremizmin etno-nacionalist në Shqipëri.
- 📉 3.5% raportojnë se në zonën ku banojnë ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin etno-nacionalist.

## Nxitësit social-ekonomikë

- 📉 70.5% besojnë se shumë të rinj kanë rënë pre e veseve dhe/ose sjelljeve të rrezikshme në zonën ku banojnë.
- 📉 36.9% e konsiderojnë komunitetin e tyre fetar si të përfaqësuar mirë në politikë dhe në institucione shtetërore.
- 📉 50.3% besojnë se në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banojnë kanë siguruar vende të mira pune.
- 📉 43.5% i vënë gishtin pranisë së grupeve fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre në zonën ku banojnë.
- 📉 30.7% mendojnë se pasurimi i shpejtë nuk është i gabuar, pavarësisht se si arrihet ai.

## Nxitësit politikë

- 📈 46.3% e shohin sistemin politik në Shqipëri si të padrejtë dhe janë dakord se duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja.
- 📈 41.2% besojnë se njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore.
- 📉 64.6% janë dakord se përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit nuk duhet lejuar.
- 📉 26.4% bien dakord se është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo mjet dhe çmim.
- 🟡 40.9% besojnë se pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi.
- 📉 28.5% janë dakord se aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti.





↑ 13.6% janë dakord se një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare.

↓ 36.2% mendojnë se vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare.

## Nxitësit kulturorë

↓ 11.6% janë të mendimit se sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman.

↓ 14.9% mendojnë se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar në përgjithësi janë nën kërcënim të vazhdueshëm.

↓ 40.5% perceptojnë se njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare.

## Tendencat e reja të ekstremizmit të dhunshëm

■ 29.2% raportojnë se në zonën ku ata banojnë, ka politikanë që shprehimisht bëjnë thirrje për dhunë ndaj kundërshtarëve politikë.

■ 74% janë dakord se disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe u shërbejnë interesave të njëri-tjetrit.

■ 25.5% besojnë se opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për qeverisje më të mirë.

■ 76.5% i perceptojnë aktorët qeverisës në Shqipëri si keqpërdorues të institucioneve dhe burimeve shtetërore për interesa të ngushta politike.

■ 68% e konsiderojnë nepotizmin si pengesë për gjetjen e mundësive të mira të punës në zonën ku banojnë.

■ 38.9% besojnë se ka një komplot të madh për të shpopulluar Shqipërinë dhe për të zëvendësuar qytetarët e saj me emigrantë të huaj.

■ 38% mendojnë se shqiptarët nuk duhet të përzihen me raca të tjera.

■ 21.7% besojnë se në zonën ku ata banojnë, të qenurit minoritar sjell përfitime të shumta sociale dhe ekonomike.

## Legjenda

% Të gjitha përqindjet i referohen përgjigjeve të grupuara për opsionet 'dakord' ose 'plotësisht dakord'.

↓ I referohet pohimeve për të cilat ka pasur një rënie në pikë përqindje krahasuar me vlerësimin e vitit 2021.

↑ I referohet pohimeve për të cilat ka pasur një rritje në pikë përqindje krahasuar me vlerësimin e vitit 2021.

■ I referohet pyetjeve që ose janë rishikuar nga viti 2021 ose janë pyetje të reja që bëhen për herë të parë në këtë sondazh.





## 2. Hyrje

Ky është vlerësimi i katërt kombëtar i ekstremizmit të dhunshëm që kryhet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në dhjetëvjeçarin e fundit. Vlerësimi i parë, “Radikalizmi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri”<sup>1</sup> (2015), shqyrton radikalizimin fetar dhe ekstremizmin e dhunshëm në vend me qëllim informimin e politikëbërjes dhe aktorëve të tjerë kryesorë për trajtimin e këtij fenomeni. Vlerësimi i vitit 2015, i cili ndihmoi në hartimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planin e tij të Veprimit, bëri të mundur të kuptohen faktorët apo “nxitësit” përkatës që çojnë në radikalizim dhe dhe hodhi dritë mbi nivelin e mbështetjes për ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri. Vlerësimi i dytë, “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”<sup>2</sup> (2018), edhe pse sërish u fokusua tek ekstremizmi fetar, i siguroi institucioneve shtetërore dhe komunitetit të parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm (P/KEDH) një studim më të gjerë që trajton perceptimet, qëndrimet dhe përvojat personale të shqiptarëve në lidhje me nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm. Në vlerësimin e vitit 2018 theksohej një potencial në rritje për format e tjera jofetare të ekstremizmit në vend. Në vlerësimin e tretë, “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”<sup>3</sup> (2021), analizohet gjendja pas gjashtë vitesh veprimtarie P/KEDH në Shqipëri dhe rëndësinë relative të nxitësve dhe faktorëve të tjerë përkatës që ushqejnë ose mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm. Vlerësimi i vitit 2021 i siguroi aktorëve të P/KEDH-së njohuri që ndihmojnë në hartimin e politikave të parandalimit, programeve të shkëputjes (nga ekstremizmi i dhunshëm), masat institucionale dhe kapacitetet e aktorëve kryesorë për rehabilitimin dhe riintegrimin e të kthyerve dhe viktimave të mundshme të ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm. Në vlerësimin e 2021 u konfirmua një rritje e formave jofetare të ekstremizmit të dhunshëm në vend. Më pas kjo tendencë u njoh dhe u përfshi edhe në strategjinë e re kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit të Shqipërisë për vitet 2023–2025.<sup>4</sup>

Që nga vlerësimi i mëparshëm i IDM-së i vitit 2021, qeveria shqiptare ka bërë disa ndryshime në fushën e P/KEDH-së. Në shkurt të vitit 2023, qeveria miratoi një strategji të re ndërsektoriale për vitet 2023–2025 dhe dy plane veprimi për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe për luftën kundër terrorizmit.<sup>5</sup> Kjo strategji e re integron si ekstremizmin e dhunshëm ashtu edhe terrorizmin për herë të parë në një strategji të unifikuar – duke zëvendësuar strategjinë ndërsektoriale kundër terrorizmit të vitit 2020 dhe strategjinë kombëtare të P/KEDH të vitit 2015 dhe planet e tyre përkatëse të veprimit.



- 1 Vurmo, G. (2015). Radikalizmi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Gjetet në adresën <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/RadikalizmiFetar-webOK21-1.pdf>
- 2 Vurmo, G., & Sulstarova, E. (2018). Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri: Vlerësim kombëtar i nxitësve, formave dhe rreziqeve. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Gjetet në adresën <https://idmalbania.org/sq/study-violent-extremism-in-albania-november-2018/>.
- 3 Vrugtmann, et al. (2021) Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri. Tiranë: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Gjetet në adresën [https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Ekstremizmi-i-Dhunshem\\_AL-2021-online.pdf](https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Ekstremizmi-i-Dhunshem_AL-2021-online.pdf)
- 4 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 81, 14 shkurt 2023. ‘Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit’. Shih Fletoren Zyrtare: <https://qzb.gov.al/share/IWfcPcMzQZ2RaMTzxBP4jw>.
- 5 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 81, 14 shkurt 2023. “Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit dhe Planin e saj të Veprimit”. Shih Fletoren Zyrtare: <https://qzb.gov.al/share/IWfcPcMzQZ2RaMTzxBP4jw>



Siç raportohet edhe në vlerësimet e mëparshme, në vitin 2018 qeveria shqiptare krijoi Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH). Kjo qendër përgjigjet për ngritjen e kapaciteteve dhe koordinimin e aktiviteteve P/KEDH në institucionet shtetërore dhe më gjerë, si dhe mbikëqyr zbatimin e pjesëve përkatëse të strategjisë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit. Në prill të vitit 2022 ndodhi një zhvillim i rëndësishëm, kur QKEDH kaloi nga varësia e Kryeministrit në atë të Ministrisë së Brendshme.

Për sa i përket përpjekjeve për riatdhesim, që nga vlerësimi i fundit Shqipëria ka realizuar me sukses dy misione për rikthimin e shtetasve shqiptarë të ngelur në Siri. Në gusht 2021, u riatdhesuan pesë gra dhe 14 të mitur<sup>6</sup>, ndërsa në një operacion të mëvonshëm në maj 2022 u riatdhesuan katër gra të tjera dhe nëntë të mitur.<sup>7</sup> Numri i përgjithshëm i shtetasve të riatdhesuar që nga viti 2020 deri më sot është dhjetë gra dhe 27 fëmijë. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka nisur procedimin penal ndaj të gjitha grave të riatdhesuara për pjesëmarrje në organizatë terroriste dhe pjesëmarrje në veprimtari luftarake në një shtet të huaj<sup>8</sup>. Mendohet se mbeten ende 35 deri në 45 shtetas shqiptarë në Siri, nga të cilët nëntë mendohet të jenë në burgjet nën administrimin e Forcave Demokratike Siriane<sup>9</sup>. Autoritetet shqiptare vazhdojnë të kërkojnë rikthimin e grave dhe fëmijëve të ngelur në kampet siriane.

Në lidhje me veprat e ekstremizmit të dhunshëm, ka pasur një rënie të dukshme në numrin total të procedimeve penale për veprën e terrorizmit gjatë viteve 2021-2022. Konkretisht, shifrat tregojnë për një rënie të konsiderueshme nga 9 raste në 2021 në vetëm një rast në 2022.<sup>10</sup> Në dhjetor 2022 Gjykata Speciale për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar dënoi me 15 vjet burg një shtetas iranian për përgatitjen e akteve terroriste kundër Organizatës Muxhahedine të Popullit të Iranit (MEK), një grup disident iranian i strehuar në Shqipëri.<sup>11</sup> Në vitin 2023 u ngritën akuza kundër dy personave për veprën e nxitjes të akteve terroriste.<sup>12</sup>

Donatorët ndërkombëtarë vazhduan të kenë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e përpjekjeve të P/KEDH-së në vend. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe Fondi Global i Angazhimit dhe Rezistencës së Komunitetit (GCERF) kanë angazhuar institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet fetare. Kontributi i tyre ka qenë në ndihmë të përpjekjeve për riintegrim, për të rritur qëndrueshmërinë e komunitetit, për komunikimin strategjik, si dhe për të rritur më tej kapacitetin e punonjësve të vijës së parë.

Shqipëria ka arritur progres të konsiderueshëm gjatë pothuajse dhjetë vjetësh në zbatimin e

- ■
- 6 Euronews Albania. (2021). Pesë gra dhe 14 fëmijë riatdhesohen nga kampet e ISIS në Siri, Rama: Operacioni, i rrezikshëm. Gjendet në adresën: <https://euronews.al/pese-gra-dhe-14-femije-riatdhesohen-nga-kampi-al-hol-ne-siri-rama-operacioni-i-rrezikshem/>.
  - 7 Ministria e Brendshme (2022). 13 gra dhe fëmijë riatdhesohen nga Siria, ministri Çuçi i pret në aeroport: Mirënjohje për SHBA. Operacionet me partnerët do të vijojnë. Marrë nga <https://mb.gov.al/13-gra-dhe-femije-riatdhesohen-nga-siria-ministri-cuci-i-pret-ne-aeroport-mirenjohje-per-shba-operacionet-me-partneret-do-te-vijojne/>.
  - 8 Hoxhaj, E. (2023). Gratë e kthyer nga Siria, në gjyq për 'pjesëmarrje në organizatë terroriste'. Reporter. Gjendet në adresën: <https://www.reporter.al/2023/12/06/grate-e-kthyer-nga-siria-ne-gjyq-per-pjesemarrje-ne-organizate-terroriste/>.
  - 9 Komisioni Evropian. (2023). Raporti i Progresit i Shqipërisë 2023. p. 49. Gjendet në adresën: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_690%20Albania%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf).
  - 10 Prokuroria e Përgjithshme (2023). Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Gjendjen e Kriminalitetit për vitin 2022. p. 148. Marrë nga [https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti\\_Vjetor\\_kriminaliteti\\_2022\\_Kuvendit\\_Prokuroria\\_e\\_Pergjithshme\\_6915.pdf](https://www.pp.gov.al/rc/doc/Raporti_Vjetor_kriminaliteti_2022_Kuvendit_Prokuroria_e_Pergjithshme_6915.pdf).
  - 11 Komisioni Evropian. (2023). Raporti i Progresit i Shqipërisë 2023. p. 49. Gjendet në adresën: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_690%20Albania%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf).
  - 12 Zëri i Amerikës (2023). Propagandonte ISIS-in, arrestohet radikali i dyshuar nga Kavaja. Marrë nga <https://www.zeriamerikes.com/a/7047374.html>; shih edhe Zëri i Amerikës (2023). I akuzuar për propagandë për qëllime terroriste, për gjykim çështja e 30 vjeçarit nga Durrësi. Marrë nga <https://www.zeriamerikes.com/a/7075070.html>.

ndërhyrjeve të P/KEDH-së. Pavarësisht këtyre arritjeve, situata dinamike e ekstremizmit të dhunshëm vazhdon të krijojë sfida, gjë që nënvizon nevojën e vazhdueshme për vlerësime të rregullta dhe ndërhyrje të përshtatura me gjendjen aktuale. Në përparësitë aktuale në fushën e P/KEDH-së bëjnë pjesë forcimi i qëndresës së komunitetit ndaj të gjitha formave të ekstremizmit të dhunshëm, ecuria e mëtejshme me rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarve për vepra që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe personave të kthyer nga zonat e konfliktit, zhvillimi i komunikimit strategjik, lufta kundër radikalizmit online, forcimi i mekanizmave ndërinstytucionalë, përmirësimi i kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë dhe puna me strategjitë e shkëputjes nga ekstremizmi dhe planet përkatëse të veprimit. Këto mund të arrihen përmes planeve shumaktoriale, duke përfshirë jo vetëm aktorët kryesorë në nivel qendror por edhe ata në nivel vendor.

Ndërkohe që prioritetet e P/KEDH-së trajtohen në mënyrë të kujdeshme, është po aq e rëndësishme të vlerësohet rregullisht edhe gjendja aktuale e çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm në vend. Këto vlerësime shërbejnë si instrumente tepër të dobishme, duke ofruar njohuri mbi situatën në zhvillim të ekstremizmit të dhunshëm. Ato jo vetëm që ndihmojnë në monitorimin e efektshmërisë të ndërhyrjeve që janë duke u zbatuar, por ofrojnë edhe të dhëna praktike me qëllim përshtatjen sa më të saktë të këtyre përpjekjeve për të pasur një ndikim më të madh. Ky është edhe qëllimi i këtij vlerësimi: të informojë vendimmarrësit dhe të përmirësojë kapacitetet e aktorëve të P/KEDH-së duke u ofruar një sërë njohurish me anë të të cilave do të identifikohen tendencat në zhvillim dhe do të bëhet i mundur hartimi i politikave, programeve dhe masave institucionale për trajtimin e këtij fenomeni dhe për forcimin e qëndresës së komunitetit. Si rezultat, kjo do të përmirësojë përpjekjet e P/KEDH-së, do të forcojë ndikimin e këtyre veprimeve dhe do të kontribuojë për një debat publik më të informuar, ndërkohë që në të njëjtën kohë pakëson mundësitë që ideologjitë e ekstremizmit të dhunshëm të fitojnë terren.



## 3. Metodologjia

Ky studim ka si qëllim të bëjë një vlerësim të perceptimeve dhe evidencave që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm në kontekstin shqiptar. Kjo analizë vjen pas nëntë vitesh fushatash në të gjithë shoqërinë për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (P/KEDH), duke u fokusuar në identifikimin e nxitësve kryesorë dhe faktorëve të tjerë që bëjnë të mundur një mjedis të favorshëm për ekstremizmin e dhunshëm. Studimi synon të paraqesë karakteristikat kryesore të ekstremizmit të dhunshëm, përhapjen e tij, komunitetet në rrezik, grupet e cenueshme, rreziqet dhe implikimet e tjera të tij. Objektivi kryesor i këtij hulumtimi është përmirësimi i performancës, ndikimit dhe kapaciteteve të aktorëve të P/KEDH në Shqipëri nëpërmjet debatit të informuar, ndërhyrjeve të bazuara në evidenca, përmirësimit të kuptuarit dhe njohurive të aktorëve kryesorë –shtetërorë dhe jo-shtetërorë– të shoqërisë si dhe komunitetit të partnerëve që mbështesin Shqipërinë në këtë përpjekje.

*Tabela 1. Matrica e nxitësve të ekstremizmit të dhunshëm sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM 2015, 2018, 2021*

NXITËSIT SOCIAL-EKONOMIKË		NXITËSIT KULTURORË		
Perceptimet e përjashtimit dhe marginalizimit social	Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit	Islami nën rrethim		
Diskriminimi ndaj kulturës shoqërore	Nevoja të papërmbyshura sociale dhe ekonomike	Agjendat “proaktive” fetare		
Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ	Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike	Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës		
NXITËSIT POLITIKË				
Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile	Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët	Pushtimi i huaj	Frikësimi apo kërcënim nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm	Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë
Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut	Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta	Dhunimi politik dhe/ose ushtarak	Qeveri të diskretituara apo mungesa ose kooptimi i opozitës ligjore	

Për të bërë të mundur krahasimin me dy studimet e mëparshme kombëtare – “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri” (IDM, 2018) dhe vlerësimin kombëtar të vitit 2021, ky studim përdor të njëjtën qasje. Të dy vlerësimet kanë për bazë metodologjinë e vlerësimit të parë “Radikalizmi Fetar dhe Ekstremizmi i Dhunshëm në Shqipëri”.<sup>13</sup> Po ashtu, të gjitha këto studime kanë

<sup>13</sup> Studimet e IDM-së të viteve 2015, 2018 dhe 2021 gjenden në këto adresa: <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/RadikalizmiFetar-webOK21-1.pdf>, [https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Study\\_Violent-Extremism-in-Albania-2018\\_-\\_web.pdf](https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Study_Violent-Extremism-in-Albania-2018_-_web.pdf) dhe [https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Ekstremizmi-i-Dhunshem\\_AL-2021-online.pdf](https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Ekstremizmi-i-Dhunshem_AL-2021-online.pdf)

përdorur kuadrin e nxitësve social-ekonomikë, politikë dhe kulturorë ndaj ekstremizmit të dhunshëm të Denoeux dhe Carter, siç evidentohet edhe në botimin “Udhëzues mbi nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm” (2009). Ashtu si në studimet e mëparshme, nuk u përfshinë dy nxitës politikë – konflikti lokal, mbështetja shtetërore – për shkak të mungesës së relevancës në kontekstin e Shqipërisë, por në raportin e këtij viti u shtua nxitësi mbi “qeveritë e diskredituara apo mungesa ose kooptimi i opozitës ligjore”.

Në këtë raport, një kapitull i veçantë i kushtohet shqyrtimit të formave të ekstremizmit të dhunshëm jofetar, përfshirë këtu tendencat politike dhe etno-nacionaliste të identifikuara në vlerësimet e mëparshme. Kjo pjesë thellohet në çështje që janë specifike për Shqipërinë nëpërmjet një sërë pyetjesh të hapura dhe pohimesh. Këto pyetje janë hartuar për të shqyrtuar perceptimet e qytetarëve në lidhje me aspekte të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm, përfshirë edhe dimensionet e tij politike, klimën e përgjithshme politike, etno-nacionalizmin, qëndrimet ksenofobike dhe prirjet ndaj teorive konspirative. Një analizë e tillë synon të hedhë dritë mbi kërcënimet e reja të cilave u duhet kushtuar vëmendje.

### Instrumenti i hulumtimit

Në tetor 2023 ekipi i IDM-së përgatiti logjistikën për realizimin e punës në terren për këtë sondazh me një kampion përfaqësues kombëtar prej 1,600 të anketuarish. Sondazhi u realizua tek popullata e përgjithshme me pjesëmarrës të moshës mbi 18 vjeç, të cilët ishin me banim të përhershëm në Shqipëri në kohën e anketimit. Kuadri i kampionimit u bazua tek të dhënat e fundit të regjistrimit të popullsisë të Regjistratit Kombëtar Civil (1 janar 2023) me ndarje sipas bashkisë dhe gjinisë.<sup>14</sup> Shkalla e emigrimit të shtetasve shqiptarë u llogarit nga një Koeficient Sasior Vendbanimi bazuar në regjistrimin e popullsisë dhe numrin e popullsisë sipas Regjistratit Civil 2023 (shtetas shqiptarë) dhe në shpërndarjen e tyre në njësi të ndryshme të qeverisjes vendore. Të dhënat nga Regjistri Civil 2023 u ponderuan me koeficientët sasiorë të vendbanimit për secilën prej 61 bashkive nga të cilat u përzgjedhën të gjitha për të bërë të mundur mbulimin më të mirë gjeografik.

### Vlerësimet e gabimit statistikor janë si më poshtë:

→ Në nivel besueshmërie prej 95%, për një popullsi me 2,180,897<sup>15</sup>, intervali i besueshmërisë është ±2.45.

→ Në nivel besueshmërie prej 99%, për një popullsi me 2,180,897, intervali i besueshmërisë është ±3.22.

Grupi i intervistuesve u trajnuar në fund të muajit shtator 2023 dhe puna në terren për sondazhin kombëtar, që u realizua në formën e intervistave ballë për ballë, u krye në muajin tetor 2023. Në të gjithë procesin u zbatuan kritere të rrepta për përzgjedhjen e të intervistuarve në çdo bashki dhe njësi administrative si dhe u përdorën mekanizma rigorozë për sigurimin e cilësisë gjatë punës në terren me sondazhin dhe administrimin e pyetësorëve. Të dhënat e sondazhit u hodhën, u pastruan dhe u përpunuan në një bazë të dhënash duke përdorur programin SPSS<sup>16</sup> dhe në muajin nëntor 2023 nisi analizimi i gjetjeve paraprake. Të dhënat e sondazhit të prezantuara në këtë studim raportohen me shifra dhjetore, ndërsa të dhënat e kryqëzuara janë rrumbullakosur në dhjetëshen më të afërt. Për shkak të rrumbullakosjes, përqindjet jo gjithmonë mund të plotësojnë 100%.

14 Siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme nëpërmjet një kërkesë mbështetur në Ligjin për të Drejtën e Informimit, më 20 mars 2023.

15 Popullsia e moshës mbi 18 vjeç më 1 janar 2023 –vlerësim i autorëve.

16 IBM’s Statistical Product and Service Solutions (SPSS)



## 4. Profili i të anketuarve


Hulumtimet për ekstremizmin e dhunshëm sugjerojnë se të kuptuarit e plotë të këtij fenomeni mundëson identifikimin e hershëm, parandalimin si dhe reagimin më efikas kundër formave aktuale të ekstremizmit të dhunshëm si dhe kundër grupeve apo individëve ekstremistë. Në fakt, studimet e kryera në Shqipëri për ekstremizmin e dhunshëm, radikalizimin, perceptimet e publikut për ekstremizmin, si dhe debatin në media për çështjet e lidhura me të, kanë përmirësuar ndjeshëm njohuritë e aktorëve kryesorë të P/KEDH-së. Këto përpjekje kanë rritur ndërgjegjësimin e publikut, kanë forcuar qëndresën e komuniteteve fetare dhe kanë fuqizuar grupe të cënueshme duke u përmirësuar aftësitë dhe kapacitetet për të luftuar dhe parandaluar idetë dhe veprimet e ekstremizmit të dhunshëm.

Në këtë studim analizohen perceptimet dhe qëndrimet e shqiptarëve ndaj formave të ndryshme të ekstremizmit, përfshirë këtu ekstremizmin e dhunshëm politik, fetar, dhe etno-nacionalist. Për më tepër, tekta dinamika e ekstremizmit në vend vazhdon të evoluojë, ky studim vlerëson format e reja dhe ato në zhvillim.

### Demografia e kampionit

Sondazhi u krye me një kampion përfaqësues kombëtar. Popullsia aktuale rezidente në Shqipëri është 2,761,785 banorë, e përbërë nga 1,366,921 meshkuj (49,46%) dhe 1,394,864 femra (50,54%)<sup>17</sup>. Kampioni ynë, i përbërë nga 1,600 të anketuar që jetojnë në Shqipëri, përbëhet nga 50,60% gra (N=809) dhe 49,4% burra (N=791), pothuajse identike me përbërjen gjinore të popullsisë shqiptare në tërësi (shih Grafikon 1).<sup>18</sup>

Grafiku 1: Përbërja gjinore e të anketuarve (N=1600)




17 INSTAT. (2023). Popullsia e Shqipërisë, 1 janar 2023. Shih: <https://www.instat.gov.al/media/9830/tab1.xlsx>

18 Të dhënat demografike të paraqitura në kapitujt e mëposhtëm janë rrumbullakosur në dhjetëshen më të afërt. Për shkak të rrumbullakosjes, përqindjet jo gjithmonë mund të plotësojnë 100%.




Në sondazh morën pjesë vetëm popullsia në moshë madhore, ku 59% e kampionit ishin më të rinj se 45 vjeç. Më konkretisht, 11.9% e të anketuarve ishin të moshës 18 deri në 24 vjeç, ndërsa 23.7% ishin të moshës 25 deri në 34 vjeç. Përafërsisht një e katërta (23.4%) ishin të moshës 35 deri në 44 vjeç, ndërsa një e pesta e të anketuarve (18.9%) ishin 45 deri në 54 vjeç. Të anketuarit e moshës 55 deri në 64 vjeç përbënin 15% të kampionit dhe ata mbi 65 vjeç përfaqësonin 7.2% të kampionit (shih Grafikonin 2).

Grafiku 2: Moshë e të anketuarve (N=1600)




Shumica dërrmuese e të anketuarve (76%) kanë kryer arsimin e mesëm ose arsimin universitar (shih Grafikonin 3). 23.4% kanë përfunduar arsimin fillor ose më pak, ndërkohë që një përqindje minimale (0.7%) refuzojnë të përgjigjen. 4.3% e të anketuarve ose janë pa arsim ose kanë kryer disa klasë në ciklin fillor 8-9-vjeçar, ndërsa 19.1% e të anketuarve kanë përfunduar arsimin fillor. 40.3% e të anketuarve kanë mbaruar arsimin e mesëm, 30.5% kanë diplomë të nivelit universitar (BA, BSc), dhe 5.2% kanë kryer arsimin pasuniversitar (studime të nivelit master ose më tej).

Grafiku 3: Niveli arsimor i të anketuarve (N=1600)



Të anketuarve iu kërkua të deklaronin edhe statusin e tyre të punësimit. Shumica e të anketuarve (63.4%) janë pjesë e fuqisë aktive punëtore, me 44.9% të punësuar me pagë dhe 18.5% të vetëpunësuar. Të anketuarit e papunë përbëjnë 1/5 e kampionit (20.1%) dhe 5.9% e të anketuarve janë studentë. Një pjesë tjetër e të anketuarve prej 8.3% deklaruan si status punësimi përgjigjen “tjetër”, ku pjesa më e madhe janë pensionistë dhe ku një përqindje më e vogël përbëhen nga shtëpiake apo individë me paaftësi. 2.3% e të anketuarve nuk iu përgjigjën kësaj pyetjeje.


Grafiku 4: Statusi i punësimit i të anketuarve (N=1600)




Në këtë sondazh u shtua një pyetje për përkatësinë politike. Pjesa më e madhe e shqiptarëve të anketuar (52.3%) nuk i përkasin asnjë grupi të caktuar politik. Një e treta shprehu mbështetje për një nga partitë kryesore politike në Shqipëri, përkatësisht Partinë Socialiste, Partinë Demokratike ose Partinë e Lirisë. Duke pranuar ndarjet e brendshme brenda Partisë Demokratike në Shqipëri<sup>19</sup>, sondazhi bëri dallimin midis Partisë Demokratike dhe Grupit të Rithemelimit së Partisë Demokratike. Gjetjet treguan se 16.20% e të anketuarve mbështesin Partinë Socialiste, 12.50% mbështesin Partinë Demokratike, 2.50% mbështesin Grupin e Rithemelimit të Partisë Demokratike dhe 2.1% mbështesin Partinë e Lirisë. Një përqindje e papërfillshme (0.6%) mbështesin partitë e tjera politike, ndërsa 13.70% zgjedhën të mos e tregojnë se cilën parti politike mbështesin apo i përkasin.



19 Komisioni Evropian, Raporti i Progresit i Shqipërisë 2023, marrë nga [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD\\_2023\\_690%20Albania%20report.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf).



Grafiku 5: Mbështetja për partitë politike nga të anketuarit




## Përkatësia dhe praktikat fetare

Bashkëjetesa dhe toleranca fetare konsiderohen si vlera themelore të shoqërisë shqiptare. Shqipëria është vendi i disa komuniteteve tradicionale fetare që janë krijuar para shumë shekujsh si dhe komunitetet fetare që janë krijuar kohët e fundit, në këto tre dekadat e fundit. Për qëllimet e hulumtimit tonë, i kërkuam të anketuarve të deklarojnë fenë e familjes së tyre dhe fenë e tyre personale. Kjo e fundit është veçanërisht e rëndësishme për të kuptuar sa më mirë kontekstin e perceptimeve që kanë krijuar të anketuarit për shkak të përkatësisë fetare historike të familjes së tyre.


Në kampionin e këtij sondazhi, 56.4% e të anketuarve janë deklaruar si myslimanë, 11.8% katolikë, 11.1% ortodoksë, 6.2% bektashi, 0.4% evangjelistë (ungjillorë) dhe 0.5% kanë deklaruar besime të tjera fetare. Një tjetër përqindje, 5.3%, e të anketuarve u identifikuan si ateistë, 0.2% si agnostikë dhe pjesa e mbetur prej 8.2% refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Grafiku 6: Përkatësia fetare e të anketuarve



Për sa i përket përkatësisë fetare të familjeve të tyre, 57.6% e të anketuarve shprehën se vijnë nga familje myslimane, 11.1% nga familje katolike, 10.4% nga familje ortodokse, 6% nga familje bektashiane dhe 0.2% nga familje evangjeliste (ungjillore). Po ashtu, 7.5% e të anketuarve vijnë nga familje të përziera fetare, 1.1% nuk janë të sigurt për fenë e familjes së tyre dhe 6.1% zgjedhën të mos i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Grafiku 7: Origjina fetare e të anketuarve




Për të vlerësuar nivelin fetar të të anketuarve, në sondazh u përfshinë edhe dy pyetje ku të anketuarve iu kërkua të përgjigjeshin nëse e konsideronin veten si praktikantë të rregullt të fesë dhe detyrimeve fetare (p.sh. kryerja e riteve fetare, lutja) dhe sa shpesh e bëjnë këtë.

Të anketuarve iu kërkua të zgjidhnin një opsion sipas një shkalle që përshkruan praktikimin e fesë së tyre. Kjo shkallë varion nga besimtari që i përmbush rregullisht kërkesat e besimit të tij, tek besimtari që respekton ritet dhe rregullat kryesore të besimit, por që neglizhon pjesën tjetër, tek besimtari që nuk praktikon fare rregullat dhe ritet fetare, deri tek ateisti. Në krahasim me sondazhin e vitit 2021, shfaqet një prirje e dukshme, që tregon një rënie në të dy ekstremet e spektrit – një rënie në numrin e atyre që angazhohen rregullisht në praktikën fetare si dhe në numrin e atyre që identifikohen si ateistë.

Rreth gjysma e të anketuarve (44.2%) e konsiderojnë veten besimtarë, por nuk i praktikojnë aspak ritet fetare, duke shënuar një rritje të dukshme (prej 10.7 pikë përqindje) në krahasim me të dhënat e sondazhit të vitit 2021. 30.3% e të anketuarve praktikojnë ritet kryesore fetare, duke reflektuar një rënie me 5.6 p.p. krahasuar me vitin 2021. Po ashtu, 10.5% i praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare, duke sjellë një rënie prej 9.3 p.p. në krahasim me të dhënat e 2021. Një tjetër përqindje, 5.6%, e të anketuarve nuk i praktikojnë ritet fetare, sepse deklarohen ateistë, shifër që ka një rënie prej 3.9 p.p. krahasuar me të dhënat e vitit 2021 (shih Grafikon 6). Pjesa e mbetur prej 8.9% e të anketuarve zgjedhën të mos i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Grafiku 8: Praktikimi i riteve fetare nga të anketuarit (N=1600)




Një tjetër mënyrë për të vlerësuar besimin fetar të individëve lidhet me pyetjen për devotshmërinë ose përkushtimin ndaj fesë së tyre. Një tregues i devotshmërisë është lutja/falja, përpjekja për të komunikuar me një hyjni ose hyjnitë, qenie ose forca të mbinatyrshme. Lutja është ndoshta akti më i individualizuar në fetë abrahamike dhe në të njëjtën kohë është një shprehje e përbashkët e devotshmërisë, shumë e ritualizuar me klerikë të specializuar dhe rregulla të përcaktuara. Prandaj, të anketuarve iu bë pyetja e mëposhtme: ‘Mund të më thoni sa shpesh luteni/faleni?’. Të anketuarit kishin mundësinë të zgjidhnin një opsion që tregonte për besimtarin e përkushtuar që lutet/falet rregullisht çdo ditë ose çdo javë, dy opsione për besimtarët që luten/falen gjatë ritualeve kolektive, që është tregues i një niveli më të ulët devotshmërie, një opsion për besimtarët që bëjnë kryesisht një jetë laike dhe i kthehen fesë në kohë të vështira, si dhe një opsion “nuk lutem/falem asnjëherë” ose refuzoj të përgjigjem. Tendencat në praktikën e lutjes/faljes nga ky sondazh tregojnë një zhvendosje drejt lutjeve/faljeve më periodike, veçanërisht gjatë ngjarjeve të veçanta fetare, ndërkohë që tregojnë një rënie të përqindjes së të anketuarve që nuk luten/falen kurrë, duke reflektuar praktikën fetare në zhvillim të të anketuarve.

Gjatë një viti normal, 40% e të anketuarve deklaruan se lutën/falën vetëm gjatë festave apo riteve fetare, duke ruajtur të njëjtën përqindje (39.6) si në sondazhin e vitit 2021. Një shifër e konsiderueshme, 27.9%, falen rregullisht, çdo ditë ose javë, gjë që reflekton një rritje prej 6.1 p.p. në krahasim me të dhënat e vitit 2021. Gjetjet e sondazhit tregojnë se 29.9% e të anketuarve lutën/falën me raste, me 22% që e praktikojnë lutjen/faljen vetëm në ngjarje të veçanta fetare – ku kemi një rritje prej 10.7 p.p. krahasuar me të dhënat e vitit 2021 – dhe 7.9% i kthehen lutjes/faljes në kohë krize familjare ose personale, me një rënie prej një 2.9 p.p. Një përqindje më e vogël (2%) e të anketuarve thanë se nuk lutën/falën kurrë, që krahasuar me të dhënat e vitit 2021 kemi një rënie prej 13.5% p.p. dhe një rënie edhe më e ndjeshme (21.9 p.p.) krahasuar me të dhënat e 2018.



Grafiku 9: Praktikimi i lutjes/faljes tek të anketuarit (N=1600)




Dy pyetjet në lidhje me praktikën e lutjes/faljes na japin dy tendenca të kundërta me njëra-tjetrën. Nga njëra anë, rezultatet e pyetjes së parë (praktikimi i riteve fetare) nxori në pah një rënie të dukshme në praktikimin e riteve fetare krahasuar me sondazhin e vitit 2021, ndërkohë që theksohet ruajtja e besimit fetar. Nga ana tjetër, pyetja e dytë (praktikimi i lutjes/faljes) evidenton një zhvendosje të praktikës së lutjes/faljes drejt një praktikimi më periodik të riteve fetare, veçanërisht gjatë ngjarjeve të veçanta fetare, dhe një rënie të theksuar në përqindjen e të anketuarve që nuk luten/falen kurrë. Ndonëse këto tendenca mund të duken kontradiktore në pamje të parë, ato nënvizojnë kompleksitetin e sjelljeve të besimtarëve në Shqipëri. Ka të ngjarë që të anketuarit të ndryshojnë shpeshësinë dhe kontekstin e lutjes/faljes duke e ushtruar besimin fetar gjatë ngjarjeve të veçanta, ndërkohë që potencialisht ulin ritmin e praktikimit të riteve të përditshme ose rutinë. Këto rezultate nxisin nevojën për një analizë më të thellë të marrëdhënieve mes besimeve fetare dhe manifestimit të këtyre besimeve në praktikën e përditshme, në mënyrë që të kuptojmë më mirë dinamikën në zhvillim të shprehjes së besimit fetar tek shqiptarët.

Shqipëria, me pesë bashkësi fetare zyrtare, konsiderohet si një shoqëri multi-fetare ku shumica e njerëzve në jetën e përditshme bashkëveprojnë me individë të besimeve të ndryshme fetare. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që shqiptarët krijojnë gjithmonë marrëdhënie të mirëfillta me njerëz të një besimi tjetër, veçanërisht në një mjedis që ka të bëjë me familjen. Në përpjekje për të zvogëluar paragjykimin shoqëror që i shtyn të anketuarit të përgjigjen pozitivisht kur pyeten në përgjithësi nëse janë dakord me martesat ndër-fetare, të anketuarit u pyetën nëse ata personalisht do të mbështesnin një anëtar të familjes të martohej me një person që i përket një feje tjetër. Shtimi i kësaj pyetje në sondazh synon të përmirësojë matjen e tolerancës së shoqërisë, duke pranuar se individët mund të preferojnë partnerë të të njëjtit besim fetar si çështje e preferencës personale, pa qenë domosdoshmërisht jotolerantë ndaj praktikimit të besimit. Duke e përshtatur pyetjen në këtë mënyrë, synojmë të kuptojmë edhe më mirë tolerancën, duke pranuar se individët mund të kenë këndvështrime të ndryshme për çështje të tilla.

Pjesa më e madhe e të anketuarve (59,9%) deklaruan se do ta mbështesnin me patjetër një anëtar të familjes (vëlla/motër ose fëmijë) nëse do të martohej me një person të një feje tjetër. Kjo tregon një rënie të lehtë prej 5.6 p.p. krahasuar me të dhënat e vitit 2021. Një tjetër

përqindje, 19.6%, do ta pranonin një martesë të tillë, por nuk do ta mbështesnin apo nxisnin atë, duke reflektuar një rritje me 3.4 p.p. në krahasim me të dhënat e vitit 2021. Nga ana tjetër, 5.1% do ta kundërshtonin nëse personi me të cilin do të martohej do të ishte besimtar praktikant, ndërsa 4.5% do të kundërshtonin një martesë të tillë në çdo rast. 7.4% e të anketuarve ishin të pasigurt se cili do të ishte reagimi i tyre në një situatë të tillë, ndërsa pjesa tjetër 3.5% refuzoi të jepte një përgjigje për këtë pyetje.

Grafiku 10: Mbështetja e të anketuarve për martesën ndërfetare të një anëtari të familjes (N=1600)



## 5. Nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri


### 5.1 Nxitësit social-ekonomikë

Në këtë kapitull shqyrtohet ndikimi i shkaqeve bazë social-ekonomike që bëjnë që një individ të jetë i pambrojtur nga ekspozimi ndaj grupeve të dhunshme ekstremiste ose në përfshirjen në aktivitete të dhunshme terroriste. Pakënaqësitë e brendshme që lidhen me motivuesit sociologjikë, si përjashtimi social, margjinalizimi dhe diskriminimi - por edhe faktorë ekonomikë si papunësia, varfëria absolute dhe relative, aktiviteti i paligjshëm ekonomik ose stimujt financiarë - njihen të gjithë si faktorë të mundshëm rreziku.

Në këtë studim kombëtar janë marrë parasysh disa nxitës social-ekonomikë me qëllim që të kuptohet ndikimi i tyre në qarqe të ndryshme të vendit dhe kërcënimi që paraqesin ato për shoqërinë, sepse ofrojnë kushtet për lindjen e grupeve radikale fetare dhe të ekstremizmit të dhunshëm. Në tabelën e mëposhtme jepen nxitësit e identifikuar dhe përshkrimi i tyre (nga Denoeux dhe Carter 2009).

Tabela 2: Nxitësit social-ekonomikë

<b>Perceptimet e përjashtimit social dhe margjinalizimit</b>	Ky perceptim mund të jetë më shumë i përhapur tek të rinjtë nga zonat urbane/periferike dhe në mjedise ku janë dëmtuar strukturat e familjes, kontrollet normale sociale nuk i shqyrtojnë sjelljet, dhe të rinjtë kanë shumë kohë që rrinë pa bërë asgjë. Kjo sjell si rezultat një ndjesi izolimi dhe dëshirë për të shkelur ligjet. Grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund ta shfrytëzojnë këtë izolim duke ofruar një arratisje, ndjesinë e gjetjes së qëllimit dhe përfshirjen në një lëvizje kolektive.
<b>Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit</b>	Rrjetet shoqërore janë një faktor i rëndësishëm në radikalizim dhe rekrutim. Njerëzit mund të përfshihen në grupe të ekstremizmit të dhunshëm së bashku me miqtë ose si rezultat i ndikimit të të afërmeve/fqinjëve apo të ndonjë predikuesi karizmatik lokal.
<b>Diskriminimi shoqëror</b>	Diskriminimi i perceptuar apo i vërtetë ndaj një individi ose komuniteti (ose të dyja), në një kuptim të gjerë mund të jetë një nxitës për ekstremizmin e dhunshëm. Në vendet ku myslimanët janë një pakicë e vogël, diskriminimi social-ekonomik dhe/ose politik mund të perceptohet si i lidhur me mungesën e respektit për Islamin dhe myslimanët, gjë që provokon radikalizimin.
<b>Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ</b>	Privimi relativ dhe pritshmëritë e dështuara janë nxitës të fuqishëm për veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm për të rinjtë duke pasur parasysh përmirësimet në arsimim, sidomos në nivelin e shkollës së mesme dhe të universitetit. Të rinjtë me nivel më të lartë arsimor priren të mendojnë se meritojnë rezultate më të mira në jetë nga ç'mund t'u ofrojë shoqëria. Në përgjithësi, ata nuk mund të marrin vendet e punës që mendojnë se i meritojnë; ata perceptojnë që nepotizmi ua pengon mundësitë për punë.





<b>Nevoja të papërbushura sociale dhe ekonomike</b>	Mospërbushja e nevojave social-ekonomike, veçanërisht kur ndërthuren me faktorë të tjerë, siç janë korrupsioni i përhapur dhe mungesa e sigurisë dhe drejtësisë, mund të jetë një faktor që shfrytëzohet nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat mund të ofrojnë paga dhe shërbime. Megjithatë, nuk është varfëria, por forma e tejskajshme e përjashtimit social nga ana e qeverisë dhe shoqërisë që shkakton mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm.
<b>Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike</b>	Veprimtaritë e paligjshme të organizatave të ekstremizmit të dhunshëm ofrojnë mundësi ekonomike fitimprurëse për ata që kërkojnë të ardhura në rrugë të lehta. Rrjetet që ushtrojnë ekstremizëm të dhunshëm dhe veprimtari ekonomike të paligjshme kanë marrëdhënie me përfitime të ndërsjella, duke i ofruar njëri-tjetrit përvojë për të fshehur sjelljen e paligjshme dhe ideologjinë për ta legjitimuar atë. Burgjet janë një vend i njohur rekrutimi për ekstremizmin e dhunshëm.

Shqipëria përjetoj një rikuperim të konsiderueshëm ekonomik pas pandemisë COVID-19. Në vitin 2022, PBB për frymë në Shqipëri vlerësohej në 6,743 dollarë<sup>20</sup>, ndonëse shumë herë më e ulët se mesatarja prej 34,159 euro e BE-së për atë vit.<sup>21</sup> Kjo rritje, e nxitur nga rritja e punësimit dhe e pagave më të larta, e shtyu punësimin në një nivel rekord prej 63.9% deri në tremujorin e dytë të 2023 – më i larti që nga viti 2019.<sup>22</sup> Pavarësisht këtyre tendencave pozitive, ekonomia përballlet me sfida për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimeve dhe energjisë, të cilat kërcënojnë rënien e nivelit të të ardhurave reale, pengojnë përpjekjet për uljen e varfërisë dhe kufizojnë fleksibilitetin e buxhetit të qeverisë.

Në Shqipëri, ku gati një e katërta e popullsisë jeton në varfëri, asistencë sociale shkon për vetëm 20% të atyre në nevojë.<sup>23</sup> Hendeku zbutet pjesërisht nga të ardhurat që dërgojnë emigrantët, të cilat në vitin 2023 arritën nivelin më të lartë të 15 viteve prej 677 milionë euro.<sup>24</sup> Për shumë familje, këto dërgesa janë jetike, sepse i ndihmojnë të përballojnë kostot e jetesës mes pasigurive të shumta ekonomike. Nuk është për t'u habitur që çështjet e stabilitetit ekonomik dhe emigrimi i punëtorëve të kualifikuar, apo ikja e trurit, spikasin si dy problemet më të rëndësishme me të cilat përballlet ekonomia shqiptare, siç theksohet nga Barometri Ballkanik 2023.<sup>25</sup>

Rritja graduale e moshës mesatare të popullsisë i bën këto sfida edhe më të vështira, ku aktualisht një në katër individë është i moshës mbi 60 vjeç. Kjo plakje demografike ushtron presion mbi skemat shtetërore të pensioneve, të cilat luftojnë për të mbështetur një numër



20 Banka Botërore, Përmbledhje për vendin – Shqipëria, marrë nga <https://www.worldbank.org/en/country/albania/overview#1>

21 Tregtia e Ekonomisë, Bashkimi Evropian, PBB për frymë, marrë nga <https://tradingeconomics.com/european-union/gdp-per-capita>

22 Banka Botërore, Raporti i Rregullt Ekonomik i Ballkanit Perëndimor, 2023 marrë nga <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>

23 Monitor, 'Ndihma ekonomike mbulon vetëm 20% të të varfëve në Shqipëri, ndër më të ulëtat në Evropë', 24 prill 2023, <https://www.monitor.al/ndihma-ekonomike-mbulon-vetem-20-te-te-varferve-ne-shqiperi-nder-me-te-uletat-ne-europe/>

24 Eliza Gedikku, 'Remitancat kapin rekordin e 15 viteve, arritën 677 mln euro në 9 muaj! Dërgesat e emigrantëve ndihmojnë familjet përballë çmimeve të larta', Shqiptarja, 12 dhjetor 2023, <https://shqiptarja.com/lajm/remitancat-kapin-rekordin-e-15-viteve-arriten-677-mln-euro-bsh-emigrantet-sollen-233-mln-euro-ne-sezonin-veror>

25 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Barometri Ballkanik, Opinioni Publik i vitit 2023, marrë nga [https://www.rcc.int/balkanbarometer/key\\_findings/2/public](https://www.rcc.int/balkanbarometer/key_findings/2/public)



në rritje pensionistësh me një bazë në rënie të numrit të kontribuuesve. Aktualisht, raporti i kontribuuesve me pensionistët është afro 1.20 me 1,<sup>26</sup> gjë që tregon për një sistem të tensionuar që varet shumë nga një fuqi punëtore në tkurrje.

Hendeku i madh në përmbushjen e nevojave sociale dhe ekonomike të popullsisë, ndërthurur me nivelet e larta të varfërisë, krijon një mjedis në të cilin aktivitetet e paligjshme ekonomike janë një mjet mbijetese. Këto kushte jo vetëm që ushqejnë lakminë, por përbëjnë edhe një faktor rreziku për përfshirjen ose mbështetjen e ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm si një mënyrë alternative për përmbushjen e këtyre nevojave të paplotësuara. Këto pabarazi janë të dukshme sidomos në periferitë social-ekonomike të vendit. Ndërkohë që investimet janë të përqendruara në Shqipërinë qendrore, zonat rurale mbeten kryesisht të margjinalizuara, duke çuar në zhvillim të pabarabartë.

## Perceptimet e përjashtimit social dhe marginalizimit

### Rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupit

Perceptimi i përjashtimit social mund të jetë më shumë i përhapur tek të rinjtë nga zonat urbane/periferike dhe në mjedise ku janë dëmtuar strukturat e familjes, kontrollet normale sociale nuk i shqyrtojnë sjelljet, dhe të rinjtë e shpërdorojnë kohën e tyre të lirë, gjë që bën që ata të bien pre e sjelljeve dhe qëndrimeve të rrezikshme. Sipas një raporti kërkimor të Këshillit Britanik në Shqipëri, një në katër të rinj kanë një ndjenjë të ulët të integritimit me komunitetet e tyre lokale (d.m.th., nuk ndihen fare pjesë e tij ose vetëm në një masë të vogël). Pjesa më e madhe e këtyre të rinjve përjetojnë nivele të ndryshme përkatësie në komunitet.<sup>27</sup> Grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund ta shfrytëzojnë këtë izolim duke ofruar një arratisje, ndjesinë e gjetjes së qëllimit dhe përfshirjen në një lëvizje kolektive. Rrjetet shoqërore janë një faktor i rëndësishëm në radikalizim dhe rekrutim. Individët mund t'iu bashkohen grupeve të ekstremizmit të dhunshëm së bashku me miqtë e tyre ose si rezultat i ndikimit të të afërmeve, fqinjëve ose një predikuesi karizmatik lokal.

Hulumtimet për dinamikën e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri kanë hedhur dritë mbi faktorët e shumtë që bënë që luftëtarët e huaj terroristë shqiptarë të përfshiheshin në konfliktin sirian gjatë valës së radikalizimit mes viteve 2011-2014.<sup>28</sup> Çështjet sociale, veçanërisht mosfunksionimi i familjeve, ndjenjat e përjashtimit nga shoqëria dhe mungesa e përfaqësimit tek institucionet shtetërore, kanë qenë të konsiderueshme dhe që i shtynë individët drejt radikalizimit. Këta individë shpesh i drejtohen figurave alternative të autoritetit që u ofronin atyre ndjenjën e përkatësisë dhe qëllimit, por që nga ana tjetër i çuan drejt ekstremizmit. Për më tepër, lidhja personale e krijuar me imamët radikalë, të cilët shiheshin si kampionë të pakorruptuar të Islamit të vërtetë, luajti një rol vendimtar. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të merren njohuri e mendime për dinamikat sociale që mbizotërojnë dhe për sfidat e hasura, në mënyrë që të orientohen ndërhyrjet e synuara dhe strukturat mbështetëse për të trajtuar në mënyrë efektive përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm.

26 ISSH, Statistika të Sigurimeve Shoqërore, janar-qershor 2023, marrë nga [https://www.iss.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/Permbledhje\\_statistika\\_06\\_23-web.pdf](https://www.iss.gov.al/wp-content/uploads/2023/09/Permbledhje_statistika_06_23-web.pdf)

27 Iliasov, Aibek., Elodie Causier, Ana Babic (2023). Shqipëria e Brezit të Ardhshëm. Këshilli Britanik. doi.org/10.57884/8Y5S-EH57

28 Mishkova, Diana, et al. (2021) Dokument Pune mbi Mjediset Mundësuese, Drejtuesit dhe Ndodhitë/Mosndodhitë e Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkan, Publikimi i Projektit PREVEX, marrë nga [www.prex-balkan-mena.eu/wp-content/uploads/2021/12/D5.2-final.pdf](http://www.prex-balkan-mena.eu/wp-content/uploads/2021/12/D5.2-final.pdf)

**Pohimet për këta nxitës:**


- Mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumarit, alkoolit, drogës etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (dhunës, veprime vandale, etj.).
- Në zonën ku banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin politik. etno-nacionalist/ fetar
- Lutemi specifikoni çfarë sjelljesh, veprimesh apo qëndrimesh ekstremiste keni vënë re në zonën ku ju banoni.

**Pohimi: Mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumarit, alkoolit, drogës etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (dhunës, veprime vandale, etj.) në zonën ku banoj.**

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Plot 70.4% ishin dakord me këtë pohim, përqindje që ka një ulje të konsiderueshme në këto vitet e fundit. Një tjetër përqindje, 23.3%, e të anketuarve nuk ishin dakord ose aspak dakord me pohimin, ndërsa 6.2% e konsideruan këtë pohim si pa lidhje ose u përgjigjën me ‘Nuk e di’. Kjo tregon një rënie prej 13.9 pikë përqindjeje (p.p.) në krahasim me vitin 2021 (kur 84.8% e të anketuarve ishin dakord ) dhe një rënie prej 10.3 p.p. nga viti 2018 (kur 80.8% e të anketuarve ishin dakord), gjë që tregon një prirje pozitive në perceptimin e sjelljes së të rinjve në këtë drejtim.

Kur bëjmë krahasime sipas ndarjes demografike, të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (76%) dhe ata që ishin simpatizantë të Partisë së Lirisë (82%) ishin më të prirur për të qenë dakord me pohimin. Perceptimi se të rinjtë kanë rënë pre e sjelljeve të rrezikshme ishte gjithashtu mjaft i përhapur tek besimtarët që luteshin/faleshin rregullisht (75%).

**Grafiku 11. Mbështetja për pohimin se mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumarit, alkoolit, drogës etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (N=1600)**



## Pohimi: Në zonën ku banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin politik/ etno-nacionalist/ fetar.


Në pyetësor, të anketuarve iu dhanë përkufizimet e tre formave të ekstremizmit dhe iu kërkua të raportonin shqetësimet e tyre për secilën, si dhe të tregonin nëse ka individë ose grupe të pranishme në zonën ku ata jetojnë që nxisin forma të tilla ekstremizmi. Për ekstremizmin fetar, 30.7% e të anketuarve e konsideruan atë shqetësues ose shumë shqetësues, dhe 6.6% vërejtën se ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar në zonat e tyre (me 4.8% disi dakord dhe 1.8% plotësisht dakord me praninë e individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin fetar). Nga ana tjetër, ekstremizmi politik u konsiderua më shqetësues, me 43.4% që shprehnin shqetësim dhe 16.3% që raportuan se kishin qenë dëshmitarë të nxitjes (10.2% deri diku dakord dhe 6.1% plotësisht dakord) së ekstremizmit politik në zonën ku ata jetonin. Ekstremizmi etno-nacionalist u pa si më pak shqetësues me 27%, me vetëm 3.5% të të anketuarve që e pranonin nxitjen e tij në zonat e tyre (2.3% deri diku dakord, 1.2% pajtohen plotësisht).

Duke reflektuar mbi të dhënat e vitit 2021, gjetjet aktuale tregojnë një prani të reduktuar të individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin e dhunshëm në zonat e anketuara. Për ekstremizmin fetar, niveli i dakordësisë ka rënë me 5.5 p.p. nga viti 2021, kur 12.1% ranë dakord. Edhe pse mbetet shqetësues, niveli i dakordësisë për praninë e ekstremizmit politik është ulur gjithashtu me 11 p.p. nga viti 2021, kur 27.3% ishin dakord. Në mënyrë të ngjashme, perceptimet e ekstremizmit etno-nacionalist kanë treguar një rënie të lehtë prej 3.6 p.p. nga viti 2021, kur 7.1% ranë dakord.


Gjatë kontrollit të të dhënave të kryqëzuara me demografinë, të anketuarit me diplomë pasuniversitare (54%), ata që mbështesin Partinë e Lirisë (59%) dhe ata që janë të vetëpunësuar (50%) kishin më shumë gjasa të pajtoheshin se individët ose grupet në zonën ku jetojnë nxisin ekstremizmin politik. I njëjti perceptim ndahet edhe mes të anketuarve që i përmbahen Ortodoksisë (50%) dhe Bektashizmit (56%), dhe atyre që praktikojnë rregullisht të gjitha ritualet e fesë së tyre (52%).

Të anketuarit e paarsimuar ose ata që kishin mbaruar nivelin e ulët (35%) dhe ata që refuzuan të zbulonin nivelin e tyre arsimor (54%) kishin më shumë gjasa të tregonin praninë e individëve ose grupeve në zonën ku ata jetojnë që nxisin ekstremizmin etno-nacionalist. Për më tepër, mbështetësit e Partisë së Lirisë (38%) dhe Partisë Demokratike (33%) ishin më të prirur të pajtoheshin me pohimin. E njëjta gjë ishte e vërtetë për të anketuarit që i përkasin besimit Ortodoks (34%), ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritualet e fesë së tyre (33%) ose ata që nuk falen kurrë (46%).

Perceptimi se individët ose grupet nxisin ekstremizmin fetar në zonat ku ata jetonin, ndahej zakonisht midis të anketuarve 45-54 vjeç (40%) dhe atyre me diplomë pasuniversitare (37%). Të anketuarit që mbështesin Grupin e Rivendosijes së PD (43%) ishin më të prirur të pajtoheshin me këtë pohim. Në mesin e besimtarëve fetarë, të anketuarit, familjet e të cilëve i përkasin besimit ortodoks (37%), ata të cilët identifikohen si ortodoksë vetë (36%), ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritualet e fesë së tyre (44%) dhe të anketuarit që praktikojnë ritualet kryesore (36%) gjithashtu kishin më shumë gjasa të tregonin praninë e individëve ose grupeve të tilla në zonën ku ata jetonin.



Grafiku 12. Përqindja e të anketuarve të shqetësuar mbi ekstremizmin politik/etno-nacionalist/fetar në Shqipëri (N=1600) dhe të anketuarit që janë dakord se ka individë/grupe që nxisin ekstremizmin politik/etno-nacionalist/fetar në zonën ku ata banojnë (N=1600).



Pyetje: Nëse zgjidhët (Dakord-3; ose Plotësisht dakord-4) për secilën nga format e ekstremizmit, ju lutem specifikoni çfarë sjelljesh, veprimesh apo qëndrimesh ekstremiste keni vënë re në zonën ku ju banoni.

Të anketuarve që thanë se në zonën ku banojnë ka individë ose grupe që nxisin një nga format e ekstremizmit – qoftë politik, etno-nacionalist apo fetar – iu kërkua të specifikonin sjelljet, veprimet apo qëndrimet ekstremiste që kanë vënë re.

Në këtë sondazh, kjo pyetje e hapur u vendos pas një sërë pyetjesh dhe pohimesh të mbyllura që ndihmojnë të anketuarin të reflektojë se sa i përhapur është ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri dhe veçanërisht në zonën ku ata jetojnë. Në pyetjet e mëparshme përfshihej një pyetje e mbyllur ku të anketuarit pyeten sa janë të shqetësuar për ekstremizmin politik, etno-nacionalist dhe fetar në Shqipëri, duke u dhënë një përkufizim për secilin prej këtyre formave të ekstremizmit. Në këtë mënyrë, të anketuarit u udhëzuan për të reflektuar mbi format e sjelljeve, veprimeve ose qëndrimeve ekstremiste për të cilat kanë qenë vetë dëshmitarë. Në përgjigje të pyetjes së hapur, 93 të anketuar identifikuan sjellje që tregojnë ekstremizmin fetar, 42 vunë në dukje ekstremizmin etno-nacionalist dhe një pjesë e konsiderueshme prej 242 të anketuarish raportuan praninë e ekstremizmit politik në zonën ku ata banojnë.

**Ekstremizmi politik** shoqërohej më së shumti me fushatat negative, ku 47 të anketuar evidentuan sulmet e njëanshme dhe mungesën e dialogut me etikë dhe respekt. Nxitja e votuesve u raportua nga 45 të anketuar, të cilët nxorën në pah praktika joetike si ofrimi i përfitimeve ose vendeve të punës në këmbim të votave. Blerja e votave, ndonëse më pak e zakonshme, ishte ende një shqetësim me 10 raste të raportuara. Dhuna ndërpersonale për shkak të përkatësisë politike është vënë re nga 22 të anketuar, gjë që tregon një klimë politike të polarizuar dhe potencialisht të dhunshme. Po ashtu, 22 të anketuar raportuan pjesëmarrje të detyruar politike, gjë që sugjeron për një angazhim të detyruar në veprimtari politike. Favoritizimi politik ose miqësitë (kronizmi) u evidentuan si formë e ekstremizmit nga 18



të anketuar, të cilët dhanë shembuj të avantazheve të padrejta sipas mendimit të tyre për ata të lidhur me partinë qeverisëse. Rastet e hakmarrjes me pushim nga puna për shkak të përkatësisë politike janë raportuar tre herë. Diskriminimi politik, përfshirë këtu mohimin e të drejtave dhe shërbimeve, u përmend nga 16 të anketuar siç u evidentua edhe dhe shqetësimi për mungesën e alternativave politike dhe proceseve të cunguara demokratike. Së fundi, 15 të anketuar e lidhën ekstremizmin politik me sistemet e patronazhit, mbështetjen radikale politike dhe lidhjet ndërmjet politikës dhe aktiviteteve kriminale. Në Kapitullin 6 më poshtë jepet një ndarje e detajuar e këtyre kategorive.

Të anketuarit që raportuan se ishin dëshmitarë të formave të ndryshme të **ekstremizmit fetar** në zonën ku banojnë u klasifikuan në 6 kategori kryesore. Kategoria më shpesh e përmendur ishte 'intoleranca fetare' me 22 raportime, përfshirë këtu mungesën e respektit për besime e tjera, detyrimin, dallueshmëria nga kultura kombëtare dhe prozelitizmin. 'Islamofobia' ishte kategoria e dytë më e cituar, me 17 të anketuar që raportuan raste apo qëndrime të qarta që tregojnë paragjykimet e tilla. Shqetësimet lidhur me 'islamit' u evidentuan nga 13 të anketuar, të cilët cekën çështje si detyrimi/shtrëngimi, prozelitizmin dhe praninë e ekstremistëve. Të anketuarit dhanë 11 raportime për 'Dëshmitarët e Jehovahit', shpesh të lidhura me përpjekjet e tyre për prozelitizmin. 'Manipulimi ideologjik' u përmend në gjashtë raste, duke përfshirë shfrytëzimin e grupeve vulnerabël nga grupe të ndryshme. Së fundi, 'efektet valëzues të konflikteve globale' u vëzhguan nga katër të anketuar, duke reflektuar se si tensionet ndërkombëtare ndikojnë në ndjenjat e banorëve në vend. Gjetjet nga kjo pyetje e hapur në lidhje me ekstremizmin fetar jepen të detajuara më poshtë, në pjesën e *Nxitësve Kulturorë*.

Për sa i përket pranisë së **ekstremizmit etno-nacionalist**, incidentet e ekstremizmit të bazuar në përkatësi etnike kishin të bënin me një kërcënim me vdekje, katër raste të nacionalizmit, tre akte dhune dhe një rast dhune psikologjike. Diskriminimi ishte shqetësimi kryesor, i raportuar nga 11 të anketuar, i ndjekur nga gjuha e urrejtjes nga pesë të anketuar dhe mohimi i të drejtave për shkak të përkatësisë etnike nga dy të anketuar. Përshkallëzimi i mundshëm i konfliktit Kosovë-Serbi si shkas për ekstremizmin etnik ishte shqetësim për pesë të anketuar. Kundër pakicave etnike që kanë rënë pre e formave të ndryshme të diskriminimit ose gjuhës së urrejtjes, të anketuarit përmendën veçanërisht romët dhe egjiptianët (tre raportime), grekët, serbët dhe maqedonasit (dy raportime secili) dhe nga një raportim për bullgarët dhe refugjatët nga zonat e konfliktit. Për më shumë detaje mbi këto kategori, shihni Kapitullin 6.

*Duke marrë parasysh rritjen e numrit të rasteve të konfiskimeve të drogave sintetike në Shqipëri,<sup>29</sup> nuk është çudi që mbi dy të tretat e të anketuarve njohin përhapjen e veseve dhe sjelljeve të rrezikshme tek të rinjtë. Megjithatë, ka pasur një ndryshim të rëndësishëm pozitiv në perceptimet gjatë viteve të fundit, me një rënie prej më shumë se 10 p.p. në krahasim me sondazhet e mëparshme, duke sugjeruar një përmirësim në sjelljen e të rinjve ose të paktën perceptimin për këtë sjellje.*

*Kur vlerësojmë praninë e individëve ose grupeve që nxisin forma të ndryshme të ekstremizmit, perceptimi për ekstremizmin politik (16.3%) mbizotëron mes shqetësimeve për ekstremizmin etno-nacionalist dhe atë fetar, ku kemi 1 në 6 të anketuar që pranojnë praninë e tij në zonën ku banojnë. Për t'u theksuar janë sjelljet e raportuara të lidhura me ekstremizmin politik, si fushata negative, nxitja e votuesve dhe dhuna ndërpersonale për shkak të përkatësive politike, të cilat reflektojnë një atmosferë të tensionuar dhe të polarizuar politike. Nga ana tjetër, shqetësimet rreth etno-nacionalizmit (3.5%) dhe ekstremizmit fetar (6.6%) janë më të ulëta, ndonëse të anketuarit kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe intolerancës fetare, duke raportuar forma të ndryshme të marginalizimit shoqëror.*



29 GI-TOC, Rritja e konfiskimeve të drogës sintetike në Shqipëri sugjeron se kërkesa për këto substanca në vend po rritet, Buletini i Riskut, gusht 2023, <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-016/05-rising-synthetic-drug-seizures-in-albania.html>



*Ky nivel i pabarabartë i shqetësimit për ekstremizmin politik krahasuar me format e tjera nënvizon rolin kryesor që luajnë rrjetet shoqërore dhe dinamikat e grupeve në krijimin e perceptimeve, të përforcuara më tej nga ndjenjat e përjashtimit social dhe marginalizimit tek të rinjtë. Përveç kësaj, me kalimin e kohës ka pasur rënie të lehta në perceptimin e të gjitha formave të ekstremizmit, ku kemi ekstremizmin politik që tregon një rënie të konsiderueshme prej 11 p.p. që nga periudha e fundit e anketimit. Kjo sugjeron një situatë me gjasa në përmirësim ose një efektivitet në rritje të masave kundër ekstremizmit, edhe pse më shumë se 200 të anketuar raportuan se ishin dëshmitarë të sjelljeve, veprimeve ose qëndrimeve specifike ekstremiste në komunitetet e tyre.*

## Diskriminimi shoqëror

Diskriminimi real ose i perceptuar ndaj një individi ose komuniteti (ose të dyjave) në një kuptim të gjerë mund të nxisë ekstremizmin e dhunshëm. Në vendet ku myslimanët janë në minorancë, diskriminimi socio-ekonomik dhe/ose politik mund të perceptohet se lidhet me mungesën e respektit për Islamin dhe myslimanët, duke provokuar kështu radikalizëm. Gjithsesi, në Shqipëri, myslimanët sunitë përbëjnë deri në 57% të popullsisë, ndonëse vetëm një përqindje e vogël e shqiptarëve e konsiderojnë veten si besimtarë praktikantë. Në përgjithësi, në vend pranohet përgjithësisht diversiteti fetar, me një qëndrim të vendosur kundër çdo nocioni dominimi nga çdo fe, pavarësisht nga madhësia.<sup>30</sup>

Pavarësisht kësaj, në vitin 2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) në Shqipëri mori në shqyrtim katër akuza në lidhje me gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimin me bazë fetare, duke nënvizuar natyrën e nuancuar të vlerësimeve të tilla. Njëra prej tyre kishte të bënte me akuzat kundër një figure publike për gjuhë të supozuar urrejtjeje në një postim në Facebook rreth praktikave të lutjes së myslimanëve gjatë Fitër Bajramit. Komisioneri vendosi se postimi në fjalë, ndonëse kritik ndaj riteve publike të lutjes, nuk përbënte gjuhë urrejtjeje kundër myslimanëve. Zyra e KMD-së mori në shqyrtim tre ankesa të tjera për diskriminim fetar, duke arritur në përfundimin në secilin rast se nuk kishte sjellje diskriminuese.<sup>31</sup> Bëhej fjalë për një mosmarrëveshje punësimi që i atribuohet bindjeve fetare dhe politike, që u gjykua edhe në Gjykatën Administrative të Tiranës; një pretendim për diskriminim fetar dhe gjinor, i konsideruar jashtë juridiksionit të Komisionerit; dhe një pretendim të një organizate joqeveritare për gjuhën e urrejtjes në një postim në Facebook lidhur me Fitër Bajramin, i cili nuk u vërtetua.

### Pohimet për këtë nxitës:

- Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar.
- Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë.
- Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucionesh të tjerë.

30 IDM dhe UNDP, Toleranca fetare në Shqipëri, 2018, marrë nga <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Toleranca-fetare-ne-Shqiperi.pdf>

31 Departament Amerikan i Shtetit, 2022 Raporti Ndërkombëtar mbi Lirinë Fetare: Albania, <https://www.state.gov/reports/2022-report-on-international-religious-freedom/albania/>.




### Pohimi: Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar.

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 12% janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ndërkohë që 63.5% e të anketuarve nuk janë dakord ose aspak dakord me të. Krahasuar me vitin 2021, kur 12% ishin dakord me pohimin, ka një rritje të lehtë prej 1.1% në numrin e të anketuarve që mbështesin këtë pohim. 11% e të anketuarve e konsideronin pohimin si pa lidhje dhe 12.4% nuk dinin të jepnin përgjigje nëse ishin dakord apo jo me të.

Mes besimtarëve fetarë, ata që i përkasin fesë së krishterë ortodokse (18%) dhe ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare kishin më shumë gjasa të ishin dakord me pohimin. Edhe mbështetësit e Partisë së Lirisë (24%) dhe Partisë Demokratike (21%) prireshin më shumë të ishin dakord me pohimin se personat e të njëjtit besimi fetar përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social.

Grafiku 13. Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social (N=1600)




### Pohimi: Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë.

Kur u pyetën, 18.9% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ndërkohë që shumica e të anketuarve (62.8%) nuk ishin dakord ose aspak dakord. Kjo paraqet një rënie të vazhdueshme gjatë viteve të perceptimit se mjekra e gjatë dhe shamia e grave lidhen me ekstremizmin fetar, me një rënie prej 6.9 p.p. nga 25.8% që ishte në sondazhin e 2021, në të cilin kishte një rënie prej 4.7 p.p. nga 30.5% në sondazhin e vitit 2018. 12.7% e të anketuarve e kanë konsideruar këtë pohim si pa lidhje dhe 5.6% nuk mund të përgjigjeshin nëse janë dakord apo jo me pohimin.



Mes besimtarëve fetarë, ata që i përkasin fesë së krishterë ortodokse (32%) dhe asaj katolike (28%) dhe ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare (26%) kishin më shumë gjasa të ishin dakord me pohimin se mjekra e gjatë (për burrat) dhe shamia (për gratë) lidhen me ekstremizmin fetar. Edhe simpatizantët e Grupit të Rithemelimit të PD-së (53%) prireshin më shumë të ishin dakord me këtë pohim.

Grafiku 14. Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë (N=1600)




#### Pohimi: Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore.

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 36.9% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ndërkohë që 34.5% shprehën se nuk ishin dakord. Në vitin 2021, përqindja e të anketuarve që ishin dakord se komuniteti fetar të cilit i përkasin është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore u rrit nga 30% në 2018 në 41.6%. Megjithatë, këtë vit ka pasur një rënie të përqindjes me 4.7 p.p.

Një përqindje e konsiderueshme prej 23.5% treguan se nuk e dinin nëse do të ishin dakord me pohimin apo jo dhe 5.2% e konsideruan atë si pa lidhje – duke treguar se përkatësia fetare e zyrtarëve publikë nuk është shqetësimi kryesor për ta. Ky perceptim është i përbashkët kryesisht për të anketuarit e besimit mysliman (42%) dhe për ata që janë besimtarë por nuk i praktikojnë fare ritet fetare (42%) ose për ata që luten/falen kryesisht në raste krizash familjare apo personale (48%).



Grafiku 15. Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore. (N=1600)



Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, besimtarët ortodoksë (18%) prireshin të besonin se individët që kanë të njëjtë fe me ta përfitojnë më pak mundësi për zhvillim ekonomik dhe social. Për më tepër, kur marrim parasysh simbolet e ekstremizmit fetar, besimtarët ortodoksë (32%) dhe katolikë (28%) prireshin më shumë se mesatarja kombëtare për të menduar se mbajtja e mjekrës së gjatë nga burrat dhe shamitë e kokës nga gratë lidheshin me besimet ekstremiste.

Në vlerësimin e diskriminimit shoqëror në përgjithësi, sondazhi nxori në pah se një pjesë modeste, 13.1% e të anketuarve, e perceptonin besimin e tyre fetar si pengesë për mundësitë ekonomike dhe sociale, duke shënuar një rritje të lehtë nga viti i kaluar. Përveç kësaj, 18.9% e të anketuarve e lidhin mjekrën e gjatë (për meshkujt) ose shaminë (për femrat) me ekstremizmin fetar. Këto gjetje mbështeten më tej nga të dhënat e përftuara kur të anketuarit u pyetën për rastet e diskriminimit të hapur ose gjuhës së urrejtjes për të cilat kishin qenë dëshmitarë vitin e kaluar.<sup>32</sup> Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes për shkak të besimit fetar u raportua në 19 raste, nga të cilat 11 raste thuhet se synonin në mënyrë specifike besimtarët myslimanë. Të dhënat, që tregojnë një shkallë të ulët të incidencës së diskriminimit të perceptuar dhe atë aktual, sugjerojnë se incidente të tilla janë të izoluara dhe ky nxitës ka më pak gjasa të ketë ndikim të madh në perceptimin e shqiptarëve për ekstremizmin fetar.

Po të kemi parasysh se popullsia shqiptare bën kryesisht një jetesë laike, të karakterizuar nga niveli i ulët i njohjes ose interesit për çështjet fetare dhe refuzimi që besimet fetare të ndikojnë ose të diktojnë mënyrën e tyre të jetesës,<sup>33</sup> është e kuptueshme pse ka një tendencë në rënie për të lidhur simbolet fizike fetare me ekstremizmin. Ky perceptim ka pësuar një rënie të dukshme gjatë viteve, ku tani kemi më pak se 1 në 5 të anketuar që bëjnë një lidhje të tillë, një rënie prej afro 7 p.p. nga sondazhi i vitit 2021. Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve, rreth 1 në 4, mbeten të pavendosur ose indiferentë ndaj rëndësisë së përkatësisë fetare në përfaqësimin politik, duke nxjerrë në pah një mosinteresim të përgjithshëm për përkatësinë fetare si kriter për angazhimin politik dhe institucional.

32 Trajtohet nëpërmjet një pyetjeje të hapur në seksionin 6. Tendencat e reja të ekstremizmit të dhunshëm.

33 IDM dhe UNDP, Toleranca fetare në Shqipëri, 2018, marrë nga <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2021/11/Toleranca-fetare-ne-Shqiperi.pdf>

## Pritshmëri të dështuara dhe privim relativ

Privimi relativ dhe pritshmëritë e dështuara janë nxitës të fuqishëm për veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm mes të rinjve. Janë ngritur shqetësime për transparencën dhe ndikimin e informalitetit në procesit e kërkimit për punë.<sup>34</sup> Për më tepër, mospërputhja mes diplomave të dhëna nga institucionet arsimore dhe aftësive që kërkohen nga tregu i punës sugjeron se edhe të rinjtë me arsim të lartë përballen me vështirësi për të gjetur punë. Shpesh këto vështirësi i shtyjnë të emigrojnë. Nga ata që dëshirojnë të largohen, pothuajse 8 në 10 shqiptarë thonë se kanë si qëllim të ikin për mundësi më të mira punësimi<sup>35</sup> ose me gjasa për mundësi më të mira arsimimi. Të dhënat nga Barometri i Ballkanit sugjerojnë se 36% e të anketuarve shqiptarë janë plotësisht ose përgjithësisht të pakënaqur me arsimin, ndërsa 30% nuk janë as të kënaqur dhe as të pakënaqur.<sup>36</sup>

Të rinjtë me nivel më të lartë arsimor priren të mendojnë se meritojnë rezultate më të mira në jetë nga ç'mund t'u ofrojë shoqëria. Ata shohin se nepotizmi pengon mundësitë për punë dhe se nuk kapin dot vendet e punës që meritojnë. Kjo u dëshmuar në protestat e studentëve të mjekësisë në vitin 2023, të cilët kundërshtuan një vendim të kohëve të fundit të qeverisë në të cilin studentëve u kërkohet të punonin për pesë vjet në Shqipëri para se të merrnin diplomën.<sup>37</sup> Masa ishte në vazhden e përpjekjeve të qeverisë për të parandaluar emigrimin masiv të studentëve të mjekësisë nga Universiteti publik i Mjekësisë. Shpesh të diplomuarit e mjekësisë menjëherë pas marrjes së diplomës ikin për të punuar ose për t'u specializuar në një nga vendet e BE-së, veçanërisht në Gjermani. Thuhet se ata e bëjnë këtë për të përfituar nga kurrikulat e përditësuara, mjediset dhe pajisjet më të mira arsimore dhe mundësitë e shumta për t'u specializuar në degë të ndryshme me interes për ta.

Në fund të fundit, kjo dukuri e pritshmërive të dështuara dhe privimit relativ jo vetëm që nxit dëshirën e profesionistëve të rinj për të emigruar, por mund të krijojë edhe një precedent të rrezikshëm – duke i bërë të rinjtë e tjerë të besojnë se shqetësimet e tyre do të bien në vesh të shurdhët. Ky perceptim, nga ana tjetër, mund t'i shtyjë individët e cenueshëm të përqafojnë ideologji ekstremiste që premtojnë një ndjesi qëllimi në jetë, përkatësi ose drejtësi sociale.

### Pohimet për këtë nxitës:

- Në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune.
- Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme.

**Pohimi: Në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune.**

34 Iliasov, Aibek., Elodie Causier, Ana Babic (2023). Shqipëria e Brezit të Ardhshëm. Këshilli Britanik. doi.org/10.57884/8Y5S-EH57

35 Iliasov, Aibek., Elodie Causier, Ana Babic (2023). Shqipëria e Brezit të Ardhshëm. Këshilli Britanik. doi.org/10.57884/8Y5S-EH57

36 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Barometri i Ballkanit, Opinioni Publik 2023, marrë nga [https://www.rcc.int/balkanbarometer/key\\_findings/2/public](https://www.rcc.int/balkanbarometer/key_findings/2/public)


37 Fjori Sinoruka, 'Studentët e mjekësisë protestojnë kundër detyrimit për të qëndruar në vend', Balkan Insight, 2 tetor 2023, <https://balkaninsight.com/2023/10/02/albania-medical-students-protest-over-obligation-to-stay-in-country/>.



Gjysma e të anketuarve (50.3%) besojnë se, në përgjithësi, njerëzit e mirë-arsimuar në zonën ku të anketuarit banojnë kanë siguruar vende të mira pune, ndërsa 42.5% nuk janë dakord me këtë pohim. Në vitin 2021, përqindja e të anketuarve që ishin dakord se të rinjtë e mirë-arsimuar në zonën e tyre kanë siguruar vende të mira pune u rrit ndjeshëm me 33.8 p.p. në 57.9%, nga 24.1% që ishte në vitin 2018. Gjithsesi, në vitin 2023, kjo përqindje ka rënë me 7.6 pp nga niveli i vitit 2021.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (85%) dhe ata që mbështesin Partinë Socialiste (68%) prireshin më shumë të ishin dakord me pohimin se qytetarët e mirë-arsimuar kanë siguruar vende të mira pune në zonën ku banojnë. Mes besimtarëve fetarë, kjo përqindje është e përafërt mes atyre që i përkasin besimit ortodoks (62%) dhe atyre që i praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (58%).

Grafiku 16. Në përgjithësi, qytetarët e mirë-arsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune. (N=1600)




### Pohimi: Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme.

Të anketuarve iu kërkua të thonin sa dakord ishin me pohimin duke përdorur një shkallë me katër pikë nga “aspak dakord” (1) në “plotësisht dakord” (4). 47.6% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin ndërkohë që 43.2% shprehën mosdakordësi me këtë pohim. Rreth 9% e të anketuarve nuk e dinin nëse burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku ata banojnë vjen nga puna e ndershme, apo që e konsiderojnë këtë pohim si pa lidhje. Krahasuar me vitin 2021, kur 63.5% e të anketuarve ishin dakord me këtë pohim, ka pasur një rënie të konsiderueshme me 15.9 p.p. për vitin 2023, pas një rritjeje të lehtë (1.8 p.p.) nga viti 2018, kur 61.7% ishin dakord.

Të anketuarit e grupmoshës 55 dhe 64 vjeç (53%), mbështetësit e Partisë Socialiste (63%) ishin më të prirur të ishin dakord me pohimin se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku jetojnë është puna e tyre e ndershme. Besimtarët ortodoksë (53%) dhe ata që

praktikojnë ritet kryesore fetare të besimit të tyre (54%), si dhe ata që luten/falen vetëm në festa fetare gjatë një viti normal (58%) kishin po aq prirje të shprehnin dakordësinë e tyre me këtë pohim.

Grafiku 17. Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme. (N=1600)



Gjetjet tregojnë për pritshmëritë e dështuara dhe privimin relativ mes të rinjve shqiptarë, veçanërisht në lidhje me mundësitë e punësimit dhe përputhjen e arsimit me kërkesat e tregut të punës. Ndonëse gjysma e të anketuarve besojnë se qytetarët e mirë-arsimuar sigurojnë vende të mira pune, një përqindje e konsiderueshme, plot 42.5%, nuk ishin dakord, duke reflektuar një skepticizëm të madh me efikasitetin e sistemit arsimor në sigurimin e mundësive për punësim. Ky skepticizëm rritet edhe më shumë nga një rënie e konsiderueshme prej 7.6 p.p. në krahasim me vitin 2021 në përqindjen e të anketuarve që ishin optimistë për perspektivat e punësimit për qytetarët e mirë-arsimuar. Për më tepër, ka pasur një rënie të ndjeshme të perceptimit se burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë është puna e tyre e ndershme, me një rënie prej 15,9 p.p. nga viti 2021. Kjo rënie sugjeron shqetësimet në rritje për transparencën dhe drejtësinë e tregut të punës, ndoshta të përkeqësuar nga informaliteti dhe nepotizmi.

Këto perceptime nxjerrin në pah një hendek mjaft të madh mes midis aspiratave të të rinjve dhe realiteteve të tregut të punës, duke i vënë theksin një problematike më të madhe shoqërore ku premtimi se arsimit është rrugë drejt begatisë mbetet i papërmbyshur për shumë njerëz, dhe që me gjasa i nxit ata drejt migrimit ose propagandës ekstremiste. Rëndësia e këtij nxitësi sugjeron se pritshmëritë e dështuara dhe privimi relativ mund t'i bëjnë të rinjtë shqiptarë të cenueshëm ndaj ideologjive ekstremiste që i shfrytëzojnë pakënaqësi të tilla.

### Nevoja të papërmbyshura sociale dhe ekonomike

Niveli i lartë i varfërisë dhe papunësisë në zonat periferike dhe të margjinalizuara si dhe shërbimet e dobëta sociale i ekspozojnë komunitetet vendore ndaj aktiviteteve të grupeve që kanë programe radikale apo ekstremiste. Mospërmbyshja e nevojave social-ekonomike, veçanërisht kur ndërthuren me faktorë të tjerë, siç janë korrupsioni i përhapur dhe mungesa



e sigurisë dhe drejtësisë, mund të jetë një faktor që shfrytëzohet nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat mund të ofrojnë paga dhe shërbime. Gjithsesi, nuk është varfëria në vetvete, por forma e tejskajshme e përjashtimit social nga ana e qeverisë dhe shoqërisë që shkakton mbështetje për ekstremizmin e dhunshëm.

Në shumë zona periferike dhe të pazhvilluara, shumë njerëz varen nga ndihma dhe asistencë ekonomike që jepen nga shteti. Prandaj, ka rëndësi të madhe që institucionet shtetërore të punojnë në mënyrë profesionale me individët dhe familjet në nevojë, jo thjesht për shkak të varfërisë, por edhe për shkak të ndjenjave akute të neglizhimit dhe përjashtimit që nxisin radikalizmin, ekstremizmin dhe sjelljen e dhunshme. Në vendet në zhvillim si Shqipëria, zakonisht sektori i shoqërisë civile hyn në partneritet me shtetin për të ofruar ndihmë, asistencë dhe trajnime për njerëzit në nevojë. Përveç fondacioneve të huaja humanitare dhe organizatave joqeveritare (OJF), në vend kanë qenë aktive edhe organizatat e huaja fetare, duke ofruar ndihma materiale, shërbime shëndetësore, arsim dhe këshillim shpirtëror për shumë qytetarë të tillë. Por ndonjëherë, siç ishte rasti në vitet 1990, organizatat humanitare fetare kanë shërbyer si mbulesë për ekstremistët e huaj fetarë të cilët përhapnin propagandën e tyre dhe synonin ta kthenin Shqipërinë në një bazë operative për aktivitetet e tyre në vende të tjera. Organizata të tilla patën ndikim të madh në zonat e varfra periferike dhe rekrutuan shumë pasues, kryesisht djem të rinj, të cilët filluan të praktikonin rite që ishin të panjohura për Islamit tradicional shqiptar deri në atë kohë. Me zbulimin e lidhjeve mes terrorizmit ndërkombëtar dhe disa prej këtyre organizatave “bamirëse” në mes të viteve 2010, këto të fundit u detyruan të mbyllnin aktivitetin e tyre në Shqipëri.<sup>38</sup>

Për të luftuar abuzimin me financimin e terrorizmit të OJF-ve, Rekomandimi 8 i Task Forcës Ndërqeveritare të Veprimit Financiar (FATF) i kërkon Shqipërisë të bëjë një vlerësim të riskut të OJF-ve për të identifikuar çdo rrezik për financimin e terrorizmit që paraqesin ato.<sup>39</sup> Për këtë qëllim, FATF ka miratuar një përkufizim funksional të OJF-ve, ku përfshihet çdo ‘person juridik ose marrëveshje ose organizatë që angazhohet kryesisht në mbledhjen ose lëvrimin e fondeve për qëllime të tilla si bamirësi, qëllime fetare, kulturore, arsimore, sociale ose vëllazërore, ose për kryerjen e formave të tjera të “veprave të mira”. Në një raport vlerësimi për financimin e terrorizmit nga OJF-të në Shqipëri theksohet se, duke pasur parasysh burimet e tyre të të ardhurave të njohura aktualisht, sektori jofitimprurës në Shqipëri nuk konsiderohet të jetë në rrezik të madh shfrytëzimi nga veprimtaritë terroriste.<sup>40</sup> Megjithatë, është e domosdoshme të nxitet një mjedis ku promovohet vetërregullimi brenda sektorit jofitimprurës dhe të rritet transparenca. Kjo është jetike për të siguruar që OJF-të, veçanërisht ato që angazhohen në ofrimin e shërbimeve, të kenë llogaridhënie. Krahas kësaj, është po aq e rëndësishme që të kultivohet mirëkuptimi te popullsia se, ndonëse OJF-të luajnë një rol vendimtar në plotësimin e shërbimeve shtetërore, ato nuk mund të zëvendësojnë shtetin në këto shërbime. Ky dallim ndihmon në parandalimin e një varësie të tepërt nga sektori jofitimprurës, duke siguruar një qasje të balancuar për trajtimin e nevojave të shoqërisë. Duke vepruar kështu, sektori jo vetëm që mund t'i përmbahet përkufizimit funksional të FATF-së, por edhe të mbrohet nga abuzimet e mundshme, duke forcuar kështu integritetin e tij dhe besimin e aktorëve të tjerë.

Për të kuptuar më mirë këtë dukuri, të intervistuarve iu parashtruan dy pohimet e mëposhtme.



38 Balkan Investigative Reporting Network. (2014). Zanafilla e islamit radikal në Shqipëri. Reporter.al, available online: <https://www.reporter.al/zanafilla-e-islamit-radikal-ne-shqiperi/>

39 FATF (2023), BPP-Lufta kundër abuzimit me financimin terrorist të organizatave jofitimprurëse, FATF, Paris, [www.fatf-gafi.org/en/publications/Financialinclusionandnpoissues/Bpp-combating-abuse-npo.html](http://www.fatf-gafi.org/en/publications/Financialinclusionandnpoissues/Bpp-combating-abuse-npo.html)

40 Raporti i Vlerësimit për Kuadrin Ligjor dhe Rregullator për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftën Kundër Financimit të Terrorizmit për Organizatat Jofitimprurëse në Shqipëri <https://www.partnersalbania.org/wp-content/uploads/2021/09/Raporti-i-Vleresimit-Legal-and-Regulatory-Framework-on-Anti-Money-Laundering-for-NPOs.pdf>



**Pohimet për këtë nxitës:**


- Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime.
- Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre.

**Pohimi:** Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime.

Kur u pyetën nëse institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale dhe pa abuzime në zonën ku banojnë të anketuarit, 41.6% e tyre thanë se janë dakord me pohimin. Gjysma e kampionit (50.4%) nuk ishin dakord me pohimin, ndërsa 7.9% e të anketuarve nuk e dinin ose e konsideronin si pa lidhje këtë pohim. Në vitin 2023, kishte një rritje prej 6.2 p.p. në 35.4% të të anketuarve që janë dakord se institucionet shtetërore në zonën ku jetojnë punojnë në mënyrë profesionale dhe pa abuzime, krahasuar me vitin 2021. Kjo vjen pas një rritjeje me 9.6 p.p. nga viti 2018, kur vetëm 25.8% ishin dakord me këtë pohim.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit e grupmoshës 45-54 (48%), dhe ata që ishin mbi 65 vjeç (47%) prireshin më shumë të ishin dakord me pohimin. Perceptimi se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale dhe pa abuzime në zonën ku banojnë të anketuarit ishte po aq i përhapur tek mbështetësit e Partisë Socialiste (62%) dhe ata që identifikoheshin si ortodoks (52%).

**Grafiku 18.** Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime. (N=1600)



**Pohimi:** Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre.




Sipas 43.5% të të anketuarve, në zonën ku ata banojnë, ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre. Përqindja e atyre që nuk ishin dakord ose aspak dakord me pohimin ishte 34.6%. 19.9% e të anketuarve nuk e dinin nëse do të ishin dakord apo jo me pohimin dhe 2.1% e konsideronin atë si pa lidhje.

Në vitin 2023, ka një rënie me 10 p.p. nga 53.5% e të anketuarve të vitit 2021 që shprehen dakord se në zonën ku jetojnë ka grupe fetare që ofrojnë të mira ekonomike ose materiale për ata që praktikojnë fenë e tyre. Kjo rënie vjen pas një rritjeje të konsiderueshme prej 22.8 p.p. nga viti 2018, kur vetëm 30.7% e të anketuarve ishin dakord me pohimin.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit e grupmoshës 55-64 vjeç (50%) dhe ata që refuzuan të tregonin nivelin e tyre arsimor (55%) ishin më të prirur të binin dakord me pohimin. Mbështetësit e Grupit të Rithemelimit të PD-së (80%) kishin shumë gjasa të shprehnin dakordësinë e tyre me pohimin se në zonën ku banojnë ka grupe fetare që ofrojnë të mira ekonomike ose materiale për ata që praktikojnë fenë e këtyre grupeve. Ky pohim është më se i vërtetë edhe për të anketuarit që janë të besimit bektashi (55%), ortodoksë (53%) dhe ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare (54%).

Grafiku 19. Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre. (N=1600)



Gjetjet nga këto pohime na japin një panoramë të rëndësishme në dinamikën komplekse të nevojave të papërmbushura sociale dhe ekonomike në Shqipëri, duke nxjerrë në pah një panoramë ku ndërveprimi mes privimit socio-ekonomik, performancës institucionale dhe ndikimit të grupeve fetare i jep formë cenueshmërisë së komunitetit ndaj programeve radikale ose ekstremiste. Duhet theksuar se pak më shumë se dy të pestat e të anketuarve besonin se institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale dhe pa abuzime, ndonëse gjysma e popullsisë së anketuar nuk ishin dakord, duke treguar një nivel të konsiderueshëm mosbesimi ose pakënaqësie me efikasitetin dhe integritetin e këtyre institucioneve. Gjithsesi, ka pasur një trend pozitiv gjatë viteve, me një rritje graduale të besimit nga viti 2018 në 2023, gjë që sugjeron se janë bërë disa përmirësime në perceptimin e publikut për punën e institucioneve.



*Nga ana tjetër, një pjesë e konsiderueshme, gati gjysma e të anketuarve, pranuan prezencën e grupeve fetare që ofronin të mira ekonomike ose materiale për praktikantët e fesë. Ky konstatim nënvizon potencialin për shfrytëzimin e dobësive socio-ekonomike nga grupe të caktuara për të zgjeruar ndikimin e tyre ose për të rekrutuar pasues, veçanërisht kur këta të fundit janë të varfër dhe të papunë. Megjithatë, ka pasur një rënie të dukshme në perceptimin e aktiviteteve të tilla (10 p.p.) që nga viti 2021, duke treguar një rënie të mundshme të publicitetit ose përhapjes së këtyre praktikave.*

*Këto mendime nxjerrin në pah një ndërveprim të vazhdueshëm të sfidave social-ekonomike, me besimin institucional dhe me ndikimin e grupeve fetare që ofrojnë të mira materiale. Të dhënat eidentojnë nevojën tejet të madhe për rritjen e profesionalizmit, transparencës dhe efektivitetit të programeve shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike për të trajtuar shkaqet bazë të cenueshmërisë dhe për të parandaluar shfrytëzimin nga grupet ekstremiste që kërkojnë të radikalizojnë ose rekrutojnë individë me vështirësi ekonomike. Tendenca në rënie në perceptimin e grupeve fetare që ofrojnë të mira materiale mund të jetë si rrjedhojë e përpjekjeve të suksesshme për të kufizuar ndikimin e grupeve ekstremiste, ndonëse mbetet një shqetësim i madh që kërkon vëmendje të vazhdueshme dhe marrjen e masave përkatëse.*

### Lakmia apo shtimi i veprimtarive të paligjshme ekonomike

Veprimtaritë e paligjshme të organizatave të ekstremizmit të dhunshëm ofrojnë mundësi ekonomike fitimprurëse për ata që kërkojnë të sigurojnë të ardhura në rrugë të lehta. Rrjetet që ushtrojnë veprimtari ekonomike të paligjshme dhe grupet e ekstremizmit të dhunshëm kanë marrëdhënie me përfitime të ndërsjella, ku të parët ofrojnë të ardhura dhe përvojë për të fshehur veprimtarinë e paligjshme dhe të dytët ofrojnë ideologjinë për ta përligjur atë. Kështu, burgjet janë një vend i njohur rekrutimi për ekstremizmin e dhunshëm.

Edhe pse ekstremizmi dhe terrorizmi i dhunshëm klasifikohen si krim i orientuar politikisht, ai është i lidhur ngushtë edhe me aktivitete të tjera të paligjshme që kanë synime ekonomike. Organizatat terroriste angazhohen në veprimtari të paligjshme ekonomike për të financuar aktivitetet e tyre. Ato blejnë armë, dokumente false dhe materiale të tjera logjistike nga trafikantë si dhe pastrojnë paratë nëpërmjet kanaleve që përdoren edhe nga krimi i organizuar. Siç u tha edhe në nxitësin “Nevoja të papërmbushura sociale dhe ekonomike”, disa organizata bamirëse islamike në Ballkan kanë vepruar në të kaluarën si organizata ombrellë për aktivitete terroriste, duke u siguruar terroristëve dokumente të rreme të prodhuara në tregun e zi dhe duke financuar përmes transfertave bankare udhëtimet e tyre në rajon.<sup>41</sup> Për të shqyrtuar nëse mjedisi në Shqipëri ofron hapësirë për lidhjen e veprimtarisë kriminale me ekstremizmin e dhunshëm, në këtë studim të anketuarit e sondazhit u pyetën se sa të gatshëm do të ishin të merreshin me veprimtari të paligjshme për të siguruar bukën e gojës.

#### Pohimet për këtë nxitës:

- Për të siguruar mbijetesën/bukën e përditshme, do justifikoja çdo lloj aktiviteti ekonomik, qoftë edhe i paligjshëm.
- Pasurimin e shpejtë e duan të gjithë pavarësisht se si arrihet.

28.1% e të anketuarve kanë pohuar se do të justifikonin çdo lloj aktiviteti ekonomik, qoftë edhe të paligjshëm, për një jetesë më të mirë. Gjithsesi, 67.1% e të anketuarve nuk ishin dakord ose aspak dakord me këtë pohim. Po ashtu, 30.7% e të anketuarve janë dakord se pasurimi i shpejtë nuk është i gabuar, pavarësisht se si arrihet, ndërkohë 64.5% nuk janë dakord me këtë pohim.


41 Zoto, E. (2013) Dështimi dhe suksesi i operacioneve inteligjente të xhihadit në internet. Tezë për gradën master. Monterey (CA): Naval Postgraduate School.



Të anketuarit me nivel të ulët arsimor – veçanërisht, ata pa arsim (40%) dhe ata që kanë ndjekur vetëm arsimin fillor (50%) – kishin më shumë gjasa të justifikonin aktivitetet ekonomike të çdo natyre për një jetë më të mirë dhe ta konsideronin pasurimin e shpejtë si të pranueshëm, pavarësisht se si arrihen ato. Prirje të ngjashme kanë shfaqur edhe të papunët, ku 33% që justifikojnë çdo aktivitet ekonomik për një standard më të mirë jetese dhe ku 36% janë dakord se pasurimi i shpejtë është i pranueshëm, pavarësisht se si arrihet ai.

Besimtarët nga familjet e përziera fetare dhe bektashinjtë treguan një hapje të dukshme ndaj të gjitha formave të aktiviteteve ekonomike, ku 54% e atyre me prejardhje të përzier fetare dhe 33% e besimtarëve bektashi ishin dakord me justifikimin e aktiviteteve të tilla. Përveç kësaj, 52% e të anketuarve me prejardhje të përzier fetare besonin se pasurinë e fituar shpejt e duan të gjithë, pavarësisht formave me të cilat arrihet ajo.

Grafiku 20. Mbështetja për justifikimin e çdo aktiviteti ekonomik, përfshirë atë të paligjshëm dhe se pasurimi i shpejtë nuk është gabim. (N=1600)



Edhe pse në përqindje minimale, është për t'u shqetësuar se pranohet nga një numër jo i vogël shqiptarësh përfshirja në aktivitete të paligjshme ekonomike ose justifikimi i përfshirjes në to për përfitime financiare, duke reflektuar joshjen e pasurisë së menjëhershme për shkak të presioneve ekonomike. Konkretisht, gati 3 në 10 të anketuar do të justifikonin çdo lloj aktiviteti ekonomik, përfshirë edhe ato të paligjshme, nëse do të sillte një standard më të mirë jetese, ndërsa një përqindje e ngjashme nuk shihte asgjë të keqe në krijimin e shpejtë të pasurisë, pavarësisht nga mënyrat me të cilat arrihet ajo. Kjo eidenton një nivel të konsiderueshëm të vështirësive ekonomike ose fleksibilitetin moral mes segmenteve më pak të arsimuara të popullsisë, duke i bërë ato potencialisht më të ndjeshme ndaj ndikimeve të organizatave të dhunshme ekstremiste dhe rrjeteve të krimit të organizuar që shfrytëzojnë dobësi të tilla për rekrutimin dhe financimin e veprimtarive të tyre. Gjithsesi, shumica mbajti një qëndrim të qartë kundër mjeteve të paligjshme për pasurim ekonomik, duke eidentuar numrin e madh të të anketuarve që respektonin ligjet dhe etikën pavarësisht vështirësive ekonomike. Kjo dikotomi nënvizon rëndësinë e trajtimit të shkaqeve bazë të cenueshmërisë ekonomike dhe përmirësimit të mundësive të të ardhurave në mënyrë të ligjshme për të parandaluar joshjen e aktiviteteve të paligjshme dhe rreziqet që lidhen me to.

## Përfundime për nxitësit social-ekonomikë

Në kategorinë ‘nxitësit politikë të ekstremizmit të dhunshëm’ u analizuan në total gjashtë nxitës, tre prej të cilëve janë veçanërisht të rëndësishëm në kontekstin shqiptar: (1) perceptimet e përjashtimit social dhe margjinalizimit; (4) pritshmëritë e dështuara dhe privimi relativ; dhe (6) lakmia ose shtimi i aktiviteteve të paligjshme ekonomike. Ndonëse është me rëndësi të vazhdohet me monitorimin e këtyre nxitësve, (2) rrjetet shoqërore dhe dinamika e grupeve; (3) diskriminimi shoqëror; (5) nevojat e papërbushura sociale dhe ekonomike duket se janë më pak shqetësuese.

Gjetjet për Shqipërinë nxjerrin në pah problematika madhore për shoqërinë, përfshirë këtu edhe pranimin se të rinjtë, në përgjithësi, përfshihen në vese dhe sjellje të rrezikshme (70.5% janë dakord me pohimin). Gjithsesi, pati një përmirësim të dukshëm në këtë perceptim, me një ulje prej më shumë se 10 pikë përqindjeje (p.p.) në pikëpamjet negative në krahasim me sondazhet e mëparshme. Pavarësisht kësaj tendence, të dhënat nxjerrin në pah sfida të mëdha në sektorin e punësimit dhe atë të arsimit. Një përqindje e konsiderueshme (42.5%) e të anketuarve shprehën dyshime për efektivitetin e sistemit arsimor për të siguruar mundësi të mira pune, gjë që theksohet me një rënie prej 7.6 p.p. që nga viti 2021 të optimizimit për perspektivat e punësimit për qytetarët e mirë-arsimuar. Për më tepër, të anketuarit ishin më pak të prirur të besonin se të ardhurat e të rinjve vijnë kryesisht nga puna e ligjshme, krahasuar me vitin 2021 (me rënie prej 15.9 p.p.). Këto tendenca nxjerrin në pah skepticizmin ndaj drejtësisë së tregut të punës, që duket se përkeqësohet nga informaliteti dhe nepotizmi.

Vështirësitë ekonomike kanë sjellë në nivel shqetësues pranimin nga disa shqiptarë të aktiviteteve të paligjshme ekonomike si një rrugë drejt standardeve më të mira të jetesës, me gati 3 në 10 të anketuar që justifikojnë çdo aktivitet ekonomik, të ligjshëm ose jo, për përfitim financiar. Ky dëshpërim apo fleksibilitet moral, më i theksuar mes të anketuarve me nivel të ulët arsimor, rrit cenueshmërinë ndaj rekrutimit nga grupet ekstremiste dhe krimi i organizuar. Megjithatë, shumica ende kundërshton me vendosmëri metodat e paligjshme për përmirësimin e jetesës, duke treguar një qëndrim të palëkundur për respektimin e standardeve etike, pavarësisht vështirësive ekonomike. Kjo dikotomi thekson nevojën urgjente për ndërhyrje që trajtojnë dobësitë ekonomike dhe luftojnë joshjen drejt aktiviteteve të paligjshme.

Niveli relativisht i ulët i besimit tek institucionet dhe diskriminimi shoqëror duhet të monitorohen vazhdimisht. Kjo qasje proaktive është me rëndësi të madhe për të trajtuar dhe luftuar çdo sfidë dhe tendencë që mund të përshkallëzohet drejt ekstremizmit të dhunshëm. Ekstremizmi politik, i identifikuar nga 16.3% e të anketuarve si një shqetësim, eklipsoi shqetësimet për ekstremizmin etno-nacionalist dhe atë fetar, duke evidentuar kështu situatën e tensionuar politike të shënuar nga fushata negative dhe intimidimi i votuesve. Pavarësisht kësaj, ka pasur një rënie me 11 p.p. në perceptimin e ekstremizmit politik që nga sondazhi i vitit 2021, duke sugjeruar një përmirësim të situatës ose marrjen e më shumë masave efektive kundër ekstremizmit. Ndërkohë, shqetësimet etno-nacionaliste (3.5%) dhe ekstremizmi fetar (6.6%) janë më pak të theksuara, por ende të pranishme, ku diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes nxjerrin në pah tendenca të lehta margjinalizimi në shoqëri. Përgjithësisht, perceptimi i të gjitha formave të ekstremizmit ka pësuar një rënie me kalimin e kohës, duke nxjerrë në pah një përparim të mundshëm në luftën kundër këtyre çështjeve.

Nga ana tjetër, mosbesimi ose pakënaqësia me efikasitetin dhe integritetin e institucioneve shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike mbetet i lartë, ku vetëm dy të pestat e të anketuarve i konsiderojnë këto institucione se punojnë në mënyrë profesionale dhe pa abuzime, edhe pse besimi është rritur gradualisht mes viteve 2018 dhe 2023. Prania e grupeve fetare që ofrojnë të mira materiale dhe ekonomike për pjesëmarrjen në to nxjerr në pah shfrytëzimin e dobësive social-ekonomike, ndonëse prania apo prevalenca e raportuar e praktikave të tilla është ulur me 10 p.p. që nga viti 2021. Për më tepër, rritja e lehtë e perceptimit për diskriminim fetar sugjeron se kemi të bëjmë me incidente të izoluara dhe jo tendenca të përhapura, me një mënyrë jetese laike dhe një tendencë në rënie për të lidhur



simbolet fetare me ekstremizmin. Këto gjetje reflektojnë një mungesë të theksuar interesi që e bën të pamundur që besimet fetare të diktojnë stilin e jetës ose angazhimin politik të shqiptarëve. Sidoqoftë, të dhënat nxjerrin në pah rëndësinë e rritjes së transparencës dhe efektivitetit të institucioneve shtetërore dhe trajtimin e dobësive që mund të shfrytëzohen nga grupet që synojnë të radikalizojnë ose rekrutojnë, ndërkohë që evidentohet edhe një tendencë e përgjithshme drejt rënies së ekstremizmit dhe diskriminimit të perceptuar.


## 5.2 Nxitësit politikë

Pjesa më e madhe e nxitësve politikë lidhen me gjendjen e demokracisë, qeverisjen dhe funksionimin e shtetit ligjor në vend. Për këta nxitës, nuk është vetëm gjendja e demokracisë, qeverisjes, dhe shtetit ligjor, por është edhe perceptimi i qytetarëve që ndikon në pakënaqësinë e njerëzve me shtetin dhe institucionet e tij. Në rastin e Shqipërisë, kjo vlen për nxitësit “Mohimi i të drejtave politike dhe liritë civile”, “Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut”, “Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta”, “Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët” dhe “Qeveri të diskretituara apo mungesa ose kooptimi i opozitës ligjore”. Nxitësit “Pushtimi i huaj” dhe “Dhunimi politik dhe/ose ushtarak” nuk përshkruajnë realitetin apo kontekstin aktual në Shqipëri, ndonëse mbetet e rëndësishme të shqyrtohet nëse grupe të caktuara qytetarësh i perceptojnë këta nxitës si të rëndësishëm, për shembull për komunitetin e tyre ose kontekstin lokal.

Nxitësi “Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë” lidhet më së shumti me perceptimet dhe qëndrimet ndaj Perëndimit dhe sistemit ndërkombëtar në përgjithësi. Nxitësit politikë vlerësohen në këtë studim duke përdorur zhvillimet përkatëse që kanë të bëjnë me çështjet në fjalë në Shqipëri dhe që mund të ndikojnë në perceptimet e të anketuarve në përgjithësi (Tabela 3).

*Tabela 3: Nxitësit politikë sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018, 2021*

<b>Mohimi i të drejtave politike dhe liritë civile</b>	Mungesa e të drejtave politike dhe liritë civile dhe ekzistenca e një sistemi politik të mbyllur e të papërgjegjshëm mund të nxisin besimin se dhuna është mjeti i vetëm që sjell ndryshimin politik. Edhe liritë qytetare e të drejtat politike mund të përfaqësojnë një lidhje kritike, por jo përfaqësuese, mes zhvillimit ekonomik dhe cenueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.
<b>Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut</b>	Trajtimi mizor e degradues (përfshirë këtu edhe torturën) i një individit në duart e policisë apo forcave të sigurisë mund të çojë në dëshirën për hakmarrje. Sa më i ashpër e më i përhapur të jetë brutaliteti, aq më e madhe do të jetë nxitja drejt veprimtarive të ekstremizmit të dhunshëm dhe aq më shumë mbështetje do të marrë ekstremizmi i dhunshëm nga komunitetet vendore.
<b>Pushtimi i huaj</b>	Vendet nën pushtimin e huaj ushtarak përballen me rrezikun e kryengritjeve dhe abuzimit me të drejtat. Mbështetja për veprimtaritë e ekstremizmit të dhunshëm mund të vijë nga njerëz që duan të hakmerren për turpërimin që u është bërë atyre personalisht ose komunitetit të tyre.



<b>Dhunimi politik dhe/ose ushtarak</b>	Ndërhyrja politike apo ushtarake në shkallë të gjerë në punët e brendshme mund të shërbejë si element bashkues, ku komuniteti i kthehet dhunës për të rikthyer nderin individual dhe kolektiv. Në komunitetet që historikisht kanë pasur shkallë të lartë autonomie dhe vetë-rregullimi, ka gjasa të ketë rezistencë të fortë.
<b>Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta</b>	Ky nxitës shkakton të paktën pasivitet qytetar e apati politike dhe mund të ushqejë një ndjesi të madhe të dhunës morale. Sa më i korruptuar të jetë mjedisi, aq më të lehtë e kanë grupet e ekstremizmit të dhunshëm të shpallin veten si alternativa e drejtë dhe t'i kundërvihen elitave të pamoralshme qeverisëse.
<b>Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët</b>	Këto zona janë të izoluara, rajone me dendësi të ulët popullsie që përbëjnë vatra të sigurta ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të krijohen pa pengesa të mëdha dhe, madje, të marrin mbështetje nga komunitetet e lëna në harresë nga qeveria.
<b>Qeveri të diskredituara apo mungesa ose kooptimi i opozitës ligjore</b>	Kur një regjim diskreditohet krejtësisht dhe nuk ka opozitë të shëndetshme, ata që duan të kundërshtojnë qeverinë dhe të prezantojnë reforma do të shtyhen përtej kanaleve normale politike dhe mund të mbështesin grupet e ekstremizmit të dhunshëm.
<b>Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm</b>	Aty ku qeveritë nuk mund t'u japin qytetarëve të tyre mbrojtje dhe siguri, grupet e ekstremizmit të dhunshëm do të përdorin frikën dhe kërcënimin për të siguruar me anë të forcës mbështetje për lëvizjen e tyre.
<b>Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë</b>	Popullsia mund të pranojë propagandën e ekstremizmit të dhunshëm se sistemi botëror politik dhe ekonomik diskriminojnë botën myslimane, gjë që mund të ngatërrohet me ndjenjat personale ose komunitare të diskriminimit.

Lista e raportuar në Tabelën 3 nuk është shteruese. Nxitësit politikë nuk veprojnë të izoluar nga njëri-tjetri apo nga nxitës të tjerë brenda kategorive kulturore dhe social-ekonomike. Gjithsesi, Denoëux dhe Carter (2009) argumentojnë se këta nxitës politikë shpesh sigurojnë mjedisin mundësues për ekstremizmin e dhunshëm:

“Një apo disa nga këta nxitës politikë mund të ndërthuren ngushtësisht me disa nga nxitësit socialë dhe ekonomikë që u trajtuan më sipër. Për shembull, korrupsioni mund të dobësojë gradualisht kapacitetin e shtetit duke dëmtuar aftësinë e qeverisë për t'u përballur me përjashtimin social, i cili, siç u diskutua edhe më sipër, shpesh nxit ekstremizmin e dhunshëm.”<sup>42</sup>

42 Denoëux, G. and Carter, L. (2009). Udhëzues për nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm (Guide to the drivers of violent extremism). USAID. p. 27. Marrë nga: [https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/Pnadt978.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnadt978.pdf)



Prandaj është e rëndësishme të kuptojmë mjedisin e gjerë politik duke analizuar ndikimin e nxitësve në këtë kategori si dhe ndërveprimin e tyre me nxitësit e tjerë dhe faktorët kontekstualë që përcaktojnë realitetin shqiptar. Vlerësimi i demokracisë në Shqipëri nuk ka ndryshuar krahasuar me vlerësimet e mëparshme të nxitësve, formave dhe rreziqeve të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Shqipëria konsiderohet ende “pjesërisht e lirë”, duke shënuar 28 nga 40 pikë për respektimin e të drejtave politike dhe 40 nga 60 pikë për liritë civile.<sup>43</sup>

Për më tepër, vlerësimi i përgjithshëm i demokracisë në vend ka rënë nga 47.02 në 46.43 (nga 100 të mundshme) në tre vitet e fundit. Në vitin 2022, demokracia shqiptare u përball me sfida të mëdha, veçanërisht gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme në gjashtë bashki në muajin mars, dhe nëpërmjet ristrukturimeve të partive politike dhe përpjekjeve për bashkëpunim ndërpartiak. Shumë nga udhëheqësit politikë të Shqipërisë treguan mungesë mbështetjeje për vlerat themelore demokratike, veçanërisht për rëndësinë e barazisë para ligjit dhe shtetit të së drejtës. Partitë politike shpesh kontrolloheshin nga liderë autoritarë, fakt që u reflektua në mënyrën se si u përzgjedhën drejtuesit vendorë të partive dhe në përgatitjet për zgjedhjet e rregullta vendore të majit 2023.<sup>44</sup> Më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar mendojnë se mungon transparenca si në qeverinë qendrore ashtu edhe në atë vendore. Në vitin 2023, partitë politike, parlamenti, gjyqësori dhe organet e prokurorisë u identifikuan si institucionet me nivelin më të ulët të besimit të publikut.<sup>45</sup>

Procesi i pranimit të Shqipërisë në BE është aktualisht në një fazë të rëndësishme pas përfundimit të takimeve të procesit të shqyrtimit. Qeveria shqiptare kishte shpresuar të niste negociatat për grupin e parë deri në fund të vitit 2023, por kjo u shty për gjysmën e parë të këtij viti, në pritje të përmbushjes së standardeve të hapjes. Që të fillojnë negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, duhet të përmbushen disa standarde, veçanërisht brenda grupit të parë mbi aspektet themelore. Këto standarde janë të lidhura me fushat e gjyqësorit dhe të drejtave themelore, korrupsionit, krimit të organizuar dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtat e pakicave dhe lirinë e shprehjes.<sup>46</sup>

Kësisoj, gjetjet e këtij studimi për ndikimin e nxitësve politikë në kontekstin e ekstremizmit të dhunshëm nuk përbëjnë surprizë duke pasur parasysh përparimin e Shqipërisë me një ritëm të ngadaltë drejt konsolidimit të shtetit ligjor, vonesat në zbatimin e reformës në gjyqësor, mungesën e dëshmimeve të qëndrueshme për ndëshkimin me sukses të korrupsionit të nivelit të lartë dhe, së fundmi, por jo më pak të rëndësishme, tendencën e vazhdueshme të mosbesimit të publikut tek institucionet. Në pjesën e mëposhtme të këtij seksioni shtjellohen gjetjet për secilin prej nxitësve politikë bazuar në sondazhin me përfaqësim kombëtar.

## Mohimi i të drejtave politike dhe liritë civile

Gjetjet nga Raporti i të Drejtave të Njeriut për Shqipërinë i Departamentit Amerikan të Shtetit<sup>47</sup> për vitin 2022 evidentojnë disa shqetësime që tregojnë në mënyrë të tërthortë problemet me të drejtat politike dhe liritë civile, si korrupsioni në sektorë të ndryshëm, mungesa e medias

43 Freedom House. (2024). Raporti për Shqipërinë “Liria në botë” (Freedom of the World 2021 report for Albania). Marrë nga: <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2024>

44 Freedom House (2023). Raporti për Shqipërinë 2023 ‘Kombet në tranzicion’ (Nations in Transit 2023 report for Albania). Marrë nga: <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2023>

45 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2023). Sondazh i opinionit publik ‘Besimi në qeverisje 2023’. Marrë nga: <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>

46 Komisioni Evropian, (2023). Albania Report 2023. Marrë nga: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023\\_en#details](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en#details)

47 Departament Amerikan i Shtetit, 2022 Raporti për praktikat e të drejtave të njeriut në Shqipëri, <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

së pavarur dhe çështjet e pavarësisë dhe integritetit të gjyqësorit. Këto probleme pengojnë ushtrimin e plotë të lirive politike dhe të drejtave civile, duke kontribuar potencialisht në një mjedis ku sistemi politik mund të duket sikur nuk i përgjigjet nevojave të publikut. Liritë civile dhe të drejtat politike mund të përfaqësojnë një lidhje të rëndësishme, por jo përfaqësuese, mes zhvillimit ekonomik dhe cenueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Si e tillë, kjo klimë mund t'i japë rrugë besimit se dhuna është e vetmja mundësi për ndryshim politik.

#### Pohimet për këtë nxitës:


- Përgjithësisht, të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore.
- Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja.

**Pohimi:** Përgjithësisht, të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me 4 pikë nga “aspak dakord” (1) në “plotësisht dakord” (4). Pothuajse gjysma e të anketuarve (49.2%) janë dakord me pohimin, ndërsa 47.4% treguan se kanë këtë mendim. Përqindja e mbështetjes ndaj këtij pohimi mbetet e njëjtë si në vitin 2021, kur 48.9% e të anketuarve ishin dakord me të.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit e grupmoshës 55-64 vjeç (55%), ata që kanë përfunduar arsimin pasuniversitar (59%) dhe ata që janë mbështetës të partisë në pushtet, Partisë Socialiste (77%), priren më shumë të jenë dakord me pohimin. Nuk vihen re dallime të mëdha kur analizojmë përgjigjet sipas demografisë së besimtarëve.

Grafiku 21. Të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore (N=1600)




**Pohimi:** Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja.



46.3% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 48.2% prirën të mos mendojnë kështu. Krahasuar me vlerësimet e mëparshme, tendenca për të rënë dakord me pohimin se sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë, tregon një kthim të lehtë drejt niveleve të vitit 2018, me një rënie të vogël nga 47.7% në 46.3%, gjë që tregon një këndvështrim relativisht të qëndrueshëm të të anketuarve ndër vite.

Të anketuarit e moshës 35-44 vjeç (53%), ata që janë të papunë (57%), mbështetësit e Partisë Demokratike (58%) dhe Grupit të Rithemelimit të PD-së (63%) prirën më shumë të jenë dakord me pohimin. Të anketuarit që u identifikuan si ateistë (57%), dhe të anketuarit që luten/falën rregullisht (50%) janë më të prirur të jenë dakord me pohimin.

Grafiku 22. Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja (N=1600)



Po të kemi parasysh se mungesa e të drejtave politike dhe lirive civile, së bashku me sistemet politike të mbyllura dhe të papërgjegjshme, mund të çojnë në besimin se dhuna është mjete i vetëm për ndryshim politik, rezultatet e sondazhit për këtë nxitës janë shqetësuese. Të dhënat sugjerojnë se gati gjysma e të anketuarve (49.2%) besojnë se të drejtat dhe liritë e tyre respektohen nga institucionet shtetërore, gjë që tregon një perceptim disi të ndarë të respektit të shtetit për liritë civile. Ky nivel dakordësie ka mbetur i qëndrueshëm që nga viti 2021, duke sugjeruar se nuk ka pasur ndonjë ndryshim të rëndësishëm në perceptimin e publikut për të drejtat dhe liritë gjatë vitit të kaluar.

Për më tepër, përqindja e dakordësisë në lidhje me domosdoshmërinë për ndryshime potencialisht të dhunshme në sistemin politik për shkak të padrejtësisë së perceptuar është 46.3%, ku kemi një rënie të lehtë në krahasim me sondazhin e mëparshëm. Kjo tregon se një pjesë e qëndrueshme, por e konsiderueshme, e popullsisë beson se sistemi aktual politik është i padrejtë dhe mund të nevojiten masa drastike për ndryshim. Ky këndvështrim sugjeron një lidhje mes shtypjes së të drejtave politike dhe lirive civile dhe prirjes drejt ekstremizmit të dhunshëm.

### Shtypja e pamëshirshme nga qeveria dhe shkelja flagrante e të drejtave të njeriut

Trajtimi mizor e degradues (përfshirë këtu edhe torturën) i një individi në duart e policisë apo forcave të sigurisë mund të çojë në dëshirën për hakmarrje. Sa më i ashpër e më i përhapur të jetë brutaliteti, aq më e madhe do të jetë nxitja drejt veprimtarive të ekstremizmit



të dhunshëm dhe aq më shumë mbështetje do të marrë ekstremizmi i dhunshëm nga komunitetet vendore.

#### Pohimet për këtë nxitës:

- Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë.
- Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore.


**Pohimi:** Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë

Sipas 20% të të anketuarve, institucionet e zbatimit të ligjit janë më të ashpra me besimtarët myslimanë që praktikojnë fenë. Megjithatë, 56.1% nuk janë dakord ose aspak dakord me këtë pohim, ndërsa 23.9% e konsiderojnë atë si pa lidhje ose nuk dinë të japin përgjigje.

Në vitin 2023, përqindja e të anketuarve që i perceptojnë institucionet e zbatimit të ligjit si më të ashpra ndaj myslimanëve praktikantë u ul pak në krahasim me shifrën e vitit 2021, me 2.7 p.p., ndonëse mbeti dukshëm më e lartë se në vitin 2018 me 6.8 p.p., duke evidentuar kështu një shqetësim në rritje gjatë kësaj periudhe për trajtimin e diferencuar nga forcat e zbatimit të ligjit.

Të anketuarit pa arsim (34%), mbështetësit e Partisë së Lirisë (32%), ata që janë të vetëpunësuar (26%) ose të papunë (27%) priren më shumë të jenë dakord me pohimin. E njëjta gjë vlen edhe për të anketuarit që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (31%) dhe që luten/falen çdo ditë apo javë (28%).

**Grafiku 23.** Institucionet ligjzbatuese janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë (N=1600)




**Pohimi:** Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore.



Kur u pyetën nëse njerëzit kishin të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen të drejtat dhe liritë nga institucionet shtetërore, 41.2% e të anketuarve janë dakord me këtë pohim, ndërsa 51.2% e të anketuarve nuk janë dakord. Gjetjet e vitit 2023 shënuan një rritje prej 6.1 p.p. për këtë pohim, krahasuar me përqindje e dakordësisë prej 35.1% në 2021 dhe pak mbi nivelin prej 35.8% në 2018.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit me arsim më pak se fillor (49%), ata që janë të papunë (50%) ose të vetëpunësuar (47%) kanë më shumë gjasa të jenë dakord me pohimin. Mbështetësit e partive opozitare si Partia e Lirisë (62%), Grupi i Rithemelimit të PD-së (55%) dhe Partia Demokratike (51%) janë më shumë të prirur të jenë dakord me këtë pohim. E njëjta gjë vlen edhe për të anketuarit që janë bektashinj (52%), si dhe ata që respektojnë festat fetare gjatë një viti normal (50%).

Grafiku 24. Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore (N=1600)



Trajtimi i ashpër dhe poshtërues nga policia ose forcat e sigurisë mund të nxisë një cikël hakmarrjeje, që me gjasa përshkallëzohet në ekstremizëm të dhunshëm dhe që fiton mbështetje te komunitetet vendore për veprime të tilla. Për të trajtuar çështjen e mosndëshkimit të policisë, në shkurt të vitit 2022 u krijua një Agjenci e pavarur e Mbikëqyrjes Policore, e ndarë nga Policia e Shtetit, e ngarkuar me detyrën e kryerjes së hetimeve dhe për t'u siguruar që zyrtarët e organeve ligjzbatuese të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Kjo nismë ka rezultuar në një numër të konsiderueshëm hetimesh si dhe arrestime e pezullime, duke treguar përkushtimin e qeverisë për të ulur numrin e abuzimeve brenda forcave të sigurisë.

Gjithsesi, rreth 1 në 5 të anketuar i perceptojnë institucionet e zbatimit të ligjit si më të ashpra ndaj myslimanëve praktikantë – një rënie e lehtë që nga viti 2021, por ende dukshëm më e lartë se ajo e vitit 2018, duke treguar një shqetësim në rritje me kalimin e kohës në lidhje me trajtimin e diferencuar nga forcat e zbatimit të ligjit. Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme, mbi 2 në 5 të anketuar, besojnë se kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat, duke shënuar një rritje të dukshme nga viti 2021 dhe 2018. Kjo sugjeron një zhgënjim në rritje me aftësinë e institucioneve shtetërore për të mbrojtur dhe respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

*Të anketuarit pa arsim, të vetëpunësuarit, të papunët, mbështetësit e Partisë së Lirisë dhe ata që praktikojnë rregullisht ritet fetare priren më shumë t'i konsiderojnë forcat e zbatimit të ligjit si më të ashpra ndaj myslimanëve praktikantë. Po ashtu, të anketuarit me nivel të ulët arsimor, të papunët, të vetëpunësuarit dhe mbështetësit e partive opozitare, së bashku me bektashinjtë dhe ata që luten/falen gjatë festave fetare, janë më shumë të prirur të mbështesin idenë e vetëgjyqësisë.*

## Pushtimi i huaj

Vendet nën pushtimin e huaj – edhe nëse kjo perceptohet si pushtim vetëm nga grupe të caktuara – përballen me rrezikun e kryengritjeve dhe abuzimit me të drejtat. Mbështetja për veprimtaritë e ekstremizmit të dhunshëm mund të vijë nga njerëz që duan të hakmerren për turpërimin që u është bërë atyre personalisht ose komunitetit të tyre. Edhe pse ky nxitës nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me situatën në Shqipëri, përfshirja e këtyre pyetjeve – dhe më gjerësisht të dy nxitësve “pushtimi i huaj” dhe “dhunimi politik/ushtarak” – na ndihmon të vlerësojmë mbështetjen e qytetarëve për ndryshimet që iu bënë Kodit Penal në vitin 2014, ndryshime që kriminalizuan veprat e pjesëmarrjes, financimit, dhe rekrutimit për konfliktet e armatosura jashtë kufijve të vendit.

### Pohimet për këtë nxitës:

- Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura nuk duhet lejuar.
- Përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët.

**Pohimi:** Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura nuk duhet lejuar.


Të anketuarve iu kërkua të deklaroheshin nëse ishin dakord që përfshirja apo nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura jashtë vendit nuk duhet lejuar. Në vitin 2023, 64.6% e të anketuarve thanë se ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ndërsa 23.3% nuk ishin dakord ose aspak dakord.

Mes viteve 2021 dhe 2023, përqindja e të anketuarve që janë dakord se nxitja ose përfshirja në konflikte të armatosura jashtë vendit nuk duhet lejuar u ul me 11.4 pp nga 76% që ishte, duke reflektuar një rënie të mbështetjes për ndalimin e pjesëmarrjes së civilëve në konflikte të armatosura jashtë vendit.

Të anketuarit e grupmoshës 45-54 vjeç (70%) dhe ata që janë të punësuar (70%) janë më shumë të prirur të jenë dakord se nxitja ose përfshirja e civilëve në konfliktet e armatosura jashtë vendit nuk duhet lejuar. Mbështetësit e Grupit të Rithemelimit të PD-së (73%) priren më shumë të kenë të njëjtin mendim, duke treguar se janë grupi më pak i mundshëm për të mbështetur përfshirjen e civilëve në konflikte të armatosura jashtë vendit.



Grafiku 25. Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura nuk duhet lejuar. (N=1600)




**Pohimi:** Përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët.

13.4% e të anketuarve e mbështesin këtë pohim, ndërsa 64.9% e të anketuarve nuk janë dakord ose aspak dakord. 9.4% treguan se ky pohim është pa lidhje dhe 12.4% refuzuan apo nuk dhanë përgjigje. Mes viteve 2021 dhe 2023, dakordësia me pohimin ra me 8.4 pp (me 21.8% që ishin dakord në 2021), duke pasqyruar pothuajse të njëjtin nivel me 2018 (kur 13% ishin dakord).

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, mbështetësit e Partisë së Lirisë (24%) dhe Partisë Demokratike (20%) ishin më shumë të prirur të shprehnin dakordësinë me pohimin. Të anketuarit që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare (20%) kanë më shumë gjasa të jenë dakord se përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan dhe Irak ishte një fyerje për myslimanët.

Grafiku 26. Përfshirja e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak ishin një fyerje për myslimanët. (N=1600)



Perceptimet e marra nga përgjigjet për këtë sondazh hedhin dritë mbi qëndrimet në përgjithësi dhe motivet e mundshme për qëndrimin e të anketuarve në lidhje me pjesëmarrjen në konfliktet e huaja. Me 64.6% që janë kundër përfshirjes së civilëve shqiptarë në konfliktet jashtë vendit, ekziston një konsensus i theksuar kundër një përfshirjeje të tillë. Gjithsesi, është e rëndësishme të kuptohet se si ndjenjat e pashprehura për misionet ushtarake ndërkombëtare dhe perceptimi për implikimet e tyre me bazë fetare dhe kulturore mund të bëjnë që individë të caktuar të kenë prirjet për përfshirje në konflikte aktive jashtë vendit. Edhe pse vetëm 13.4% e shohin pjesëmarrjen ushtarake të Shqipërisë si fyese për myslimanët, në perspektivat e shqiptarëve për konfliktet ndërkombëtare dhe përfshirjen e tyre të mundshme mund të ndikojnë në mënyrë të ndërlikuar faktorët politikë, ekonomikë ose fetarë.

## Dhunimi politik/ushtarak

Në këtë nxitës vlerësojmë sa mundësi ka propaganda ekstremiste të sigurojë mbështetje nëpërmjet nevojës së perceptuar për rikthimin e dinjitetit ose ideologjisë fetare në përgjithësi. Ndërhyrja politike apo ushtarake në shkallë të gjerë në punët e brendshme mund të shërbejë si element bashkues, ku komuniteti i kthehet dhunës për të rikthyer nderin individual dhe kolektiv.


### Pohimet për këtë nxitës:

- ➔ Çdo qytetar duhet të mbrojë ideologjinë e tij/saj me çdo mjet dhe çmim.
- ➔ Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht.

**Pohimi:** Çdo qytetar duhet të mbrojë ideologjinë e tij/saj me çdo mjet dhe çmim.

26.2% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ndërkohë që shumica prej 63.8% e të anketuarve nuk ishin dakord. Kur bëjmë krahasim me gjetjet e vitit 2021, ka një rënie me 6.1 p.p. në përqindjen e të anketuarve që janë dakord me pohimin, nga 32.3% në 26.2%.

Grafiku 27. Çdo qytetar duhet të mbrojë ideologjinë e tij/saj me çdo mjet dhe çmim. (N=1600)



Të anketuarit e moshës 18-24 vjeç (32%) dhe ata që janë të vetëpunësuar (32%) kanë më shumë gjasa të shprehin dakordësinë me pohimin se çdo qytetar duhet të mbrojë ideologjinë e tij/saj me çdo mjet dhe çmim. Mbështetësit e partive opozitare si Partia e Lirisë (42%), Partia Demokratike (36%) dhe Grupi i Rithemelimit së PD (35%) janë më të prirur për të rënë dakord me këtë.


**Pohimi: Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht.**

Të pyetur për aspektin fetar, nëse është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e tij fetar me çdo çmim dhe kusht, 26.4% u shprehën dakord me pohimin. 64.4% e të anketuarve ose nuk ishin dakord ose u shprehën aspak dakord.

Kjo shënon një rënie të vazhdueshme të mbështetjes për pohimin në lidhje me detyrën e çdo besimtari për të mbrojtur vlerat dhe dinjitetin e tij fetar me çdo çmim dhe kusht, me një rënie prej 7.8 p.p. nga 34.2% në 2021 në 26.4% në sondazhin e fundit dhe një rënie totale prej 14.2 p.p. nga 40.6% në 2018.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, ata me arsim më të ulët se ai fillor (32%), ata që janë të vetëpunësuar (36%) dhe mbështetësit e Partisë së Lirisë (47%), Grupit të Rithemelimit të PD-së (43%) dhe Partisë Demokratike (40%) janë më shumë të prirur të shprehen dakord me pohimin. Mes besimtarëve, ata familjet e të cilëve i përkasin besimit ortodoks (34%), që identifikohen si ortodoksë (35%) dhe praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (47%), priren më shumë të bien dakord se është detyrë e çdo besimtari të mbrojnë vlerat dhe dinjitetin e tyre fetar me çdo çmim dhe kusht.

**Grafiku 28. Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo çmim dhe kusht. (N=1600)**



*Gjetjet e sondazhit tregojnë se rreth një në katër të anketuar janë dakord me detyrën për të mbrojtur ideologjinë dhe dinjitetin fetar me çdo kusht. Konkretisht, 26.2% besojnë se është detyrë e çdo qytetari të mbrojë ideologjinë e tij me çdo mjet, një rënie në krahasim me sondazhet e mëparshme, ndërkohë që po një përqindje pothuajse e ngjashme (26.4%) është dakord me detyrën e çdo besimtarit për të mbrojtur vlerat dhe dinjitetin e tij fetar me çdo kusht, ku edhe këtu kemi një rënie të përqindjes. Kjo prirje sugjeron një ngurrim në rritje tek popullata e gjerë për të mbështetur dhunën për arsye ideologjike ose fetare.*

*Të rinjtë, të vetëpunësuarit dhe mbështetësit e partive të ndryshme opozitare, veçanërisht nga partitë opozitare, si Partia e Lirisë, Partia Demokratike dhe Grupi i Rithemelimit të PD-së, janë më shumë të prirur për të qenë dakord me këto pohime. Përveç kësaj, edhe të anketuarit që praktikojnë ritet e fesë së krishterë ortodokse priren të mbështesin nocionin e mbrojtjes së ideologjisë dhe dinjitetit fetar me çdo kusht.*

## Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta

Beteja e Shqipërisë kundër korrupsionit ka pasur zhvillime të rëndësishme, veçanërisht me ndjekjen penale të rasteve të profilit të lartë si ai i njërit prej ish-kryeministrave (PD) <sup>48</sup>, ish-zëvendëskryeministrit (PS) <sup>49</sup> dhe i ish-Ministrit të Mjedisit. <sup>50</sup> Në vitin 2024, qeveria shqiptare ndërmoi një hap të rëndësishëm me krijimin e postit të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, duke sinjalizuar kështu një përpjekje për të trajtuar korrupsionin në të gjithë sistemin. <sup>51</sup> Raporti i fundit i Transparency International njih edhe përparimet e bëra, duke theksuar se përparimi i mëtejshëm thelbësor varet nga forcimi i legjislacionit të drejtësisë penale dhe sigurimi i mbikëqyrjes efektive të degës ekzekutive. Megjithatë, raporti e rendit Shqipërinë në vendin e 98-të nga 180 shtete, me një rezultat prej 37 pikësh nga 100 të mundshme <sup>52</sup>, duke reflektuar kështu sfidat e vazhdueshme të korrupsionit që përshtojnë sektorin publik dhe atë privat.

Duke pasur parasysh këtë kontekst, realiteti i shkëputjes dhe i apatisë politike në Shqipëri nuk sjell çudira. Gjithsesi, ky realitet mund të nxisë një ndjenjë zemërate morale. Edhe pse në Shqipëri kjo nuk është aq serioze sa në vendet e goditura rëndë nga konfliktet, është me rëndësi të shqyrtohen angazhimi qytetar dhe pakënaqësia e mundshme me politikën dhe qeverisjen: sa më i korruptuar të jetë mjedisi, aq më të lehtë e kanë grupet e dhunshme të shpallen si alternativë e drejtë dhe të godasin elitat qeverisëse imorale.

48 Reuters, 'Albanian prosecutors charge former Prime Minister Sali Berisha in corruption probe', 22 October 2023, marrë nga <https://www.reuters.com/world/europe/albanian-prosecutors-charge-former-pm-berisha-corruption-probe-2023-10-22/>.

49 Tirana Times, 'Nga mërgimi, ish-zëvendëskryeministri i Shqipërisë akuzon për korrupsion masiv në krye të udhëheqjes së PS-së, 6 shkurt 2024, marrë nga <https://www.tiranatimes.com/?p=154290>.

50 Gjergj Erebara, BIRN, 'Ish-Ministri i Mjedisit në Shqipëri burgoset për korrupsion', 25 shtator 2023, marrë nga <https://balkaninsight.com/2023/09/25/albania-former-minister-sentenced-for-corruption/>.

51 Euronews Albania, 'Presidenti dekreton Ministrin e ri të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin', 15 janar 2024, marrë nga <https://euronews.al/en/president-decrees-new-state-minister-for-public-administration-and-anticorruption/>.

52 Transparency International, '2023', marrë nga <https://www.transparency.org/en/cpi/2023/index/alb>.



**Pohimet për këtë nxitës:**


- Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime, në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi.
- Vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara.
- Pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi.

**Pohimi:** Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime, në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi.

Në vitin 2023, 30% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ndërkohë që 41.6% e kundërshtonin atë. Kur bëjmë krahasim me vitin 2021, përqindja e të anketuarve që besojnë se në Shqipëri do të kishte më shumë drejtësi nëse më shumë njerëz do të ishin besimtarë të fesë së të anketuarve ra me 8 p.p., nga 38.0% në 30%. Kjo rënie vjen pas një rritje të vogël prej 2.5 p.p. në 2021, gjë që tregon një zhvendosje të kohëve të fundit në opinionin e të anketuarve larg këtij besimi.

Të anketuarit me arsim më të ulët se ai fillor (46%) dhe mbështetësit e Partisë Demokratike (38%), Grupit të Rithemelimit të PD-së (35%) dhe Partisë së Lirisë (35%) janë më shumë të prirur të jenë dakord me këtë pohim. Ata që i përkasin besimit katolik (40%) dhe ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare (54%) kanë më shumë gjasa të jenë dakord se Shqipëria do të kishte më shumë drejtësi nëse më shumë njerëz do të ishin të fesë së tyre (të të anketuarve).

**Grafiku 29.** Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime, në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi. (N=1600)




**Pohimi:** Vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara.



Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Në vitin 2023, 32.4% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ndërkohë që 42.3% e të anketuarve e kundërshtonin atë. Në po këtë vit pati një rënie me 5.9 pp në përqindjen e të anketuarve që ishin dakord se vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara, rënie prej 38.3% në 2021.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit mbi 65 vjeç (43%) dhe ata me nivel arsimor më të ulët se ai fillor (54%) shfaqën prirje më të madhe për të rënë dakord me pohimin. Të anketuarit që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (55%), ata që nuk luten/falen kurrë (46%) dhe ata që luten/falen rregullisht (46%) priren më shumë të thonë se vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara.

Grafiku 30. Vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara. (N=1600)




**Pohimi:** Pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 40.9% e të anketuarve besojnë se pandëshkueshmërisë së njerëzve me poste të larta në Shqipëri po i vjen fundi gjithnjë e më shumë, ndërsa më shumë se gjysma e kampionit – 53% – nuk ishin dakord ose aspak dakord. 6.1% e të anketuarve e konsiderojnë këtë pohim si pa lidhje ose u përgjigjen duke zgjedhur opsionin “Nuk e di”.

Të anketuarit me arsim fillor (47.5%) dhe ata që mbështesin Partinë Socialiste (61.8%) priren më shumë të jenë dakord me pohimin “Pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi”.



Grafiku 31. Pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi. (N=1600)



Gjetjet e sondazhit tregojnë se 30% besojnë se në Shqipëri do të kishte më shumë drejtësi nëse më shumë njerëz do të ishin të fesë së të anketuarve, duke vënë në dukje një rënie të lehtë nga vitet e mëparshme. Kjo pikëpamje është më e përhapur tek ata me nivel të ulët arsimor dhe besimtarët e fesë katolike. Për më tepër, 32.4% janë dakord se vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara, ndonëse këtu kemi një rënie të dakordësisë, gjë që sugjeron skepticizëm në rritje në lidhje me korrelacionin mes besimit fetar dhe integritetit të qeverisë. Pavarësisht optimizmit modest, ku 40.9% besojnë se kohës së pandëshkueshmërisë së zyrtarëve të lartë po i vjen fundi, pjesa më e madhe e të anketuarve mbetet skeptikë, duke theksuar mendimin e tyre kritik mbi efektivitetin e masave të fundit kundër korrupsionit. Përtej ndarjeve demografike, ekziston një tendencë e dukshme ku të anketuarit me më pak arsim dhe praktikantë të rregullt të fesë janë më të prirur të besojnë në ndikimin e fesë në drejtësi dhe potencialin për tejkalimin e korrupsionit qeveritar.

### Zona të paqeverisura ose të qeverisura dobët

Zonat me dendësi të ulët popullore zakonisht mund të përbëjnë vatra të sigurta ku grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të krijohen pa pengesa të mëdha dhe, madje, të marrin mbështetje nga komunitetet e lëna në harresë nga qeveria. Grupet e ekstremizmit të dhunshëm mund të tërhiqen drejt “shteteve me forcë të kufizuar”, në krahasim me shtetet e dështuara apo në dështim e sipër, ku mund të sigurojnë infrastrukturën e nevojshme për të zhvilluar rrjetin e tyre dhe për të kryer veprimtarinë e tyre. Ndonëse zonat e izoluar që janë të qeverisura dobët apo të paqeverisura nuk janë problem në Shqipëri, në këtë studim përqipemi të vlerësojmë rëndësinë dhe shtrirjen e “shtetit si ofruar shërbimi” dhe që ka në qendër qytetarin në perceptimet e shqiptarëve. Pohimet ndihmojnë të përcaktojmë rreziqet nga propaganda e mundshme të ekstremizmit të dhunshëm por edhe të hapësirës për grupet e tilla për të mbushur çdo boshllëk në ofrimin e shërbimeve publike cilësore në zona të caktuara. Përveç kësaj, gjetjet hedhin dritë mbi praninë e shtetit në zonat rurale si dhe perceptimet e publikut për nevojën për të monitoruar aktivitetet fetare në Shqipëri.

**Pohimet për këtë nxitës:**


- Në zonën ku banoj vërehet më shumë prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët
- Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti.

**Pohimi:** Në zonën ku banoj vërehet më shumë prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët.

Në vitin 2023, 62.3% e të anketuarve ishin dakord me këtë pohim, ndërsa 32.8% e kundërshtonin atë. Mbështetja për këtë pohim ka rënë paksa me 1.9 p.p. nga 64.2% në vitin 2021, që vjen pas një rënieje më të madhe me 6 p.p. nga 2018 në 2021.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, studentët (67%) priren më shumë të jenë dakord me pohimin. Mbështetësit e partive opozitare, si shumica e të anketuarve që mbështesin Partinë e Lirisë (71%) dhe Grupin e Rithemelimit të PD-së (70%) janë më shumë të prirur ta shohin shtetin si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve publike për qytetarët në zonën ku banojnë.

**Grafiku 32.** Prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët (N=1600)




**Pohimi:** Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Në 2023, 28.5% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ndërsa shumica prej 57.9% e të anketuarve e kundërshtonin këtë pohim. Niveli i dakordësisë me pohim ka rënë me 9.2 p.p., nga 37.7% që ishte në vitin 2021.



Të anketuarit e moshës 35-44 vjeç (35%), ata pa arsim ose nivel të ulët arsimor (47%) dhe ata që mbështesin Partinë e Lirisë (41%) janë pak më të prirur të jenë dakord me pohimin. Tek besimtarët fetarë, ungjillorët (67%) si dhe ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (39%) janë gjithashtu më të prirur të jenë dakord me këtë pohim.

Grafiku 33. Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti. (N=1600)



Një shumicë e konsiderueshme e shqiptarëve e shohin shtetin më shumë në prizmin e zbatimit të ligjit sesa si një ofrues të shërbimeve bazë për qytetarët, me 62.3% që janë dakord me këtë perspektivë. Ndonëse tek të anketuarit mbizotëron pikëpamja se roli i shtetit është kryesisht ligjzbatues, niveli i dakordësisë ka rënë paksa që nga viti 2021. Në aspektin demografik, studentët dhe mbështetësit e partive opozitare janë më shumë të prirur ta perceptojnë shtetin në këtë rol.

Lidhur me mbikëqyrjen e aktiviteteve fetare nga shteti, më pak se një e treta e të anketuarve shprehën dakord se aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti, duke reflektuar kështu një rënie të konsiderueshme të dakordësisë që nga viti 2021 dhe duke treguar se gjithnjë e më shumë njerëz e mbështesin përfshirjen e shtetit në çështjet fetare. Megjithatë, është me rëndësi të pranohet se interpretimet individuale të pohimit "Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti" ndikohen nga një matricë faktorësh, përfshirë këtu përvojat personale, prejardhjen kulturore dhe klimën politike që mbizotëron në vend. Përgjigjet për këtë pohim mund të ndryshojnë ndjeshëm. Një pjesë e të anketuarve mund të mbrojnë parimin e qeverisjes laike, duke theksuar rëndësinë e një qeverie që i harton ligjet dhe politikën e saj duke u mbështetur në arsytim, barazi dhe parimet universale dhe jo tek ideologjitë fetare. Nga ana tjetër, të anketuarit e tjerë mund ta perceptojnë këtë pohim si shkelje të drejtpërdrejtë të lirisë së tyre fetare, duke e interpretuar atë si një rrezik potencial për shprehjet e besimit fetar, siç është detyrimi për heqjen e simboleve fetare në institucionet publike apo ato arsimore.

Kjo perspektivë ndryshon sipas grupmoshave të ndryshme, nivelit arsimor dhe përkatësisë politike, ku ata të moshës 35-44 vjeç, ata me nivel të ulët arsimor ose pa arsim fare dhe mbështetësit e Partisë së Lirisë tregojnë një prirje më të madhe për të kundërshtuar mbikëqyrjen e shtetit të aktiviteteve fetare. Edhe besimtarët ungjillorë dhe ata që ushtrojnë rregullisht të gjitha ritet fetare gjithashtu një preferencë të konsiderueshme për më pak ndërhyrje të shtetit në aktivitetet fetare.

## Qeveri të diskredituara apo mungesa ose kooptimi i opozitës ligjore

Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2023 në Shqipëri u zhvilluan kryesisht pa probleme, ndonëse u vunë në dukje problematika të tilla si përdorimi i burimeve shtetërore për fushatë partiake, raportime për kërcënimin e votuesve dhe punonjësve të administratës publike dhe akuza për blerje votash. Zgjedhjet dukshëm patën një shkallë të ulët pjesëmarrjeje me vetëm 38.2% të votuesve. Për më tepër, në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2023 për Shqipërinë vihej në dukje polarizimi i vazhdueshëm politik, përkundër përçarjeve të njëpasnjëshme brenda partisë kryesore të opozitës, Partisë Demokratike (PD).

Ky nxitës sugjeron se kombinimi i një qeverie tërësisht të diskredituar dhe një opozite ligjore të munguar, të “zbutur” ose të kooptuar duket të jetë faktor nxitës për zhvillimin e ekstremizmit të dhunshëm. Popullatat që e konsiderojnë rendin ekzistues si të falimentuar dhe që nuk besojnë se mund ta ndryshojnë apo reformojnë sistemin politik nëpërmjet mjeteve paqësore dhe ligjore, përbëjnë një objektivi që është veçanërisht i ndjeshëm ndaj propagandës së organizatave të EDH. Për të hedhur dritë mbi këtë temë, studiuesit hartuan pohimet e mëposhtme, duke nënvizuar një skenar ku keqpërdorimi i institucioneve nga qeveria dhe bashkëpunimi me elementë kriminalë, së bashku me një opozitë të komprometuar ose joefektive, bëjnë që publiku të jetë i zhgënjyer me sistemin politik.

### Pohimet për këtë nxitës:

- Aktorë qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike.
- Disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe u shërbejnë interesave të njëri-tjetrit.
- Opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje.


**Pohimi:** Aktorë qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike.

Pjesa më e madhe e të anketuarve, 76.5%, janë dakord ose plotësisht dakord se aktorët qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike. Por 16.7% e të anketuarve nuk ndajnë të njëjtin mendim, duke e kundërshtuar atë. 6.8% e të anketuarve e konsiderojnë pohimin si pa lidhje ose nuk dinë të japin një përgjigje.

Ata që janë mbështetës të Grupit të Rithemelimit të PD-së (92.5%), partive të tjera (88.9%), Partisë Demokratike (85.9%), ose që nuk mbështesin fare asnjë parti (83.4%), janë më të prirur të jenë dakord që aktorët qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike. Këtë mendim e kanë më së shumti të anketuarit e papunë (84.2%) dhe studentët (82.1%).



**Grafiku 34. Aktorë qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike. (N=1600)**




**Pohimi: Disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe u shërbejnë interesave të njëri-tjetrit.**

74% e kampionit shprehen dakord se disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe i shërbejnë interesave të njëri-tjetrit. Nga ana tjetër, 16.3% e të anketuarve nuk janë dakord ose aspak dakord me pohimin. 9.7% e të anketuarve e konsiderojnë pohimin si pa lidhje ose përgjigjen se nuk e dinë.

Ata që janë mbështetës të Grupit të Rithemelimit të PD-së (95%), partive të tjera (88.9%), jo mbështetës të ndonjë partie (80.6%), ose Partisë Demokratike (80.4%) janë më shumë të prirur të jenë dakord që disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe i shërbejnë interesave të njëri-tjetrit.

**Grafiku 35. Disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe u shërbejnë interesave të njëri-tjetrit. (N=1600)**




## Pohimi: Opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje.

Një e katërta e kampionit beson se opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje, me 25.5% që shprehen dakord ose plotësisht dakord me pohimin. Nga ana tjetër, 65.9% e të anketuarve nuk janë dakord me këtë pohim.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (33%) dhe ata me arsim më pak se ai fillor (46%) u evidentuan se priren të jenë më shumë dakord se opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje. Këtë mendim e kanë kryesisht mbështetësit e Grupit të Rithemelimit të PD-së (40%), Partisë së Lirisë (35%) dhe partive të tjera (33%).

Grafiku 36. Opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje. (N=1600)



Në kontekstin e pjesëmarrjes së ulët të votuesve në zgjedhjet e fundit të përgjithshme dhe akuzave për parregullsi zgjedhore, këto gjetje pasqyrojnë perceptimet e publikut për integritetin politik dhe qeverisjen. Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve (76.5%) janë dakord se aktorët qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesat e tyre politike. I njëjti konstatim ndahet nga 74% e të anketuarve që shprehen dakord se disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë. Nga ana tjetër, vetëm një e katërta e kampionit, 25.5%, beson se opozita politike në Shqipëri ofron alternativa shpresëdhënëse për një qeverisje më të mirë. Këto gjetje ilustronë zhgënjimin e thellë të publikut, si me organet qeverisëse ashtu edhe me opozitën, duke përkeqësuar edhe më shumë dobësitë kundrejt ekstremizmit të dhunshëm për shkak të perceptimeve për dështimin e sistemit politik.

Mbështetësit e Grupit të Rithemelimit të PD-së shfaqin vazhdimisht një nivel më të lartë të dakordësisë me pohimet si për keqpërdorimin e burimeve shtetërore (93%), ashtu edhe për lidhjet mes eliteve politike dhe kriminelëve (95%). Ky konsensus i madh reflektohet edhe mes mbështetësve të grupeve të ndryshme politike, përfshirë këtu edhe Partinë Socialiste (PS) në pushtet, duke nxjerrë në pah një shqetësim të përgjithshëm që shkon përtej bindjeve dhe përkatësisë politike. Mes të anketuarve që mbështesin PS-në, 51% janë dakord



se aktorët qeverisës shfrytëzojnë institucionet dhe burimet shtetërore, ndërsa 49% pranojnë se anëtarë të caktuar të elitës politike kanë marrëdhënie me kriminelë, duke përfituar reciprokisht nga këto lidhje.

Të papunët (84%) dhe studentët (82%) sugjerojnë se ata janë më të vëmendshëm ndaj pasojave politike dhe ekonomike të keqpërdorimeve dhe lidhjeve të tilla. Për më tepër, optimizmi për kapacitetin e opozitës për të sjellë ndryshime pozitive ka më shumë gjasa të gjendet tek individët e moshuar dhe ata me nivel të ulët arsimor, dhe është veçanërisht i dukshëm tek mbështetësit e Grupit të Rithemelimit të PD-së dhe Partisë së Lirisë. Ky tendencë sugjeron se ndonëse zhgënjimi me sistemin politik është mjaft i përhapur, disa grupe demografike – ndoshta për shkak të statusit të tyre social-ekonomik, përkatësive politike ose përvojave – tregojnë një ndjeshmëri më të lartë ndaj çështjeve në fjalë.

### Frikësimi apo kërcënimi nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm

Aty ku qeveritë nuk mund t'u japin qytetarëve të tyre mbrojtje dhe siguri, grupet e ekstremizmit të dhunshëm do të përdorin frikën dhe kërcënimin për të siguruar me anë të forcës mbështetje për lëvizjen e tyre. Ndonëse ky nxitës nuk përshkruan realitetin shqiptar, format e fshehta të shtrëngimit ose edhe presioni i bashkëmoshatarëve që mund ta detyrojnë një person të bashkohet ose të tolerojë ideologji radikale apo të ekstremizmit të dhunshëm. Për të vlerësuar këtë nxitës në kontekstin shqiptar, në këtë sondazh u synua të vlerësohej nëse të anketuarit ishin të gatshëm të denonconin anëtarë të komunitetit të tyre që kanë bindje ekstremiste fetare.

Siç raportohet edhe në seksionin e nxitësve kulturorë dhe kapitullin mbi kërcënimet e tjera në zhvillim, gjetjet e sondazhit tregojnë se ndonëse ekstremizmi fetar njihet më shpesh sesa ekstremizmi etno-nacionalist, të dyja janë dukshëm më pak të përhapura se ekstremizmi politik sipas perceptimeve të popullsisë së anketuar. Konkretisht, prania e ekstremizmit fetar raportohet nga 6.6% e të anketuarve, duke e konsideruar atë si më pak shqetësues në krahasim me ekstremizmin politik, të cilin e vunë re 16.3% e pjesëmarrësve, por më i përhapur se ekstremizmi etno-nacionalist, i pranuar nga vetëm 3.5%.

#### Pohimi për këtë nxitës:


- Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër vlerësime nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4), ku 77.8% nuk ishin dakord. Mbështetja për pohimin ka mbetur e pothuajse e qëndrueshme me kalimin e kohës, duke dëshmuar një rritje minimale prej 1.1 pp nga 2018 në 2021 dhe një rritje të ngjashme nga 2021 në 2023.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit me arsim më të ulët se ai fillor (24%) dhe ata që janë të vetëpunësuar (19%) kanë më shumë gjasa të jenë dakord me pohimin. Ky qëndrim ndahet zakonisht mes atyre që janë mbështetës të Grupit të Rithemelimit të PD-së (23%) dhe Partisë Demokratike (19%), kanë më shumë gjasa të jenë dakord me pohimin.



Grafiku 37. Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare. (N=1600)



Në një mjedis ku mund të mungojnë siguria dhe mbrojtja nga qeveria, potenciali i grupeve të ekstremizmit të dhunshëm për të përdorur frikësimin dhe detyrimin për të siguruar mbështetje është një shqetësim i njohur. Megjithatë, ky nxitës nuk përkon plotësisht me situatën në Shqipëri, ku janë forma të tjera më pak të dukshme si shtypa apo presioni nga bashkëmohatarët që mund të ndikojnë që individët të pranojnë ose tolerojnë ideologjitë radikale. Lidhur me denoncimin e ekstremizmit fetar nga komuniteti, një shumicë e konsiderueshme (77.8%) e të anketuarve nuk ishin dakord me pohimin se një besimtar i vërtetë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tyre që kanë pikëpamje ekstremiste fetare, gjë që konfirmon mosmiratimin e ekstremizmit fetar.

### Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë myslimane

Në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria dallohet për ndjenjat e saj të forta pro-evropiane, ku të dhënat më të fundit tregojnë për një entuziazëm të dukshëm për anëtarësimin në BE, mbështetja për të cilën është rritur në 92%, duke shënuar kështu një rritje në krahasim me vitet e mëparshme.<sup>53</sup> Organizatat ndërkombëtare zakonisht gëzojnë mbështetje të madhe dhe renditen vazhdimisht si institucionet më të besuara në Shqipëri. Raporti më i fundit i sondazhit të opinionit publik “Besimi në Qeverisje” i rendit NATO-n (77%), OKB-në (74%) dhe BE-në (75%) si institucionet më të besuara, në krahasim me parlamentin (29%) dhe partitë politike (26%)<sup>54</sup>.

53 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Barometri Ballkanik, Opinioni Publik i vitit 2023, marrë nga <https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications>.

54 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2023). Sondazh i opinionit publik ‘Besimi në qeverisje 2023’. Marrë nga: <https://idmalbania.org/trust-in-governance/>



Toleranca fetare në Shqipëri konsiderohet si vlerë themelore e shoqërisë e rrënjësuar thellësisht në traditën dhe vlerat qytetare të vendit. Megjithatë, rritja e populizmit në mbarë botën dhe paragjykimet në vendet e BE-së, veçanërisht ndaj refugjatëve nga vendet myslimane, kanë arritur tek publiku në vend dhe kanë ndikuar tek opinionet e tyre. Në një kontekst të tillë, popujt mund të pranojnë propagandën e ekstremizmit të dhunshëm se sistemi ekonomik e politik në botë diskriminon botën myslimane, gjë që mund të shkaktojë ndjenjën personale apo të përbashkët të diskriminimit. Për të shqyrtuar këtë nxitës, në këtë studim trajtohen perceptimet e shqiptarëve ndaj sistemit ndërkombëtar dhe Perëndimit, si në nivel global ashtu edhe në rajonin e Ballkanit, përfshirë këtu edhe perceptimet lidhur me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.


#### Pohimet për këtë nxitës:

- Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame.
- Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare.
- Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut).
- SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut).


**Pohimi:** Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame.

Të anketuarve iu kërkua të thonin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër vlerësime nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 25.4% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ndërsa 55.3% e të anketuarve e kundërshtojnë atë. 13.1% e të anketuarve nuk dinin të jepnin përgjigje dhe 6.2% e konsiderojnë pohimin si pa lidhje. Dakordësia me pohimin se strukturat ekonomike dhe politike globale janë një shpikje e Perëndimit për të sunduar vendet islame u ul lehtësisht me 0.8 pikë përqindjeje në 2023 në 25.4% nga 26.2% në 2021, pas një rritjeje prej 7.7 pikë përqindjeje nga 18.5% e vitit 2018.

Mbështetësit e Partisë së Lirisë (56%), Partisë Demokratike (37%) dhe Grupit të Rithemelimit të PD-së (35%) priren më shumë të besojnë se strukturat politike dhe ekonomike globale janë një shpikje e Perëndimit për të sunduar vendet islame. Këtë mendim e kanë zakonisht ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare (42%) dhe luten/falen rregullisht (40%).



Grafiku 38. Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame. (N=1600)




Pohimi: Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare.

36.2% e të anketuarve janë dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ndërsa 45.5% e të anketuarve nuk janë dakord. 18.3% nuk e dinë ose e konsiderojnë të parëndësishme pohimin.

Në vitin 2023, niveli i dakordësisë me pohimin ra me 11 p.p. nga niveli më i lartë i 2021 (kur 47.2% ishin dakord), që është gjithsesi 1.7 p.p. më i lartë se niveli i vitit 2018 (kur 34.5% ishin dakord).

Grafiku 39. Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare. (N=1600)




Të anketuarit që mbështesin partitë opozitare, si Grupi i Rithemelimit të PD-së (65%), Partia e Lirisë (62%) dhe Partia Demokratike (44%) priren më shumë të jenë dakord me pohimin. Të anketuarit me diplomë pasuniversitare (49%), ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet fetare (51%) dhe ata që luten/falen rregullisht (57%) dhe ata që nuk luten/falen asnjëherë (46%) kanë më shumë gjasa të besojnë se vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë së tyre fetare.

**Pohimi:** Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut).

37% e të anketuarve janë dakord me pohimin, ndërsa 45.2% e të anketuarve e kundërshtojnë atë. Edhe pse përqindja e të anketuarve që janë dakord me pohimin ra me 6.9 p.p. nga 43.9% në 2021, ajo ende shënon një rritje të ndjeshme prej 9.3 p.p. nga 27.7% e regjistruar në 2018, duke treguar një rritje të vazhdueshme të shqetësimeve mbi drejtësinë e BE-së ndaj vendeve të Ballkanit me popullsi të konsiderueshme të besimit islam.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit me diplomë pasuniversitare (47%) dhe ata të besimit bektashian (44%) priren më shumë të besojnë se Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane.

**Grafiku 40.** Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut). (N=1600)




**Pohimi:** SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut).

Të anketuarve iu kërkua të deklaronin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër vlerësime nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Në vitin 2023, 28.7% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ndërkohë që 53.3% e tyre e kundërshtuan atë. Një numër më i vogël të anketuarish priren të jenë dakord me pohimin në lidhje me padrejtësinë e SHBA-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor me popullsi të konsiderueshme myslimane. Përqindja e dakordësisë ra me 6.3 p.p. nga 2021 në 2023, ndërkohë që ishte rritur me 13.4 p.p. nga 2018 në 2021.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit që mbështesin partitë opozitare si Partia e Lirisë (53%), Grupi i Rithemelimit të PD-së (43%) dhe Partia Demokratike (41%) kanë më shumë gjasa të shprehin dakord me pohimin. Të anketuarit që luten/falen rregullisht (49%) dhe praktikojnë të gjitha ritet e fesë së tyre (44%) priren më shumë që ta perceptojnë SHBA-në si të padrejtë ndaj vendeve të Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane.

Grafiku 41. SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut). (N=1600)



Rreth 1 në 4 të anketuar besojnë se strukturat politike dhe ekonomike globale janë shpikje e Perëndimit për të sunduar vendet myslimane, duke shënuar një rënie të lehtë nga vitet e mëparshme. Po ashtu, 36.2% e të anketuarve janë dakord se vendet ballkanike me shumicë të krishterë marrin më shumë mbështetje nga Perëndimi për shkak të përkatësisë së tyre fetare, duke treguar një rënie në krahasim me vitet e mëparshme, por ende pak më e lartë se në vitin 2018. Për shqetësimet për drejtësinë e Bashkimit Evropian ndaj vendeve ballkanike me popullsi të konsiderueshme myslimane janë dakord rreth 37% e të anketuarve, pavarësisht një rënieje që nga viti 2021, duke treguar një rritje të vazhdueshme të shqetësimeve gjatë këtyre viteve. Edhe perceptimi i drejtësisë së SHBA-së pësoi një rënie në nivelin e dakordësisë, me rreth 28.7% të të anketuarve që janë dakord.

Mbështetësit e partive opozitare si Partia e Lirisë, Partia Demokratike dhe Grupi i Rithemelimit të PD-së janë më të prirur t'i konsiderojnë strukturat ndërkombëtare dhe mbështetjen e Perëndimit si të njëanshme kundër vendeve myslimane ose në favor të shteteve me shumicë të krishterë. Ky besim është po aq i përhapur mes atyre që ushtrojnë rregullisht ritet fetare, duke treguar një korrelacion mes prirjeve politike,



*përkushtimit fetar dhe perceptimeve për drejtësinë e komunitetit ndërkombëtar. Të anketuarit me diplomë pasuniversitare dhe ata që i përmbahen besimit bektashian tregojnë nivele më të larta të dakordësisë me pohimet që kritikojnë drejtësinë e BE-së dhe SHBA-së.*

## Përfundime për nxitësit politikë

Nga nëntë nxitës të analizuar në kategorinë e nxitësve politikë drejt ekstremizmit të dhunshëm, tre prej tyre duken se kanë lidhje veçanërisht me kontekstin shqiptar: (1) Mohimi i të drejtave politike dhe lirive civile, (6) Zonat e paqeverisura ose të qeverisura dobët, (7) Qeveritë e diskredituara apo mungesa ose kooptimi i opozitës ligjore, dhe një nxitës tjetër që është disi i rëndësishëm: (5) Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta. Këta nxitës mbështeten nga rreth gjysma e të anketuarve dhe madje edhe më shpesh nga njerëz me nivel të ulët arsimor.

Gjetjet theksojnë rritjen e konsiderueshme të përkrahjes së nxitësve politikë, ku gati gjysma e të anketuarve (49.2%) mendojnë se të drejtat dhe liritë e tyre respektohen nga institucionet shtetërore, duke nxjerrë në pah një perceptim të ndarë për respektimin e lirive civile. Qëndrueshmëria në këtë perceptim që nga viti 2021 nuk do të thotë se kemi ndonjë ndryshim të rëndësishëm në pikëpamjet e publikut për të drejtat dhe liritë civile. Përveç kësaj, pothuajse gjysma e të anketuarve (46.3%) e konsideron sistemin politik si të padrejtë dhe që me gjasa kërkon ndryshime të dhunshme. Këto gjetje nënvizojnë lidhjen mes shtypjes së të drejtave politike, lirive civile dhe prirjes drejt ekstremizmit të dhunshëm. Për më tepër, 30% e të anketuarve besojnë se Shqipëria do të kishte më shumë drejtësi nëse njerëzit do të respektonin më shumë fenë e tyre, ku kemi një rënie të besimit të korrelacioni mes besimit fetar dhe integritetit të institucioneve shtetërore.

Për sa i përket qeverisjes dhe roleve të shtetit, pjesa më e madhe e të anketuarve e shohin shtetin kryesisht si ligjzbatues dhe jo si ofruer shërbimi. Rënia e dakordësisë mbi mbikëqyrjen e aktiviteteve fetare nga ana e shtetit nënkupton një rritje të mbështetjes për përfshirjen e shtetit në çështjet fetare, e ndikuar nga faktorë të ndryshëm, përfshirë këtu nivelin kulturor dhe klimën politike. Për më tepër, zhgënjimi i madh me qeverisjen politike është mjaft i dukshëm, me një përqindje të lartë të të anketuarve që pranojnë se aktorët qeverisës keqpërdorin burimet shtetërore dhe se këta aktorë kanë lidhje me kriminelë. Po ashtu, të anketuarit kanë shumë pak besim që opozita të ofrojë zgjidhje për më shumë mirëqeverisje. Ky zhgënjim shprehet nga të gjithë të anketuarit e çdo përkatësi politike, ku më e dukshme është mes të papunëve dhe studentëve, që shprehin një shqetësim të madh për integritetin politik dhe përkeqësimin e mundshëm të cënueshmërisë ndaj ekstremizmit për shkak të dështimeve të perceptuara të sistemit.

Gjetjet na japin një tablo të karakterizuar nga pakënaqësia me institucionet shtetërore, perceptimet për paragjykimet e komunitetit ndërkombëtar dhe një qëndrim kritik ndaj ekstremizmit dhe përfshirjes në konfliktet e huaja. Një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve (77.8%) shprehin kundërshtinë e tyre me ekstremizmin fetar, duke shprehur një refuzim të fortë nga të gjithë. Për më tepër, 64.6% kundërshtojnë përfshirjen e shqiptarëve në konfliktet e huaja, duke shprehur kështu një konsensus kundër një pjesëmarrjeje të tillë. Po ashtu, rreth një në katër të anketuar e konsiderojnë mbrojtjen e ideologjisë dhe dinjitetit fetar të një rëndësie parësore, ndonëse ka një rënie të mendimeve të tilla, gjë që sugjeron një predispozitë të lehtë ndaj dhunës për arsye ideologjike ose fetare. Mbi 40% e të anketuarve e justifikojnë vetëgjyqësinë kur ndjejnë se u janë cenuar të drejtat dhe liritë e tyre, duke nxjerrë në pah kështu një zhgënjim në rritje me rolin mbrojtës të shtetit. Veçanërisht, rreth një në pesë të anketuar mendojnë se ka paragjykim në zbatimin e ligjit kundër muslimanëve praktikantë, duke shprehur shqetësime për trajtim të pabarabartë. Në frontin ndërkombëtar, vazhdojnë ende shqetësimet e vogla për drejtësinë e Bashkimit Evropian dhe perceptimet për njëanshmëri në mbështetjen e Perëndimit ndaj vendeve të Ballkanit me shumicë të krishterë, me afërsisht 36.2% dhe 37% që evidentojnë këto probleme, përkatësisht.



### 5.3 Nxitësit kulturorë

Ballkani Perëndimor është një pikë lidhëse mes ndikimeve të Perëndimit dhe Lindjes, gjë që krijon një mozaik të grupeve etnike dhe fetare, ku besimet ndërthuren me traditat vendore. Efektet valëzues (ripple) të konflikteve globale, së bashku me përhapjen e teknologjisë që përcjell informacion në kohë reale, shkakton një përplasje mes dinamikave dhe traditave lokale me çështje më të gjera ndërkombëtare.

I rëndësishëm në këtë kontekst është edhe identiteti i individëve. Identiteti mund të kuptohet në dy aspekte që kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe që mund të quhen "sociale" dhe "personale". Identiteti social i referohet thjesht një grupi personash të shënjuar nga një etiketë dhe të dalluar nga rregullat që përcaktojnë anëtarësimin dhe tiparet ose atributet karakteristike (të supozuara). Në rastin e dytë, identitet personal është një karakteristikë (ose karakteristika) të veçanta e dalluese për të cilat një person krenohet ose i sheh si pasoja shoqërore, por pak a shumë të pandryshueshme.<sup>55</sup> Feja mund të jetë pjesë e këtyre dy ndjesive dhe ndonëse individët fetarë ruajnë lidhje të rrënjësura tek komunitetet e tyre vendore, ende vazhdon ndjenja e përkatësisë ndaj një komuniteti më të gjerë global besimtarësh. Kjo mund të ndodhë natyrshëm, por mund të përhapet edhe nga grupe dhe individë që gjithashtu i përkasin atij grupi të caktuar. Siç theksohet edhe nga Roy (2013), lëvizjet fundamentaliste dhe radikale brenda feve kryesore botërore kërkojnë të shkëputin fenë nga rrënjët e saj kulturore, duke e paraqitur atë si "fe të pastër" dhe duke e bërë atë të favorshme për globalizimin.<sup>56</sup> Ky lloj identifikimi fetar mbikombëtar mbetet relativisht i dobët në Ballkan, pasi është formuar nga përvojat e ndryshme të ndërtimit të shtetit, modernizimit dhe laicizmit gjatë periudhave të komunizmit dhe tranzicionit.<sup>57</sup> Në fakt, në rastin e Shqipërisë, ky identifikim fetar mbikombëtar nuk është i përhapur, sepse shqiptarët, shumica e të cilëve janë myslimanë sunitë, kanë zhvilluar një qasje pluraliste ndaj fesë si dhe kanë qenë më shumë të ekspozuar ndaj shekullarizmit dhe nacionalizmit për pjesën më të madhe të periudhës pas-osmane në fillim të shekullit XX.<sup>58</sup>

Propaganda e ekstremizmit të dhunshëm synon të shfrytëzojë çështje të tilla identitare dhe t'i ofrojë audiencës së saj një ligjërim dikotomist të formës "ne kundër tyre".<sup>59</sup> Edhe pse Shqipëria, si komunitetet e tjera kryesisht myslimane në Ballkan, ka mbajtur tradicionalisht lidhje të kufizuara ndërkombëtare dhe ka refuzuar një ligjërim dikotomist, tundimi nga xhihad global kundër Perëndimit i shpërndarë përmes propagandës së ekstremizmit të dhunshëm, ka gjetur rezonancë tek myslimanët e cenushtëm dhe të radikalizuar në vend.

Për të vlerësuar perceptimet e të anketuarve, në këtë studim përfshimë një seksion për nxitësit kulturorë. Duke u bazuar në studimin e Denoux dhe Carter (2009),<sup>60</sup> ne shqyrtojmë tre lloje nxitësish kulturorë që lidhen me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm me bazë fetare: (1) feja nën rrethim; (2) Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës, dhe (3) Agjendat "Proaktive"



55 Fearon, J. (1999), 'Çfarë është identiteti (në kuptimin që përdoret sot)', Stanford University, <https://web.stanford.edu/group/fearon-research/cgi-bin/wordpress/wp-content/uploads/2013/10/What-is-Identity-as-we-now-use-the-word-.pdf>.

56 Roy, O. (2013). *Padija e Shenjtë: Kur ndahen rrugët e fesë dhe kulturës*. Oxford: Oxford University Press.

57 Merdjanova, I. (2013) *Rizbulimi i Umetit: Myslimanët në Ballkan midis Nacionalizmit dhe Transnacionalizmit*. Oxford: Oxford University Press, p. 58.

58 Endersen, C. 2015, 'Besimi, atdheu apo të dyja? Ligjërimet islamike akomoduese dhe ato neo-fundamentaliste në Shqipëri', në Arolda Elbasani dhe Olivier Roy (ed.) *Rizgjimi i islamit në Ballkan: Nga identiteti të fetarizmi*, pp. 222–241. Basingstoke: Palgrave MacMillan.

59 J.M. Berger (2018). 'Ekstremizmi'. Massachusetts Institute of Technology, MIT Press, <https://direct.mit.edu/books/book/4142/Extremism>.

60 Denoux, G. dhe Carter L. (2009). *Ndihma për Zhvillim dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit: Një Udhëzues për Programimin*. Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.



fetare. Kjo qasje synon të hedhë dritë mbi ndërveprimin kompleks të ndikimeve kulturore dhe ruajtjes së identitetit përballë dinamikave globale në zhvillim. Për më tepër, kemi përfshirë pyetje në lidhje me një nxitës tjetër – ‘autoriteti i kontestuar i institucioneve fetare’ – për të shqyrtuar më tej kontekstin shqiptar.

*Tabela 4: Nxitësit kulturorë sipas Denoeux dhe Carter, 2009; IDM, 2015, 2018, 2021*

<b>Feja nën rrethim</b>	Ekziston një lidhje e fortë mes suksesit të grupeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe perceptimit se Perëndimi po sulmon islamin dhe myslimanët. Njerëzit që përjetojnë shtypje dhe poshtërim në jetën e tyre të përditshme mund të jenë më të ndjeshëm ndaj imazheve shumë të politizuara dhe emocionale të myslimanëve të tjerë që vuajnë në vende të tjera.
<b>Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës</b>	Popullata mund të perceptojë një kërcënim të përgjithshëm kulturor ndaj traditave, zakoneve, vlerave dhe ndjesisë së nderit dhe dinjitetit personal dhe kolektiv.
<b>Agjendat “Proaktive” fetare</b>	Grupet që nxisin këto agjenda do të tentojnë të imponojnë versionin e tyre të islamit, xihadit, etj., tek komunitetet vendore, duke dobësuar kështu strukturat dhe praktikatat më të moderuara e më tolerante fetare. Kjo mund të krijojë kushtet për ekstremizmin e dhunshëm.
<b>Autoriteti i kontestuar i institucioneve fetare</b>	Mosmarrëveshjet e brendshme mes grupeve të së njëjtës fe në Shqipëri, kur bashkohen me ndikimin dhe propagandën e huaj, i pengojnë fetë të krijojnë një mburojë kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe mund të çojnë në propagandë fetare edhe më radikale në shoqëri.

## Feja nën rrethim

Ky është nxitësi më i spikatur kulturor dhe i referohet ndjenjës se islami dhe myslimanët janë nën sulm sistematik nga ndikimet e jashtme (veçanërisht Perëndimi); se ata po denigrohen, shahen dhe demonizohen; se përballen me fushata të orkestruara për t’i marginalizuar, shtypur ose nënshtruar; dhe se betejat e vazhdueshme politike në pjesë të ndryshme të globit pasqyrojnë këtë sulm, aksionet e të cilit nuk janë asgjë më pak se mbijetesa e besimit. Ndonjëherë, kërcënim i perceptuar nuk është vetëm nga Perëndimi, por edhe nga brenda - nga myslimanë që janë larguar nga “rruga e vërtetë” (d.m.th., që janë një sekt tjetër) ose kanë “tradhtuar fenë e tyre” duke u bërë palë me Perëndimin.<sup>61</sup>

Në vlerësimin bazë të vitit 2015 për ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri të kryer nga IDM raportoheshin raste të imamëve të vetëshpallur që predikonin urrejtje kundër myslimanëve të tjerë shqiptarë, duke i quajtur hipokritë apo edhe qafirë (të pafe) dhe duke i akuzuar ata si

61 Sarah Ladbury dhe Maliha Hussein, ‘Zhvillimi i bazës së të dhënave për hipotezat mbi ekstremizmin dhe radikalizimin në Pakistan’, (Studim i mbështetur nga Departamenti i Mbretërisë së Bashkuar për Zhvillim Ndërkombëtar, prill 2008).



bashkëpunëtorë të politikës së Perëndimit kundër islamit.<sup>62</sup> Hulumtimet e fundit i vërtetojnë edhe më shumë këto gjetje, duke zbuluar se ekstremistët e dhunshëm në Shqipëri e cilësojnë Komunitetin Mysliman të Shqipërisë – institucioni i vetëm zyrtar që përfaqëson Islamin – si një zgjatim të aparatit shtetëror që synon të shtypë popullsinë myslimane shqiptare.<sup>63</sup>

Studimet empirike tregojnë se perceptime të tilla se islami është ‘nën rrethim’ lidhen shumë fort me mbështetjen ose përfshirjen në përpjekjet për ekstremizëm të dhunshëm.<sup>64</sup> Ndjenja se islami është në sulm mund të eklipsojë nxitësit politikë dhe socio-ekonomikë që shpesh marrin më shumë vëmendje në shpjegimet e ekstremizmit të dhunshëm. Për shembull, studimet mbi shqiptarët që shkuan për të luftuar në Siri dhe Irak në fillim të viteve 2010 zbulojnë se shumë nga ata që udhëtuan për në Siri e bënë këtë nga një ndjenjë e perceptuar e solidaritetit ndaj myslimanëve që po shtypeshin atje.<sup>65</sup> Atyre iu shfaqeshin video ku tregoheshin vështirësitë me të cilat përballeshin ‘vëllezërit’ dhe ‘motrat’ myslimanë në Siri, dhe ku bëheshin edhe thirrje për mbështetje. Të shtyrë nga dëshira për t’u ardhur në ndihmë besimtarëve të fesë të tyre, ata kishin besimin se mbrojtja e islamit dhe mbështetja e myslimanëve në nivel global përbënte një detyrim fetar.

Edhe pse situata në Shqipëri është përmirësuar në krahasim me vitet 2010, monitorimi i vazhdueshëm i perceptimeve të popullatës shqiptare në lidhje me këtë propagandë ngelet sërish i rëndësishëm.

#### Pohimet për këtë nxitës:

- Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman.
- Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë.

**Pohimi:** Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman.

Të anketuarve iu kërkua të deklaronin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër vlerësime nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 11.6% e të anketuarve ishin dakord se është e vështirë të jesh një besimtar praktikant mysliman në Shqipëri, ndërsa shumica dërrmuese prej 79.2% e kundërshtonin këtë pohim. Krahasuar me rezultatet e studimit të vitit 2021, kur 19.9% e të anketuarve ishin dakord, përqindja e të anketuarve që janë dakord me këtë pohim ka rënë me 8.3 p.p.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës ose përkatësisë fetare. Të anketuarit që ushtrojnë të gjitha ritet fetare (26.2%) dhe ata pa arsim ose më pak vite se arsimi fillor (19.1%) ishin më shumë të prirur të shprehnin dakordësi me këtë pohim. Të anketuarit me diplomë pasuniversitare (3.6%) ishin më pak të prirur të binin dakord me pohimin.

62 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (2015) ‘Radikalizmi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri’. Tiranë. fq. 89–90.


63 Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, ‘Eksplorimi i zhvillimit të një komunikimi strategjik për P/KEDH në Shqipëri’, shkurt 2021, <https://hedayah.com/app/uploads/2021/09/Exploration-of-P-CVE-strategic-communication.pdf>.

64 Denoeux, G. dhe Carter L. (2009) ‘Ndihma për Zhvillim dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit: Një Udhëzues për Programimin. Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.

65 Raporti për luftën kundër ekstremizmit, ‘Shqipëri: Ekstremizmi dhe Kundër-Ekstremizmi’, New York: Projekti i Kundër-Ekstremizmit (2017). Shih edhe: Redion Qirjazi dhe Romario Shehu, ‘Perspektivat e komunitetit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri’, Research, Berlin: Fondacioni Berghof (2018), fq. 1–2.



Grafiku 42: Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman (N=1600) përkundër besimtar praktikant i krishterë (N=1600)



### Pohimi: Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë.

Për këtë pohim, vetëm 7.1% e të anketuarve janë shprehur se janë dakord, ndërsa shumica dërrmuese e të anketuarve (82.4%) nuk janë dakord. Në krahasim me rezultatet e vitit 2021, kur 9.5% ishin dakord me pohimin, kemi një rënie me 2.4 p.p. në përqindjen e të anketuarve që janë dakord me pohimin. Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk shohim dallime të mëdha sipas moshës, gjinisë, përkatësisë fetare, ushtrimit të besimit apo statusit të punësimit. Dallimi i vetëm ishte se të anketuarit pa arsim ose më pak vite shkollë fillore (14.7%) kishin më shumë gjasa të binin dakord me pohimin.

*Siç u përmend më sipër, studimet empirike kanë treguar se njerëzit që ndihen të shtypur ose të marginalizuar mund të jenë më të gatshëm për të dhënë mbështetje ose për t'u përfshirë në përpjekjet e ekstremizmit të dhunshëm.<sup>66</sup> Edhe pse gjuha e urrejtjes e propaganduar nga imamët radikalë e vërejtur në studimin e vitit 2015 mbi ekstremizmin e dhunshëm nuk është aq e përhapur sot, është e rëndësishme të vazhdohet të monitorohet nëse shqiptarët e një feje të caktuar ndihen të marginalizuar. Përgjigjet ndaj pohimeve të nxitësit 'Feja nën rrethim' tregojnë se shumica dërrmuese e shqiptarëve nuk mendojnë se është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman apo i krishterë në Shqipëri.*

*Krahasuar me vitin 2021, sondazhi i këtij viti nxori në pah një rënie prej 8.3 p.p. në përqindjen e shqiptarëve që besojnë se është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman në Shqipëri. Po kështu, rënie prej 2.4 p.p. pati edhe tek të anketuarit që besojnë se është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë në Shqipëri. Tendencat në këtë sondazh tregojnë një përmirësim të dukshëm në perceptimin e publikut për lirinë e ushtrimit të fesë në kontekstin shqiptar. Rënie që u evidentuan në përqindjen e individëve që mendojnë se është e vështirë të jesh besimtar praktikant mysliman ose i krishterë në vend sugjerojnë një ndryshim të lehtë pozitiv në qëndrimin e publikut. Gjithsesi, ndonëse këto gjetje janë inkurajuese, është e domosdoshme të pranohet se në përpjekjet e bashkërenduara për sigurimin e lirisë së fesë dhe rritjen e ndërgjegjësimit për ekstremizmin e dhunshëm duhet të përfshihen besimtarët praktikantë dhe popullsia e*

66 Denoëux, G. dhe Carter L. (2009) "Ndihma për Zhvillim dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit: Një Udhëzues për Programimin. Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.

*gjerë. Në këtë mënyrë, nëpërmjet një strategjie gjithëpërfshirëse mund të trajtohen me efektivitet jo vetëm perceptimet e diskriminimit me të cilat përballen besimtarët praktikantë, por edhe të luftohen problemet e përhapura si islamofobia. Është me rëndësi të ndërgjegjësohet dhe të sigurohet mirëkuptim më i madh nga shoqëria për të nxitur një mjedis gjithëpërfshirës që respekton besimet e ndryshme fetare dhe kultivon tolerancën brenda komunitetit në përgjithësi.*

## Kërcënim i përgjithshëm ndaj kulturës

Kërcënimi kulturor perceptohet në formën e zbehjes së traditave “autentike” dhe gërryerjes së solidaritetit të grupit nga ndikimet kulturore që vijnë nga jashtë. Komunitetet mund të përdorin dhunën ose ta mbështesin përdorimin e saj nga disa prej anëtarëve të tyre, sepse e perceptojnë dhunën si mjet të domosdoshëm për të parandaluar humbjen e kontrollit mbi të ardhmen e tyre kulturore, ose sepse kërkojnë të parandalojnë asimilimin ose përfshirjen e tyre në një sferë tjetër kulturore.<sup>67</sup> Në raste të tilla, ajo që përfshihet këtu nuk është aq shumë mbrojtja e fesë në vetvete, por përpjekja për të afirmuar kufij më të gjerë kulturorë (shumë prej të cilëve janë të ndërthurur me fenë, mund të shprehen në një idiomë fetare, ose mund të mbrohen përmes mjeteve për cila feja mund të ofrojë një justifikim).

Pas revokimit të ndalimit të lirisë së fesë, ringjallja e fesë në Shqipërinë postkomuniste u shoqërua me dyndjen e misionarëve dhe fondacioneve fetare të huaja. Që në fillim të viteve 1990, u ngritën shqetësime se në Shqipëri po përhapeshin mësimet dhe norma fetare që ishin të huaja për traditat fetare të vendit. Për të matur perceptimet e publikut për kërcënimet ndaj formave tradicionale të praktikimit të fesë islame apo të feve të tjera në Shqipëri, të anketuarve iu ofruan dy pohime.

### Pohimet për këtë nxitës:

- Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të islamit konservator.
- Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm.


### Pohimi: Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator.

Të anketuarve iu kërkua të tregonin sa dakord ishin me pohimin duke përdorur një shkallë me katër pikë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 24.8% ishin dakord me pohimin, ndërkohë që 53.2% e të anketuarve nuk ishin dakord dhe 18.2% nuk dhanë përgjigje. Në krahasim me rezultatet e vitit 2021, kur 39.1% ishin dakord me pohimin, kemi një rënie të dukshme me 14.3 p.p. Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk evidentohen dallime të mëdha sipas gjinisë apo statusit të punësimit. Të anketuarit me diplomë pasuniversitare (40%), ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (35%), ata të grupmoshës 45-54 vjeç (33%) dhe katolikët (32%) ishin më të prirur të binin dakord me pohimin.

67 Denooux, G. dhe Carter L. (2009) ‘Ndihma për Zhvillim dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit: Një Udhëzues për Programimin. Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.




Grafiku 43: Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator. (N=1600)



**Pohimi:** Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm.

Të anketuarve iu kërkua të jepnin një vlerësim për pohimin “Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm” në një shkallë me 4 nivele, nga ‘aspak dakord’ (1) në ‘plotësisht dakord’ (4). 14.9% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ndërsa 71.7% ishin kundër. Krahasuar me vitin 2021, kur 21.7% e të anketuarve u shprehën dakord, ka pasur një rënie me 6.8 p.p. në përqindjen e të anketuarve që janë dakord me pohimin. Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk shohim dallime të mëdha sipas gjinisë, nivelit arsimor apo përkatësisë fetare. Të anketuarit që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (28%) ishin më të prirur të binin dakord me pohimin. Nga ana tjetër, të anketuarit e grupmoshës 18-24 vjeç (10%) ishin më pak të prirur të binin dakord me këtë pohim.

Grafiku 44: Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm. (N=1600)



*Kërcënimi i perceptuar kulturor rrjedh nga rënia e traditave 'autentike' dhe dobësimi i identitetit të grupit për shkak të ndikimeve të jashtme kulturore. Duke e perceptuar dhunën si një masë të nevojshme, komunitetet mund të përdorin ose të miratojnë veprime të dhunshme për të mbrojtur kontrollin mbi të ardhmen e tyre kulturore dhe për t'i rezistuar asimilimit, ose përfshirjes në një sferë tjetër kulturore. Në rastin e Shqipërisë, një në katër të anketuar besonte se myslimanët përballen me ndikime të huaja që vijnë nga islami konservator. Edhe pse shifrat aktuale paraqesin një farë shqetësimi, vihet re një përmirësim i dukshëm në krahasim me të dhënat e vitit 2021, teksa kemi një rënie me 14.3 p.p. në numrin e të anketuarve që i perceptojnë myslimanët si të ekspozuar ndaj ndikimeve të jashtme që vijnë nga islami konservator. Për më tepër, në total 14.9% e të anketuarve besojnë se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm. Edhe kjo përqindje është disi shqetësuese, por edhe këtu ka pasur përmirësim krahasuar me të dhënat e vitit 2021, ku kemi një rënie prej 6.8 p.p. Është e rëndësishme të vazhdohet me monitorimin e ndikimit të huaj në çështjet e brendshme fetare dhe tek besimtarët shqiptarë. Qasjet që nxisin dialogun dhe llogaridhënien do t'u bënin të mundur individëve të cenueshëm të angazhohen në një mjedis të sigurt, jo vetëm për të trajtuar shqetësimet e tyre kundër të tjerëve, por edhe për të reflektuar mbi forcimin e identitetit të bazuar në parime. Një gjë e tillë do t'u mundësonte individëve të kuptojnë potencialin e tyre transformues dhe të marrin një rol më aktiv në shoqëri duke vepruar si ndërmjetës, duke reduktuar kështu ndikimin e kërcënimeve keqdashëse kulturore dhe duke ruajtur zakonet dhe vlerat tradicionale. Mbështetja mbi vlerat kombëtare, të tilla si harmonia fetare apo dialogu gjithëpërfshirës do të mundësonte që qëndrimet e panjohura nga shoqëria të diskutoheshin në një mënyrë produktive dhe të sigurt.*

## Agjenda "proaktive" fetare

Ndryshe nga dy nxitësit e mësipërm, ky nxitës nuk ka të bëjë me reagimin ndaj një veprimi të perceptuar dashakeqës nga të tjerët. Përkundrazi, ai ka të bëjë me marrjen e hapave proaktive për të riformësuar shoqërinë sipas pikëpamjeve të dikujt. Ky nuk është rasti i reagimit kundër forcave të huaja që ndërhyjnë në 'terrenin kulturor' të besimtarit, por një ndërhyrje agresive në territorin kulturor të të tjerëve.<sup>68</sup> Nga një këndvështrim kulturor ose fetar, individët dhe grupet e drejtuar nga kjo agjendë nuk duan thjesht të lihen të qetë, por kërkojnë të ristrukturojnë territorin fetar ose kulturor të të tjerëve në mënyrë që ta bëjnë atë territor sipas pikëpamjeve të tyre për mënyrën se si duhet të organizohet shoqëria dhe si duhet të veprojë ajo.

Kur flasim për marrëdhënien midis fesë dhe kulturës tek grupet fetare moderne, kemi dy qëndrime kryesore: grupet e akomodimizmit dhe grupet e fundamentalizmit.<sup>69</sup> Grupet e akomodimizmit mendojnë se feja është e ngulitur në kulturë dhe se kultura e përbashkët është parakusht për ekzistencën e fesë. Për akomodimizmin, besimtari i një feje mund të ketë të njëjtën kulturë me një jobesimtar dhe besimtarë të feve të tjera. Fundamentalizmi, nga ana tjetër, kërkon ndarjen e fesë nga kultura.

Kur grupet ekstremiste ose radikale promovojnë qëndrimin e tyre - fundamentalist - të islamit ose të feve të tjera tek popullata në vend, ato dobësojnë strukturat dhe praktikat fetare tradicionale më të moderuara dhe tolerante. Indoktrinimi i një version kaq të ngurtë të besimit që e shkëput besimtarin nga kultura dhe shoqëria përreth mund të bëjë që këta individë dhe grupe të përqafojnë ekstremizmin fetar. Mundësia dhe rreziku i individëve dhe grupeve radikale për të përhapur një agjendë proaktive fetare në Shqipëri matet përmes tre pohimeve. Pohimi i parë vlerëson sa të shqetësuar janë shqiptarët për ekstremizmin e dhunshëm në vend, ndërsa pohimi i dytë vlerëson nëse në zonën ku banojnë ka grupe të mirë-organizuara që përhapin interpretime ekstremiste të besimeve të ndryshme. Më pas, të anketuarit u pyetën për format e sjelljeve, veprimeve apo qëndrimeve ekstremiste që kanë vënë re në zonën ku banojnë.

68 Denoëux, G. dhe Carter L. (2009) "Ndihma për Zhvillim dhe Kundërshtimi i Ekstremizmit: Një Udhëzues për Programimin", Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar.

69 Roy, O. (2013) Padija e shenjtë: Kur ndahen rrugët e fesë dhe kulturës. Oxford: Oxford University Press.




**Pohimet për këtë nxitës:**

- Sa të shqetësuar jeni për ekstremizmin fetar në Shqipëri?
- Në zonën ku banoj ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar.
- Çfarë sjelljesh, veprimesh apo qëndrimesh ekstremiste keni vënë re në zonën ku banoni?

**Pohimi: Sa të shqetësuar jeni për ekstremizmin fetar në Shqipëri?**


Të anketuarve iu kërkua të deklaronin sa të shqetësuar janë me ekstremizmin fetar duke përdorur një shkallë me katër pikë nga “aspak i shqetësuar” (1) deri në “shumë i shqetësuar” (4). 30.6% e të anketuarve u shprehën se ishin të shqetësuar për ekstremizmin fetar në Shqipëri, ndërsa shumica (64.7%) nuk ishin të shqetësuar. Krahasuar me vitin 2021, kur 31.8% e të anketuarve shprehën këtë shqetësim, diferenca është e vogël (-1.2 p.p.). Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk u evidentuan dallime të mëdha sipas gjinisë apo statusit të punësimit.

Të anketuarit me përkatësi fetare përzier (18%), ata që identifikohen si besimtarë, por nuk praktikojnë ritet fetare (25%) dhe ata të grupmoshës 18 deri në 24 vjeç (25%), ishin më pak të shqetësuar për ekstremizmin fetar në Shqipëri. Të anketuarit që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (44%), ata të grupmoshës 45 deri në 54 vjeç (40%), të anketuarit me diplomë pasuniversitare (37%), ata që identifikohen si bektashi (36%), ata që praktikojnë ritet kryesore të fesë së tyre (36%), dhe ata që identifikohen si ortodoksë (36%), ishin përgjithësisht më të shqetësuar për ekstremizmin fetar në Shqipëri.

**Grafiku 45: Shqetësimi për ekstremizmin fetar në Shqipëri (N=1600)****Pohimi: Në zonën ku banoj ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar.**

6.6% e të anketuarve ishin dakord se në zonën ku banojnë ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar, ndërkohë që shumica dërrmuese prej 79.9% e kundërshtuan këtë pohim, dhe 11.8% nuk dhanë përgjigje. Krahasuar me vitin 2021, kur 12.1% e të anketuarve ishin dakord, kemi një rënie me 5.5 p.p. të të anketuarve që janë dakord se në zonën ku banojnë ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar. Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk u vunë re dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, përkatësisë fetare, ushtrimit të besimit fetar apo statusit të punësimit. Të anketuarit pa arsim apo ata me nivel të ulët arsimor (2%) ishin më pak të prirur të binin dakord me këtë pohim.

Grafiku 46: Në zonën ku banoj ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar. (N=1600)



**Pohimi:** Çfarë sjelljesh, veprimesh apo qëndrimesh ekstremiste keni vënë re në zonën ku banoni?

Të anketuarit që konfirmuan praninë e individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin e dhunshëm fetar në zonën ku banojnë, u pyetën më pas në një pyetje të hapur se çfarë sjelljesh, veprimesh apo qëndrimesh ekstremiste kishin vënë re. Për këtë pyetje morëm gjithsej 89 përgjigje, ku 81 u konsideruan të vlefshme pas shqyrtimit të kujdesshëm, të cilat i vendosëm në disa kategori. Vlen të përmendet se informacioni i dhënë në disa përgjigje përfshinte disa kategori, duke rezultuar në përfshirjen e tyre në më shumë se një kategori.

Përgjigjet u grupuan në gjashtë kategori. Intoleranca fetare ishte kategoria më e lartë e raportuar (N=22) që përfshin disa nën-kategori. Të anketuarit theksuan rastet kur individët ose grupet kishin shfaqur mungesë respekti ndaj feve të tjera, shoqëruar kjo me shpërndarjen e komenteve përçmuese. Për më tepër, të anketuarit shprehën shqetësimin për detyrimin apo shtrëngimin, sipas tyre, të besimit fetar brenda komuniteteve të tyre, duke vënë në dukje manipulimin e besimeve fetare si mjet kontrolli nga individë apo grupe të caktuara. Po ashtu, pjesëmarrësit shprehën pakënaqësi për 'dallueshmërinë fetare', duke vënë në dukje disa raste kur individë fetarë nuk kremtonin festat kombëtare, shprehnin kundërshtimin ndaj martesave ndërfitare dhe prireshin drejt izolimit fetar. Nën-kategoria e fundit brenda kategorisë "Intoleranca fetare" ishte "prozelitizmi fetar"; raste kur përpjekjet për të konvertuar të tjerët në një besim të caktuar u interpretuan si formë e sjelljes ekstremiste.



Në përgjigjet e tjera të kësaj pyetjeje të hapur u shfaq një kategori e dallueshme që mund të etiketohet si “Islamofobia”. Kjo ishte kategoria e dytë më e raportuar (N=16) dhe përfshinte dy lloje të ndryshme përgjigjesh. E para lidhej me raportime të drejtpërdrejta nga të anketuar që ishin dëshmitarë të rasteve të islamofobisë. E dyta ishin përgjigjet që i referoheshin qëndrimeve më të përgjithshme islamofobike, përfshirë këtu pohime që i stigmatizonin individët bazuar në shprehjet e jashtme të besimit të tyre, të tilla si shoqërimi i mjekrës ose shamisë me ekstremizëm dhe etiketimi i praktikave si agjërimi si tregues të ekstremizmit.


Kategoria e tretë e raportuar ‘Islami’ (N=14) përfshinte disa nën-kategori. Brenda kësaj kategorie, të anketuarit shprehën një sërë çështjesh që lidhen me njëra-tjetrën, duke evidentuar një larmi të madhe përvojash dhe perceptimesh në lidhje me ekstremizmin islamik. Ata theksuan raste të ‘shtrëngimit/detyrimit fetar’, ku individët ose grupet myslimane ishin përhapur të impononin pikëpamjet e tyre fetare te të tjerët, duke shkaktuar kështu shqetësime rreth shtrëngimit fetar si një formë influencimi. “Prozelitizmi” u shfaq si një nënkategori tjetër në këtë drejtim. Nën-kategori të tjera ishin edhe “Prania e ekstremistëve” të lidhur me islamit dhe shqetësimet në lidhje me “manipulimin ideologjik” të grupeve të cënueshme. Kjo e fundit i referohet shfrytëzimit të mundshëm të individëve të cënueshëm nëpërmjet përhapjes së ideologjive ekstremiste brenda kontekstit islam. Në kompleksitetin e kësaj kategorie kontribuuan më tej referencat për ‘zgjerimin e islamit’. Pjesëmarrësit vunë në dukje shqetësimet rreth rritjes dhe ndikimit të islamit, duke evidentuar probleme rreth trajektores dhe ndikimit të besimit në zonën e anketuar.

Kategoria e katërt ishte ‘Dëshmitarët e Jehovahit’ (N=11). Të anketuarit përmendën këtu ‘prozelitizmin fetar’, duke vënë në dukje përballjet e herëpashershme me Dëshmitarët e Jehovahit që bënin vazhdimisht propagandë, përfshirë këtu edhe vizita të paftuara në shtëpitë e të anketuarve. Në disa raste, të anketuarit nuk dhanë shqetësime të veçanta, por i lidhën Dëshmitarët e Jehovahit me sjellje, veprime dhe qëndrime ekstremiste.

Kategoria e pestë, e cila ndërthuret edhe me kategoritë e tjera të raportuara më sipër është emërtuar si ‘manipulim ideologjik’ (N=7) e cila i referohet rasteve kur grupet e cënueshme raportohet se janë shfrytëzuar për të promovuar ideologji fetare, ndonëse të anketuarit nuk përmendën ndonjë fe në mënyrë të veçantë. Të anketuarit përshkruan rastet kur individë ose grupe, jo domosdoshmërisht të lidhur me një besim të caktuar fetar, përfitonin nga popullsitë e cënueshme duke ofruar mbështetje materiale për të çuar përpara agjendën e tyre ideologjike.

Kategoria e fundit e raportuar, ‘tjetër’ (N=11), përfshinte një sërë përgjigjesh të veçanta. Të anketuarit raportuan ‘efektet valëzues (ripple)të konflikteve globale’ ku konfliktet në rajone të largëta kishin ndikuar tek individët e zonave të anketuara. Të anketuarit vunë në dukje ndikimin e konflikteve globale – siç është rasti i fundit i konfliktit të armatosur Izrael-Palestinë – në perceptimet, sjelljet ose qëndrimet e popullatës vendase. Kjo nxjerr në pah ndërlidhjen e konflikteve të tilla dhe reagimet e mundshme që përjetohen përtej kufijve gjeografikë të konfliktit. Të anketuarit treguan se kishin qenë dëshmitarë të rasteve të propagandës fetare ekstremiste. Për më tepër, disa nga të anketuarit shprehën ndjenja antifetare, duke shprehur indinjatë ndaj atyre që kanë besime fetare ose që praktikojnë fenë.

*Kur grupet ekstremiste ose radikale fetare propagandojnë interpretimin e tyre fondamentalist të besimit, ato dobësojnë në këtë mënyrë strukturat fetare tradicionale dhe ato më të moderuara. Kërcënimi i individëve dhe grupeve radikale që propagandojnë një agjendë fetare proaktive në Shqipëri u mat duke vlerësuar shqetësimet e të anketuarve për ekstremizmin fetar në vend, praninë e individëve dhe grupeve që nxisin ekstremizmin fetar në zonën ku banojnë si dhe format e sjelljeve, veprimeve apo qëndrimeve ekstremiste që kishin vënë re. Një përqindje e konsiderueshme prej 30.6% e të anketuarve shprehnin shqetësimin e tyre për ekstremizmin fetar në Shqipëri, duke shënuar kështu një rënie të lehtë (1.2 p.p.) në krahasim me të dhënat e vitit 2021. Një numër i vogël të anketuarish (6.6%) shprehnin mendimin se ka grupe apo individë që nxisin ekstremizmin fetar në zonën ku banojnë, duke shënuar kështu një ulje prej 5.5 p.p. krahasuar me të dhënat e vitit 2021.*





*Për sa i përket sjelljeve, veprimeve apo qëndrimeve ekstremiste, të anketuarit dhanë disa përgjigje. Intoleranca fetare ishte kategoria më e raportuar, ku përfshiheshin mungesa e respektit ndaj feve të tjera, detyrimi apo shtrëngimi për besimin fetar brenda komuniteteve të besimtarëve, dallueshmëritë fetare nga kultura kombëtare dhe prozelitizmi fetar. Në kategoritë e tjera bënin pjesë islamofobia, ekstremizmi islamik, Dëshmitarët e Jehovait, manipulimi ideologjik dhe efektet valëzues të konflikteve globale. Gjetjet nën këtë nxitës nxjerrin në pah nevojën për të nxitur dialogun si një formë për ndërtimin e qëndresës, mbi bazën e vlerave dhe traditave të përbashkëta fetare shqiptare. Për këtë qëllim, komunitetet fetare duhet të luajnë një rol kyç në dobësimin e ndikimit fundamentalist tek ligjërimi fetar në Shqipëri.*

## Përfundimet për nxitësit kulturorë

Shumica dërrmuese e të anketuarve pohuan se ushtrimi i besimit fetar në Shqipëri, qoftë si besimtar mysliman apo i krishterë, nuk përbën vështirësi, duke reflektuar kështu edhe një rënie të numrit të të anketuarve që mendonin se ndesheshin me kufizime në praktikën e tyre fetare në krahasim me të dhënat e vitit 2021. Edhe pse 11.6% sërish raportuan vështirësi në ushtrimin e besimit fetar si mysliman praktikant në Shqipëri, ka një përmirësim të dukshëm (me rënie prej 8.3 p.p.) krahasuar me të dhënat e 2021. Po ashtu, vetëm 7.1% u shprehën se është e vështirë të jesh një besimtar praktikant i krishterë në Shqipëri, përqindje që ka pësuar rënie me 2.4 p.p. në krahasim me të dhënat e vitit 2021.

Ka pasur një rënie të konsiderueshme prej 14.3 p.p. në përqindjen e të anketuarve që besonin se myslimanët në Shqipëri përballen me ndikime të huaja nga islami konservator krahasuar me të dhënat e vitit 2021. Edhe pse kjo rënie tregon një progres që duhet vlerësuar, mbetet shqetësues fakti se një e katërta e të anketuarve (24.8%) kanë mendimin se besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja konservatore.

Ndjenja mbizotëruese tek shqiptarët (71.7%) është se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar nuk janë objekt presioni dhe kërcënimi. Edhe pse përqindja e atyre që mendojnë se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar në përgjithësi është nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm ka rënë me 6.8 p.p. krahasuar me të dhënat e vitit 2021, 14.9% e të anketuarve ende e kishin këtë mendim.

Ndonëse shumica e shqiptarëve (64.7%) nuk shprehën shqetësime për ekstremizmin fetar në Shqipëri, pothuajse një në tre të anketuar (30.6%) ndiheshin të shqetësuar për këtë formë të ekstremizmit në vend. Këtu kemi një rënie të lehtë prej 1.2 p.p. krahasuar me të dhënat e vitit 2021.

Shumica dërrmuese e të anketuarve (79.9%) nuk besonin se në zonën ku ata banojnë ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar. Këtu kemi një rënie të dukshme (5.5 p.p.) krahasuar me të dhënat e vitit 2021. Gjithsesi, kemi ende 6.6% të të anketuarve që priren të jenë dakord me pohimin.

Të anketuarit i perceptojnë disa sjellje, veprime ose qëndrime si ‘ekstremiste’ në komunitetin e tyre. Intoleranca fetare ishte kategoria më e raportuar, ku përfshiheshin mungesa e respektit ndaj feve të tjera, detyrimi apo shtrëngimi për besimin fetar brenda komuniteteve të besimtarëve, dallueshmëritë fetare nga kultura kombëtare dhe prozelitizmi fetar. Në kategoritë e tjera bënin pjesë islamofobia, ekstremizmi islamik, Dëshmitarët e Jehovait, manipulimi ideologjik dhe efektet valëzues të konflikteve globale.

Gjetjet e mësipërme tregojnë se në Shqipëri është bërë progres gjatë dy viteve të fundit në drejtim të nxitësve kulturorë të ekstremizmit. Ende ka shqetësime lidhur me ndikimet e huaja fetare dhe marginalizimin fetar. Kjo sugjeron nevojën për të vazhduar me monitorimin e këtyre çështjeve dhe të forcohet angazhimi i të gjithë shoqërisë për të ofruar një hapësirë për dialog gjithëpërfshirës që do t’u bënte të mundur njerëzve të përmbushnin detyrat e tyre qytetare me përgjegjësi dhe kompetencë. Nga ana tjetër, kjo do t’u bënte të mundur



komuniteteve të marginalizuara të bashkërendojnë dhe trajtojnë shqetësimet e tyre, duke nxitur kështu edhe llogaridhënien. Mbështetja tek vlerat tradicionale kombëtare, si harmonia fetare dhe dialogu gjithëpërfshirës do të bënte të mundur që qëndrimet ekstreme të kalonin nëpër filtrat e shoqërisë shqiptare – duke parandaluar kështu çdo ndikim të huaj që synon të dëmtojë identitetin shqiptar. Roli i komuniteteve fetare është më shumë rëndësi në këtë drejtim.

### Autoriteti i kontestuar i institucioneve fetare

Përveç nxitësve kulturorë të ekstremizmit të dhunshëm, në kreun e mëposhtëm përshkruhen rezultatet që lidhen me kontekstin më të gjerë të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri. Kjo pjesë vëzhgon mbështetjen e të anketuarve për drejtuesit e komunitetit të tyre fetar në vend, mbështetjen për klerikët fetarë në nivel vendor, tolerimin për ndjekjen e interpretimeve fetare jozyrtare, si dhe perceptimin rreth formimit fetar të klerikëve të tyre në nivel vendor. Mosmarrëveshjet e brendshme mes grupeve të së njëjtës fe, kur kombinohen me ndikimin dhe propagandën e huaj, i pengojnë fetë të krijojnë një ‘mburojë’ kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe mund të çojnë në propagandë fetare më radikale në shoqëri. Roli i klerikëve fetarë në komunitet dhe formimi i tyre fetar mund të jenë mjaft të dobishme për të ndihmuar individët e radikalizuar në përvetësimin e aftësive të të menduarit kritik, në mënyrë që të kuptojnë procesin e manipulimit dhe të shkëputen prej tij. Niveli i besimit dhe mbështetjes që gëzojnë komunitetet fetare ndihmon në forcimin e harmonisë si brenda një komuniteti fetar ashtu edhe ndërmjet feve të ndryshme.


#### Pohimet për këtë nxitës:

- Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku banoj.
- Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët.
- Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare.
- Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar.

**Pohimi: Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku banoj.**

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër vlerësime nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Më shumë se gjysma e të anketuarve (54.1%) u shprehën dakord me këtë pohim, ndërsa 17.4% u shprehën kundër. 2.8% e konsideronin pohimin si pa lidhje dhe 25.8% nuk dhanë përgjigje. Krahasuar me vitin 2021, kur 58.2% ishin dakord me këtë pohim, ka pasur një rënie prej 4.1 p.p. në përqindjen e të anketuarve që mendojnë se qëndrimet e kreut të komunitetit të tyre fetar (në Tiranë) gëzon mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku ata banojnë. Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk shohim dallime të mëdha për sa i përket gjinisë, moshës apo fesë. Të anketuarit pa arsim ose me nivel të ulët arsimor (30.9%), ata me familje të përziera fetare (26.7%) dhe ata që janë të vetëpunësuar (23%) ishin më të prirur ta kundërshtonin këtë pohim. Po ashtu, të anketuarit bektashi (12.1%) ishin më pak të prirur të kundërshtonin pohimin.


Grafiku 47: Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku banoj. (N=1600)



**Pohimi:** Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët.

Kur u pyetën të vlerësonin nëse ishin dakord me pohimin “Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët” duke përdorur një shkallë me katër vlerësime nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4), 39.6% e të anketuarve u shprehën dakord dhe 28.9% u shprehën kundër. 27.1% e të anketuarve nuk ishin të sigurt për përgjigjen e tyre. Krahasuar me vitin 2021, kur 49.3% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ka pasur një rënie prej 9.7 p.p. në përqindjen e të anketuarve që binin dakord me pohimin. Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk evidentohen dallime për sa i përket gjinisë, moshës, besimit fetar apo statusit të punësimit të të anketuarve. Të anketuarit pa arsim ose me arsim fillor (45.6%) dhe ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (34.5%) ishin më të prirur të mos binin dakord me pohimin. Të anketuarit me diplomë pasuniversitare (21.7%) ishin më pak të prirur të mos binin dakord me pohimin.


Grafiku 48. Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët. (N=1600)



### Pohimi: Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare.

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër vlerësime nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 40.5% e të anketuarve u shprehën dakord se njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me interpretimin e komunitetit të tyre zyrtar fetar, ndërsa 37.3% e të anketuarve u shprehën kundër këtij pohimi. 16.9% e të anketuarve nuk ishin të sigurt për përgjigjen e tyre ndërsa 5.3% e konsideronin atë si pa lidhje. Krahasuar me vitin 2021, kur 45.7% e të anketuarve ishin dakord me këtë pohim, kemi një rënie prej 5.2 p.p. Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha sipas gjinisë apo fesë. Të anketuarit që kanë një diplomë pasuniversitare (48.2%) dhe ata që janë besimtarë, por nuk praktikojnë asnjë rit fetar (45.8%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin. Të anketuarit pa arsim ose më pak se arsimi fillor (25%), ata mbi 65 vjeç (30.4%), ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (33.9%) dhe studentët (34.7%) ishin më pak të prirur të pajtoheshin me pohimin.

Grafiku 49. Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare. (N=1600)




### Pohimi: Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar.

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër vlerësime nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). 20.5% ishin dakord me pohimin, ndërsa 35.4% ishin kundër. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (41.1%) nuk jote sigurt për përgjigjen e tyre. Krahasuar me vitin 2021, kur 23.8% e të anketuarve ishin dakord me pohimin, ka një rënie të lehtë prej 3.3 p.p. Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk shohim dallime të mëdha sipas gjinisë, moshës, përkatësisë fetare apo nivelit të praktikimit të fesë. Të anketuarit me diplomë pasuniversitare (30.1%) ishin

më të prirur të binin dakord me pohimin. Nga ana tjetër, studentët e anketuar (9.5%) ishin më pak të prirur të pajtoheshin me pohimin.

Grafiku 50: Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar. (N=1600)



Gjetjet që jepen në këtë pjesë tregojnë se pjesa më e madhe e të anketuarve (54.1%) besojnë se qëndrimet e kreut të komunitetit të tyre fetar gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve në zonën ku banojnë. Megjithatë, këtu vëmë re se një rënie prej 4.1 p.p. krahasuar me vitin 2021. Kjo rënie mund t'i atribuohet mosmarrëveshjeve të brendshme të grupeve fetare, së bashku me ndikimet e huaja dhe propagandën nga jashtë. Këta faktorë pengojnë formimin e një "mburoje të përbashkët" kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe mund të çojnë në rritjen e rivaliteteve brenda fesë dhe në propagandë fetare më radikale në shoqëri. Si e tillë, është e domosdoshme të studiohen më në thellësi dinamikat e brendshme të këtyre tensioneve dhe të zbatohen ndërhyrjet e duhura.


Ashtu si me vlerësimet e mëparshme në 2021 dhe 2018, shqiptarët vazhdojnë t'i perceptojnë klerikët fetarë në nivel vendor si më pak ndikim në krahasim me drejtuesit e komuniteteve fetare në Tiranë. Ky sondazh tregon se 39.6% e të anketuarve besojnë se klerikët fetarë në nivel vendor kanë një ndikim të lartë tek besimtarët e tyre. Vlen të përmendet se kjo përqindje shënon një rënie prej 9.7 p.p. krahasuar me vitin 2021, duke nënkuptuar nevojën për të forcuar rolin e institucioneve fetare në nivel vendor. Niveli i besimit dhe mbështetjes që gëzojnë komunitetet fetare kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në forcimin e harmonisë si brenda një komuniteti fetar ashtu edhe ndërmjet feve të ndryshme.

Në Shqipëri, individët kanë lirinë për të ushtruar besimin e tyre fetar pa qenë nevoja të respektojnë rreptësisht mësimet e institucioneve fetare zyrtare. Megjithatë, ndjeshmëria ndaj manipulimit nga interpretimet fetare jozyrtare nënvizon 'sigurinë teologjike' të ofruar nga këto institucione zyrtare. Në këtë sondazh evidentohet se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (40.5%) besojnë se njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me komunitetet përkatëse fetare. Pavarësisht se këtu kemi një rënie prej 5.2 p.p. krahasuar me vitin 2021, përqindja e të anketuarve që pranon interpretimet jozyrtare mbetet e konsiderueshme. Duke pasur parasysh larminë e ndikimeve mbi çështjet fetare nga aktorët e jashtëm, është i kuptueshëm ky nivel i konsiderueshëm i të anketuarve që pranojnë të ndjekin interpretimet fetare jozyrtare. Megjithatë, mungesa e monitorimit të kësaj propagande nga një autoritet qendror dhe zyrtar, mund të çojë në përhapjen e interpretimeve më radikale dhe intolerante



*fetare në vend. Këto interpretime mund të bëjnë që njerëzit të humbasin lidhjen me mjedisin e tyre fizik, me qytetarët e besimeve të ndryshme apo edhe me mjedisin tolerant të Shqipërisë në tërësi. Nga ana tjetër, është e rëndësishme që komunitetet zyrtare fetare të ruajnë tolerancën ndaj interpretimeve alternative të të njëjtit besim, të pranojnë përfshirjen e ideve të ndryshme dhe të sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjithë besimtarëve brenda komunitetit të tyre fetar.*

*Se fundi, një e pesta e të anketuarve (20.5%) besojnë se ka klerikë pa arsimin e duhur fetar në komunitetin e tyre, duke shënuar një rënie prej 3.3 p.p. krahasuar me vitin 2021. Hapi i parë drejt fuqizimit të institucioneve fetare është nëpërmjet arsimit. Klerikët që mendohet se nuk kanë arsimin e duhur fetar, qoftë i saktë apo jo, rrezikojnë të dëmtojnë besueshmërinë e komuniteteve të tyre fetare dhe që mund të nxisin pranimin e grupimeve fetare jozyrtare. Roli i klerikëve fetarë në komunitet dhe formimi i tyre fetar mund të jenë të dobishëm për të ndihmuar individët e radikalizuar që këta të fundit të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik, në mënyrë që të kuptojnë procesin e manipulimit dhe të shkëputen prej tij.*



## 6. Tendencat e reja të ekstremizmit të dhunshëm: tendencat politike dhe etno-nacionaliste në Shqipëri

Gjetjet e përpunuara të këtij sondazhi për sa i përket formave të ndryshme të ekstremizmit theksojnë rëndësinë e specifikës së kontekstit për t'i kuptuar sa më mirë ato. Edhe pse analiza trajton kryesisht ekstremizmin e dhunshëm fetar, përmes prizmit të Deneoux dhe Carter, në këtë kapitull trajtohen tendencat në rritje të formave të ekstremizmit të dhunshëm jofetar në Shqipëri, siç u evidentuan nga sondazhi i mëparshëm kombëtar.<sup>70</sup> Studimi thellohet në manifestimet e ekstremizmit të dhunshëm jofetar në Shqipëri – ekstremizmi politik dhe etno-nacionalizmi – me fokus të veçantë në ekstremizmin politik, i cili, sipas vlerësimit aktual mbetet më i përhapur se format e tjera të ekstremizmit të dhunshëm. Perceptimet e qytetarëve në këtë pjesë duhet të kuptohen në kuadër të kontekstit më të gjerë të çështjeve shoqërore në Shqipëri, përfshirë këtu perceptimin për nepotizmin, detyrimin politik, marrëdhëniet ndëretnike, shqetësimet për ndryshimet demografike dhe teoritë e konspiracionit. Literatura nënvizon se cenueshmëria ndaj ekstremizmit për çdo njeri ndikohet shumë nga ekspozimi ndaj mjediseve që nxisin ndryshime morale, duke theksuar këtu rëndësinë e tipareve personale dhe të kontekstit social në procesin e radikalizimit.<sup>71</sup>

Edhe pse sondazhi i perceptimit publik zbulon se të anketuarit janë po aq të shqetësuar për ekstremizmin politik (43.4%) sesa në vitin 2021, janë rritur ndjeshëm shqetësimet për ekstremizmin etno-nacionalist (në 27%, 10.3 p.p. më shumë se në 2021). Ndërkohë që arsyet për rritjen e shqetësimeve në lidhje me etno-nacionalizmin mes të anketuarve mund të ndryshojnë, në vitin 2023 janë shënuar nga disa ngjarje të mëdha. Ndonëse këto ngjarje nuk mund t'i atribuohen drejtpërsëdrejti rritjes së ekstremizmit etno-nacionalist, ato mund të kenë luajtur një rol në formësimin e perceptimeve të publikut për këtë çështje. Për shembull, në zgjedhjet vendore të vitit 2023, një kandidat i opozitës dhe anëtar i pakicës greke, u arrestua me akuzën për blerje votash.<sup>72</sup> Kjo solli dënime të forta nga Athina dhe opozita shqiptare, të cilët e kritikuan këtë arrestim si shkelje të parimeve ligjore dhe të drejtave të pakicave, duke pretenduar se arrestimi u bë për motive politike.

Në qendër të një debati të diskutueshëm rreth përkatësisë etnike gjatë regjistrimit të popullsisë

70 Vrugtman, Leonie, Sara Kelmendi, Romario Shehu, dhe Diori Angjeli. 2021. "Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri: Vlerësim i nxitësve, formave dhe rrezeve", Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). <https://idmalbania.org/the-status-of-violent-extremism-in-albania-2021/>.

71 Rottweiler, Bettina, Paul Gill, and Noémie Bouhana. 2022. "Individual and Environmental Explanations for Violent Extremist Intentions: A German Nationally Representative Survey Study", *Justice Quarterly* 39, no. 4: 825-846. <https://doi.org/10.1080/07418825.2020.1869807>.

72 Fjori Sinoruka, "Prokuroria shqiptare kërkon dënim me burg për kryebashkiakun e Himarës." *Balkan Insight*, 13 shkurt 2024. <https://balkaninsight.com/2024/02/13/albanian-prosecution-seeks-jail-term-for-mayor-elect-of-himara/>.



në vitin 2023 ishte dhe minoriteti grek.<sup>73</sup> Akuzat për parregullsi<sup>74</sup> dhe ndërhyrje nga jashtë,<sup>75</sup> veçanërisht në lidhje me përfaqësimin e minoritetit grek, i hodhën edhe më shumë benzinë zjarrit të tensioneve dhe perceptimeve të margjinalizimit, duke hedhur rrënjët e ndjenjave etno-nacionaliste.

Ka pasur gjithashtu raste të incidenteve të dhunës me motive politike. Gjatë fushatës së zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021, pati një përplasje me pasojë vdekje mes mbështetësve të Partisë Socialiste (PS) dhe Partisë Demokratike (PD).<sup>76</sup> Ky incident ilustron rritjen e rrezikut për dhunë politike gjatë periudhave zgjedhore, veçanërisht kur intensifikohet konkurrenca elektorale. Incidente të tjera të ngjashme kanë pasur të bëjnë kryesisht me konfrontime fizike mes militantëve të partive<sup>77</sup> dhe një sulm të paprecedentë ndaj liderit të opozitës, që fillimisht mendohej se ishte i motivuar politikisht, ndonëse i kryer nga një individ me probleme të shëndetit mendor dhe pa lidhje me grupe të organizuara.<sup>78</sup>

Shqetësimet rreth ekstremizmit etno-nacionalist edhe brenda Shqipërisë ka të ngjarë të rrisin incidente të tjera në rajon, megjithëse prekin kryesisht shqiptarët e Kosovës. Në maj 2023, pas mosmarrëveshjeve mbi rezultatet e zgjedhjeve vendore në veri të Kosovës u përshkallëzuan tensionet, ku serbët u përleshën me forcat policore të Kosovës dhe paqeruajtësit e NATO-s. Për më tepër, në shtator 2023, një sulm i kryer nga militantët serbë ndaj një patrulle të policisë së Kosovës në Banjska rezultoi në vdekjen e një polici të Kosovës, që u pasua me shkëmbim zjarri që rezultoi në vdekjen e tre militantëve serbë.<sup>79</sup>

## Perceptimi i qytetarëve për ekstremizmin e dhunshëm

*Për të kuptuar sa më mirë nuancat e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri është e rëndësishme të kuptojmë se si qytetarët e perceptojnë ekstremizmin e dhunshëm. Për këtë duhen hulumtuar perspektivat e popullatës për veprimet që mund të konsiderohen si ekstremizëm i dhunshëm, si dhe duhen identifikuar shqetësimet dhe pasojat specifike që lidhen me një ekstremizëm të tillë. Qëllimi kryesor që të mësojmë se si kuptohet dhuna e dhunshme nga të anketuarit nuk është vetëm kontekstualizimi i fenomenit, por edhe informimi i politikëbërjes dhe ofrimi tek punonjësit e P/KEDH-së i njohurive empirike për strategjitë efektive.*

## Pyetje e hapur: Sa të shqetësuar jeni me ekstremizmin politik/etno-nacionalist në Shqipëri?



73 Qeveria shqiptare, Nis Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023, operacioni më i rëndësishëm statistikor në Shqipëri, Deklaratë për shtyp, 13 shtator 2023, <https://www.kryeministria.al/newsroom/nis-censi-i-popullsisë-dhe-banesave-2023-operacioni-me-i-rendesishem-statistikor-ne-shqiperi/>

74 Stavros Tzimas, Censusi në Shqipëri mes shqetësimeve për manipulim, 6 tetor 2023, <https://www.ekathimerini.com/opinion/1221778/albania-census-amid-concerns-of-manipulation/>


75 Klan TV News, Alarmi i Ardit Bidos: Po tentohet të manipulohet censusi i 2023-shit në Dhërmi dhe Himarë për t'i nxjerrë minoritet grek, 18 shtator 2023, <https://tvklan.al/alarmi-i-ardit-bidos-po-tentohet-te-manipulohet-censusi-i-2023-shit-ne-dhermi-dhe-himare-per-ti-nxjerre-minoritet-grek>

76 ABC News, "Vritet Pjerin Xhuvani i PS në Elbasan, 3 të plagosur. Policia merr plumb në këmbë pas përplasjes për votat në Elbasan" 21 prill 2021, <https://abcnews.al/vritet-pjerin-xhuvani-i-ps-ne-elbasan-2-te-plagosur-policia-merr-plumb-ne-kembe-pas-perplasjes-per-votat-ne-elbasan/>

77 "Socialistët i konsiderojnë përplasjet në Elbasan si provokim politik," Albanian Daily News, 14 mars 2021, <https://albaniandailynews.com/news/socialist-sees-elbasan-clashes-as-political-provocation-1>

78 Alba Mborja, "Lideri i opozitës shqiptare sulmohet gjatë protestës kundër qeverisë." EXIT, 6 dhjetor 2022. <https://exit.al/en/albanias-opposition-leader-attacked-during-anti-government-protest/>

79 Alice Taylor, " Prishtina dhe BE në mosmarrëveshje për raportin mbi 'sulmin terrorist' të Banjskës," Euractiv, 15 janar, 2024, <https://www.euractiv.com/section/politics/news/pristina-eu-at-odds-over-banjska-terrorist-attack-report/>





Të anketuarve iu kërkua të deklaronin se sa të shqetësuar janë për ekstremizmin politik dhe etno-nacionalist në Shqipëri në një shkallë prej 4 pikësh nga ‘aspak i shqetësuar’ (1) në ‘shumë i shqetësuar’ (4). Të anketuarit ishin më shumë të prirur të shprehnin shqetësim për ekstremizmin politik: 43.4% e të anketuarve treguan se janë të shqetësuar (25.6%) ose shumë të shqetësuar (17.8%). Më shumë se një e katërta e kampionit (27%) shprehën shqetësim edhe për ekstremizmin etno-nacionalist, ku 16.5% e të anketuarve thanë se janë të shqetësuar dhe 10.5% shumë të shqetësuar.


Kur bëjmë krahasime me të dhënat e sondazhit të vitit 2021, vërehet se numri i të anketuarve që shprehin shqetësim për ekstremizmin politik është rritur me 1.4 p.p. ndërsa numri i të anketuarve që shprehin shqetësim për ekstremizmin etno-nacionalist në Shqipëri është rritur me 10.3 p.p.

Përsa i përket nivelit të shqetësimit për ekstremizmin politik në Shqipëri, gjithsej 52.7% nuk ishin të shqetësuar ose aspak të shqetësuar, ndërsa 3.9% e kampionit thanë se nuk e dinin ose e konsideronin pyetjen si pa lidhje. Po ashtu, kur u pyetën sa të shqetësuar janë për ekstremizmin etno-nacionalist në vend, 67.7% nuk ishin të shqetësuar, ndërsa 5.3% treguan se nuk kishin njohuri për këtë çështje ose e konsideronin pyetjen si pa lidhje.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit me diplomë pasuniversitare (54%), të vetëpunësuarit (50%) dhe mbështetësit e Partisë së Lirisë (59%), ishin më shumë të prirur të shprehnin shqetësim për ekstremizmin politik në Shqipëri.

Si për kontrast, të anketuarit me më pak arsim se ai fillor (35%) dhe ata që refuzuan të përgjigjen për nivelin e tyre arsimor (54.5%) ishin më shumë të prirur të shqetësoheshin për ekstremizmin etno-nacionalist. Këtë shqetësim e kanë në përgjithësi edhe të anketuarit që mbështesin Partinë e Lirisë (38%) dhe Partinë Demokratike (33%) si dhe ata që janë bektashinj (35%) dhe ortodoksë (34%).

Grafiku 51. Shqetësimet për ekstremizmin politik përkundër ekstremizmin etno-nacionalist (N=1600)



**Pyetje e mbyllur: Sipas mendimit tuaj, a mund të cilësohen veprimet e mëposhtme si ekstremizëm i dhunshëm?**



Të anketuarve iu dha një listë veprimesh<sup>80</sup> dhe u pyetën se kur këto veprime mund të konsideroheshin si ekstremizëm i dhunshëm sipas një shkalle prej 5 pikësh (asnjëherë, rrallëherë, ndonjëherë, shpeshherë ose gjithmonë). Veprimi që konsiderohet më së shumti si ekstremizëm i dhunshëm ishte kërcënimi fizik ndaj një individi ose grupi për arsye politike, fetare ose ideologjike, ku 45.5% e të anketuarve zgjedhën përgjigjen “gjithmonë”. Edhe përfshirja në një akt kriminal për këto arsye konsiderohet “gjithmonë” si ekstremizëm i dhunshëm nga 37.1% e të anketuarve. Sulmi verbal ndaj një individi apo grup për arsye të ngjashme është “gjithmonë” ekstremizëm i dhunshëm sipas 33% të të anketuarve, ndërsa shpërndarja ose pëlqimi i materialeve që promovojnë dhunën është “gjithmonë” ekstremizëm i dhunshëm për 26.6% të kampionit.

Sulmi verbal ndaj një individi përshkruhet “shpesh” si ekstremizëm i dhunshëm nga 27.3% e të anketuarve; po kështu përshkruhet edhe shpërndarja ose pëlqimi i materialeve të dhunshme me 26.4%; përfshirja në akt kriminal nga 24,1%; dhe kërcënimi fizik ndaj një njeriu me 23.9%. Veprimet me një përqindje të konsiderueshme të përgjigjes “ndonjëherë” janë: bërja e komenteve poshtëruese (24.9%), shpërndarja ose pëlqimi i materialeve të dhunshme (24.1%), sulmi verbal ndaj një individi apo grupi (20.5%) dhe kërcënimi fizik ndaj një individi apo grupi (15.2%). Një përqindje e vogël e të anketuarve janë të pasigurt për këto klasifikime, duke filluar nga 1.5% në 2.3% për veprime të ndryshme.

Tabela 5. Përqindja e të anketuarve që i përshkruajnë veprimet si ekstremizëm të dhunshëm (N=1600)

Sipas mendimit tuaj, a mund të cilësohen veprimet e mëposhtme si ekstremizëm i dhunshëm?						
	Asnjëherë	Rrallëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë	Gjithmonë	Nuk e di
a) Pjesëmarrja në një protestë paqësore për arsye politike, fetare ose ideologjike	53.6%	23.2%	12.7%	5.2%	3.1%	2.3%
b) Bërja e komenteve poshtëruese për dikë për arsye politike, fetare ose ideologjike	13.4%	24.8%	24.9%	20.3%	15.1%	1.5%
c) Përfshirja në një akt kriminal për arsye politike, fetare ose ideologjike	6.4%	11.5%	19.1%	24.1%	37.1%	1.7%
d) Shpërndarja ose pëlqimi i materialeve që promovojnë përdorimin e dhunës për arsye politike, fetare ose ideologjike	6.4%	14.2%	24.1%	26.4%	26.6%	2.3%

80 Pyetje dhe variabla të përshtatura nga: "Të kuptojmë ekstremizmin në Skoci: Perceptimet dhe përvojat publike". (27 korrik 2023), Qeveria Skoceze, Marrë nga <https://www.gov.scot/publications/understanding-extremism-scotland-public-perceptions-experiences/pages/4/>.

Sipas mendimit tuaj, a mund të cilësohen veprimet e mëposhtme si ekstremizëm i dhunshëm?						
	Asnjëherë	Rrallëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë	Gjithmonë	Nuk e di
e) Sulm verbal ndaj një individi ose grupi për arsye politike, fetare ose ideologjike	6.1%	11.0%	20.5%	27.3%	33.0%	2.1%
f) Kërcënim fizik ndaj një individi ose grupi për arsye politike, fetare ose ideologjike	5.9%	8.1%	15.2%	23.9%	45.5%	1.5%

**Pyetje e mbyllur: Cila nga pasojat e mundshme të ekstremizmit të dhunshëm është më shqetësuesja në rastin e Shqipërisë?**

Kur u pyetën për pasojat më shqetësuese të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, përgjigja më e shpeshtë (28.3%) ishte se ai kërcënon jetën e qytetarëve. Shqetësimi i dytë më i madh për të anketuarit ishte se ekstremizmi i dhunshëm sjell si pasojë shkeljen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve (18.3%), i ndjekur nga afër nga cenimi i sigurisë kombëtare (12.5%). Më pak shqetësuese ishte ideja se ekstremizmi i dhunshëm dëmton imazhin e Shqipërisë (4.1%), ose se dëmton marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet fqinje (1.2%). Për t'u theksuar është konstatimi se 7.7% e të anketuarve nuk e shihnin si shqetësim ekstremizmin e dhunshëm, ndërkohë një përqindje e vogël ose nuk e dinin (0.7%) ose refuzuan të përgjigjen (2.6%).

*Tabela 6. Përqindja e të anketuarve që tregojnë për pasojat më shqetësuese të ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri (N=1600)*

Pasoja	Përqindja (N=1600)
Kërcënon jetën e qytetarëve	28.3%
Cenon sigurinë kombëtare	12.5%
Të drejtat dhe liritë e qytetarëve	18.3%
Dhuna për motive politike	8.4%
Dëmton ekonominë	5.1%
Nxit urrejtje dhe mosbesim në shoqëri	11.3%
Cenon imazhin e Shqipërisë	4.1%
Cenon marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet fqinje	1.2%
Ekstremizmi i dhunshëm nuk është shqetësues	7.7%
Nuk e di/refuzim	3.4%



Shqetësimi në rritje për ekstremizmin politik dhe etno-nacionalist sugjeron një ndërgjegjësim dhe shqetësim në rritje të popullsisë lidhur me këto çështje. Këto shqetësime mund të jenë një reflektim i rritjes së ekspozimit ndaj këtyre formave të ekstremizmit si dhe ndaj tensioneve të tjera në rajonin e gjerë. Rastet si ndalimi i një kandidati të pakicës greke me akuzën për blerje votash, apo tensionet në Kosovë, mund të ndikojnë në perceptimet e të anketuarve. Si rezultat, të anketuarit janë më të prirur t'i konsiderojnë pasojat e ekstremizmit të dhunshëm kryesisht në aspektin e kërcënimeve ndaj jetës së qytetarëve, shkeljeve të të drejtave dhe lirive dhe cenimit të sigurisë kombëtare.

Për të zbutur efektet që mund të kenë aktet e ekstremizmit të dhunshëm te popullsia, është me rëndësi që raportimi në media të mbetet i paanshëm kur mbulon tema të tilla të ndjeshme. Këto tema mund të manipulohen lehtësisht përmes një prizmi etno-populist, që kërkon të shfrytëzojë qasjen anti-elitiste të populizmit dhe apelin e tij drejtuar 'njerëzve të thjeshtë' kundër elitave të perceptuara.<sup>81</sup> Kjo ndërthuret me një fokus te nacionalizmi që i vë theksin identitetit kombëtar koheziv, shpesh duke përjashtuar pakicat ose duke mohuar ndikimet nga jashtë.


Gjetjet në këtë seksion tregojnë se kuptohen në forma të ndryshme ato që përbëjnë akte të ekstremizmit të dhunshëm. Ka një hierarki të dukshme në veprimet që mendohet se konsiderohen si ekstremizëm i dhunshëm, ku për kërcënimet fizike dhe përfshirjen në akte kriminale shprehet më shumë shqetësim. Gjithsesi, një pjesë e vogël e të anketuarve thanë se rrallëherë ose asnjëherë nuk e perceptojnë përfshirjen në aktivitete kriminale (17.9%) ose kërcënimet fizike ndaj individëve ose grupeve (14%) si forma të ekstremizmit të dhunshëm, edhe kur ato veprime kryhen për qëllime politike, fetare ose për motive ideologjike. Për më tepër, një në pesë shqiptarë nuk e konsideron problematike përhapjen e materialeve që promovojnë dhunën për arsye politike, fetare ose ideologjike. Këto vëzhgime na jerrin në pah nevojën për të vazhduar me përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm.

## Ekstremizmi politik dhe klima politike

**Pohimi:** Në zonën ku unë banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin politik.

16.3% e të anketuarve ishin dakord se në zonat ku jetojnë ka individë apo grupe që nxisin ekstremizmin politik, ndërsa shumica (70.5%) nuk ishin dakord dhe 13.2% ishin të pasigurt ose e konsideronin si pa lidhje këtë pohim. Krahasuar me sondazhin kombëtar të vitit 2021, ka një rënie me 11 p.p. në përqindjen e të anketuarve që raportojnë praninë e individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin politik në zonat e tyre. Mbështetësit e Grupit të Rithemelimit të PD-së (35%) ishin grupi demografik më i prirur për të rënë dakord me këtë pohim.

Grafiku 52. Në zonën ku unë banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin politik. (N=1600)



81 Varshney, A. Populizmi dhe nacionalizmi: Përmbledhje e ngjashmërive dhe dallimeve. *St Comp Int Dev* 56, 131–147 (2021), <https://link.springer.com/article/10.1007/s12116-021-09332-x>.

Të anketuarve që raportojnë për individë ose grupe që nxisin ekstremizmin politik iu kërkua të përshkruanin, në një pyetje të hapur, sjelljet, veprimet ose qëndrimet ekstremiste që kishin parë. Nga 242 përgjigje të marra (15.1% e kampionit të përgjithshëm), 14 përgjigje u konsideruan të pavlefshme.

Të anketuarit zakonisht e lidhin ekstremizmin politik me fushatën negative (47 të anketuar), që i referohet përhapjes së qëllimshme të informacionit të njëanshëm ose të rremë për të sulmuar ose dëmtuar kundërshtarin. Mungesa e dialogut ku kundërshtarët politikë të tregojnë respekt dhe diskursi i karakterizuar nga gjuha e urrejtjes, shpifja dhe gjuha agresive u etiketuan shpesh si sjellje ekstremiste.

Nxitja e votuesve ishte kategoria e dytë më e raportuar, për të cilën 45 të anketuar iu referuan përpjekjeve për të detyruar votuesit. Kjo kishte të bënte kryesisht me ofrimin e përfitimeve apo favoreve jofinanciare në këmbim të votave, duke reflektuar kështu një sfidë madhore për integritetin e procesit zgjedhor. Ndonëse përmendet më rrallë se nxitja e votuesve, blerja e votave ishte po ashtu një shqetësim i madh, për të cilën 10 të anketuar thanë se kishin qenë dëshmitarë të rasteve kur votat shkëmbeheshin drejtpërdrejt me para ose të mira materiale.

Të shpeshta ishin dhe rastet e dhunës kundër individit për shkak të përkatësisë politike (raportuar nga 22 të anketuar), veçanërisht gjatë fushatave elektorale – duke treguar një mjedis shumë të polarizuar në të cilin përkatësia politike mund të çojë në konflikte personale dhe dhunë. Përveç kësaj, të anketuarit kishin qenë dëshmitarë të kërcënimeve me dhunë fizike (shtatë të anketuar) dhe kërcënim me vdekje (dy të anketuar) për shkak të përkatësisë politike. Pesë të anketuar iu referuan edhe rasteve kur qytetarët u bënë objekt i sulmeve verbale për shkak të përkatësisë së tyre politike.

Problem i raportuar rëndom ishte edhe pjesëmarrja e detyruar politike (për 22 të anketuar), ku disa njerëz janë të detyruar të bëhen anëtarë të partive politike në zonën ku jetojnë ose të marrin pjesë në ngjarje apo aktivitete politike, si fushata elektorale ose protesta, për shkak të presionit të ushtruar ndaj tyre. Ky lloj presioni dhe detyrimi minon angazhimin vullnetar politik dhe është tregues i një mjedisi politik shtypës.

Në këtë kontekst, 18 të anketuar e konsideronin edhe favorizimin/kronizmin politik si formë të ekstremizmit. Ata besojnë se lidhja me partinë qeverisëse siguron avantazhe të mëdha, përfshirë rritjen e mundësive për punësim për qytetarët, përjashtimin e bizneseve nga gjogat dhe një preferencë të përgjithshme të shoqërisë ndaj anëtarëve të partisë. Më tej, janë raportuar të paktën tre raste të hakmarrjes me pushim nga puna për shkak të përkatësisë politike. Gjithashtu, 16 të anketuar kanë treguar se kanë qenë dëshmitarë të rasteve ku qytetarëve u mohohen të drejtat dhe shërbimet ose janë diskriminuar për shkak të përkatësisë së tyre politike.

Së fundi, nga 16 të anketuar u raportua mungesa e alternativave politike, e karakterizuar nga një centralizim i pushtetit brenda partisë qeverisëse si formë e ekstremizmit politik dhe u përmendën konflikte të brendshme brenda partive opozitare, gjë që tregon, sipas tyre, një mjedis mbytës politik dhe sfida për procesin demokratik. Të anketuar të tjerë (15 vetë) raportuan se ekstremizmi politik në zonën e tyre merr formën e sistemit të patronazhit (rrjetet e patronazhistëve), mbështetjes radikale ndaj një kandidati politik ose lidhjeve politike me grupet kriminale.




Tabela 7. Sjellje, veprime apo qëndrime të raportuara si ekstremizëm politik (N=242)

Sjellje, veprime apo qëndrime të raportuara	Nr. i të anketuarve
Dhuna ndaj individit për shkak të përkatësisë politike	22
Kërcënime me vdekje për shkak të përkatësisë politike	2
Kërcënime për dhunë fizike për shkak të përkatësisë politike	7
Dhuna verbale për shkak të përkatësisë politike	5
Pjesëmarrje e detyruar politike	22
Fushata negative	47
Mohimi i të drejtave dhe shërbimeve dhe diskriminimi politik	16
Hakmarrja me pushim nga puna për shkak të përkatësisë politike	3
Favoritizmi politik/kronizmi	18
Nxitja e votuesit	45
Blerja e votës	10
Mungesa e alternativave politike	16
Të tjera	15
Përgjigje të pavlefshme	14
<b>TOTAL</b>	<b>242</b>


**Pohimi:** Në zonën ku unë banoj, votimi për partinë në pushtet është i domosdoshëm për të mbajtur një vend pune në administratën publike.

Të anketuarve iu kërkua të deklaronin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër pikë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord” (4). Një shumice e konsiderueshme e të anketuarve (68.1%) thanë se votimi për partinë qeverisëse është i detyrueshëm për të mbajtur vendin e punës në administratën publike në zonën ku banojnë. Gati një e katërta e kampionit (24.4%) ishin kundër këtij pohimi. 7.5% e të anketuarve thanë se nuk e dinin ose e konsideronin si pa lidhje këtë pohim.

Përveç mbështetësve të Partisë Socialiste (PS), Grupit të Rithemelimit të PD-së (80%), Partisë Demokratike (80%), Partisë së Lirisë (77%) dhe atyre që nuk mbështesin asnjë grup politik (74%) të gjithë ishin të prirur të binin dakord se në zonën ku jetojnë, votimi për partinë qeverisëse është i detyrueshëm për të mbajtur vendin e punës në administratën publike.



Grafiku 53. Në zonën ku unë banoj, votimi për partinë në pushtet është i domosdoshëm për të mbajtur një vend pune në administratën publike. (N=1600)




**Pohimi:** Në zonën ku unë banoj ka politikanë që shprehimisht bëjnë thirrje për dhunë ndaj kundërshtarëve politike.

Pothuajse 1/3 e kampionit (29.2%) vuri në dukje praninë e politikanëve të cilët shprehimisht bëjnë thirrje për dhunë kundër kundërshtarëve politikë në zonën ku jetojnë, ndërkohë që vetëm 57.2% e kundërshtuan këtë pohim. Përveç kësaj, 10.2% u përgjigjën me “nuk e di” dhe 3.3% e konsideruan pohimin se nuk ka lidhje fare.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, ata me diplomë pasuniversitare (39%) si dhe ata që refuzuan të deklaronin nivelin e tyre arsimor (36%) ishin më të prirurit për të rënë dakord me pohimin.

Grafiku 54. Në zonën ku unë banoj ka politikanë që shprehimisht bëjnë thirrje për dhunë ndaj kundërshtarëve politike. (N=1600)




### Pohimi: Disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe u shërbejnë interesave të njëri-tjetrit.

74% e kampionit u shprehën dakord me pohimin se disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe se ata i shërbejnë interesave të njëri-tjetrit. Nga ana tjetër, 16.3% e të anketuarve nuk kishin këtë mendim, ndërsa 9.7% e të anketuarve e konsideruan pohimin si pa lidhje ose thanë se nuk e dinin.

Mbështetësit e Grupit të Rithemelimit të PD-së (95%), ata që nuk mbështesin asnjë parti (81%) dhe mbështetësit e Partisë Demokratike (80%) ishin më shumë të prirur të shpreheshin dakord se disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë.

Grafiku 55. Disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe u shërbejnë interesave të njëri-tjetrit. (N=1600)




### Pohimi: Pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi.

40.9% e të anketuarve besojnë se pandëshkueshmërisë së personave me pozita të larta në Shqipëri po i vjen fundi gjithnjë e më shumë, ndërsa më shumë se gjysma e kampionit (53%) nuk janë dakord. 6.1% e të anketuarve e konsiderojnë pohimin si pa lidhje ose janë përgjigjur me "nuk e di".

Të anketuarit vetëm me arsim fillor (48%) dhe mbështetësit e Partisë Socialiste (62%) prireshin më shumë të deklaroheshin se pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri po i vjen fundi gjithnjë e më shumë.



Grafiku 56. Pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi. (N=1600)




**Pohimi:** Opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje.

Një e katërta e kampionit (25.5%) beson se opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për një qeverisje më të mirë. Nga ana tjetër, 65.9% e të anketuarve nuk janë dakord me pohimin.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (33%) dhe ata me nivel arsimor më të ulët se ai fillor (46%) rezultuan se ishin më shumë të prirur të deklaronin se opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për një qeverisje më të mirë. Këtë mendim e kanë përgjithësisht edhe mbështetësit e Grupit të Rithemelimit të PD-së (40%) dhe Partisë së Lirisë (35%).

Grafiku 57. Opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje (N=1600)




### Pohimi: Aktorë qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike.

Më shumë se 3/4 e të anketuarve, 76.5%, besonin se aktorët qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike, ndërkohë që vetëm 16.7% e të anketuarve ishin kundër këtij pohimi dhe 6.8% e konsideronin atë si pa lidhje ose nuk ishin të sigurt për të.

Ata që janë mbështetës të Grupit të Rithemelimit të PD-së (93%), Partisë Demokratike (86%), ose nuk mbështesin fare asnjë parti (84%), ishin më të prirur të binin dakord se aktorët qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike. Këtë mendim zakonisht e kanë të anketuarit e papunë (84%) dhe studentët (82%).

Grafiku 58. Aktorë qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike (N=1600)




### Pohimi: Në zonën ku banoj, nepotizmi po e bën të vështirë gjetjen e mundësive të mira të punës.

Të anketuarve iu kërkua të deklaronin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër pikë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord”. Një shumicë e konsiderueshme (68%) ose ishin dakord (35.9%) ose plotësisht dakord (31.9%) se nepotizmi po e bën të vështirë gjetjen e mundësive të mira të punës në zonën ku jetojnë. Ndërkohë, 23% e pjesëmarrësve ose nuk ishin dakord (16.4%) ose aspak dakord (6.7%) me pohimin. Një përqindje më e vogël, 3.8% e konsideronin pohimin si të parëndësishëm për rrethanat e tyre dhe 5.4% ishin të pasigurt, duke u përgjigjur me “nuk e di”.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, mbështetësit politikë të Grupit të Rithemelimit të PD-së (85%), Partisë së Lirisë (79%) dhe ata që nuk mbështesin asnjë grup politik (73%) prireshin më shumë për t'u shprehur dakord me pohimin.

Grafiku 59. Në zonën ku banoj, nepotizmi po e bën të vështirë gjetjen e mundësive të mira të punës. (N=1600)



Rezultatet e sondazhit për ekstremizmin politik nxjerrin në pah se qytetarët janë po aq të shqetësuar për ekstremizmin politik (43.4%) sa ishin edhe në sondazhin e vitit 2021, me një rritje shumë të lehtë prej 1.4 p.p. Edhe pse ka pasur një rënie të ndjeshme të perceptimit për nxitjen e ekstremizmit politik, me 16.3% të anketuarve që raportuan nxitje në zonat e tyre – një rënie prej 11 p.p. që nga viti 2021 – shqetësimet për fushatën negative, presionin ndaj votuesve dhe detyrimin politik ishin ende të pranishme te të anketuarit. Në mënyrë të veçantë, një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve e lidhin ekstremizmin politik me veprime që minojnë integritetin zgjedhor dhe me politikanë që nxisin një mjedis politik të polarizuar ose mbytës e shtypës.

Për më tepër, nga sondazhi evidentohet një konsensus shqetësues për keqpërdorimin e institucioneve dhe burimeve shtetërore për interesa të ngushta politike, ku në total 76.5% e të anketuarve pranojnë se ka keqpërdorim. Po ashtu, rreth 68% e të anketuarve besojnë se nepotizmi e bën të vështirë gjetjen e mundësive për punë dhe se votimi për partinë qeverisëse si i detyrueshëm për mbajtjen e vendeve të punës në administratën publike, duke theksuar një marginalizim në rritje të mbështetësve të opozitës ose atyre që ndihen të papërfaqësuar në spektrin politik në Shqipëri. Mungesa që evidentohet për alternativat politike, e karakterizuar nga centralizimi i pushtetit brenda partisë qeverisëse, krahas konflikteve të brendshme mes partive opozitare, është tregues i një shoqërie të polarizuar.

Së fundmi, Prezenca e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Shqipëri ka bërë disa rekomandime për të rritur integritetin zgjedhor,<sup>82</sup> duke theksuar rëndësinë e kryerjes së një hetimi të shpejtë dhe gjithëpërfshirës për akuzat serioze për parregullsi zgjedhore, përfshirë këtu blerjen e votave, ushtrimin e presionit ndaj votuesve dhe shfrytëzimin e burimeve shtetërore për avantazhe elektorale. Përveç kësaj, OSBE-ja i vuri theksin edhe domosdoshmërisë së zbatimit të masave procedurale për të garantuar fshehtësinë e votimit, për të parandaluar kështu praktika të tilla si frikësimi i votuesve, votimi në grup dhe votimi në emër të dikujt tjetër. Masa të tilla synojnë të rrisin ndërgjegjësimin e publikut për këto praktika të dëmshme dhe të sigurojnë një proces të drejtë zgjedhor – gjë që është e domosdoshme në dritën e gjetjeve të këtij sondazhi.



82 OSBE, Prezenca e OSBE-së thekson nevojën për përparim në reformën zgjedhore në Shqipëri gjatë takimit të posaçëm të Grupit Ndërkombëtar të Punës Zgjedhore, 7 dhjetor 2023, <https://www.osce.org/presence-in-albania/560058>.



*Tendencat e shfaqura në lidhje me ekstremizmin politik kanë të bëjnë me normalizimin e fushatës negative, rrënjosjen e praktikave të nxitjes së votuesve dhe përjetësimin e një kulture politike që toleron ose madje edhe nxit dhunën dhe presionin. Këto praktika jo vetëm që kërcënojnë integritetin e procesit zgjedhor, por përkeqësojnë ndasitë shoqërore dhe minojnë demokracinë dhe besimin e qytetarëve tek institucionet demokratike.*

*Gjetjet tregojnë se problemet që ka të ngjarë të përkeqësojnë prirjen e individëve drejt ekstremizmit të dhunshëm përfshijnë nxitjen e qartë të dhunës nga politikanët dhe zënkat verbale ose fizike për shkak të përkatësisë politike. Për më tepër, lidhjet e rrënjosura mes disa anëtarëve të elitave politike dhe rrjeteve kriminale, zhgënjimi me aftësinë e opozitës për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme qeverisëse mund të kontribuojnë më tej në një mjedis të favorshëm për përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm. Për të trajtuar këto probleme madhore, është i nevojshëm trajtimi i tensioneve dhe konflikteve të brendshme mes anëtarëve të partive politike, të cilët ose janë të përfshirë si objektivi ose si kontribues në përshkallëzimin e dhunës. Rritja e kapacitetit të tyre për të administruar dhe ulur konfliktet është jetike për krijimin e një mjedisi politik më paqësor dhe konstruktiv.*


*Mbështetësit e Partisë Demokratike (PD) dhe të Grupit të Rithemelimit të PD-së ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin në lidhje me nxitjen e ekstremizmit politik, detyrimin për të votuar për partinë në pushtet për të mbajtur vendin e punës dhe lidhjen mes elitave politike dhe rrjeteve kriminale. Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohjes së këtyre çështjeve mund të jetë tregues i një ekspozimi më të madh dhe rrezik në rritje për t'u ndikuar nga subjekte që nxisin ekstremizmin politik mes fraksioneve të opozitës. Këto mendime theksojnë nevojën për përpjekje të bashkërenduara për të trajtuar shkaqet bazë të polarizimit politik, për të siguruar integritetin e proceseve zgjedhore dhe për të nxitur një debat politik gjithëpërfshirës dhe pozitiv.*

## Ekstremizmi etno-nacionalist dhe vëzhgimet sociale në përgjithësi

**Pohimi:** Në zonën ku unë banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin etno-nacionalist.

Të anketuarve iu kërkua të deklaronin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër pikë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord”. Vetëm 3.5% e të anketuarve janë dakord se në zonën ku banojnë ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin etno-nacionalist, ndërkohë që 80.7% janë kundër dhe 15.9% nuk janë të sigurtë ose e konsiderojnë pohimin si pa lidhje. Krahasuar me sondazhin kombëtar të vitit 2021, kjo përqindje përfaqëson një rënie me 4.1 p.p. të numrit të të anketuarve që pohojnë praninë e individëve ose grupeve që nxisin ekstremizmin etno-nacionalist në zonat e tyre.

**Grafiku 60.** Në zonën ku unë banoj, ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin etno-nacionalist. (N=1600)



Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, nuk vihen re dallime të mëdha ndërmjet variablave.

Të anketuarve që vunë re se në zonën ku banojnë ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin etno-nacionalist iu kërkua të përshkruanin sjelljet, veprimet apo qëndrimet ekstremiste që kishin parë. Nga 42 përgjigje që u dhanë, 7 ishin të pavlefshme.

Ndër sjelljet, veprimet ose qëndrimet e veçanta të ekstremizmit etno-nacionalist që ata kishin dëshmuar, diskriminimi ishte kategoria më e raportuar, me 11 të anketuar që vunë re forma të ndryshme të diskriminimit, përfshirë këtu diskriminimin racor, etnik ose kombëtar. Pesë të anketuar kanë qenë dëshmitarë të gjuhës së urrejtjes, gjuhës poshtëruese ose nxitjes së urrejtjes kundër grupeve të veçanta etnike, ndërsa dy të anketuar raportuan incidente ku individëve u janë mohuar të drejtat dhe shërbimet bazë, që të anketuarit ia atribuonin përkatësisë etnike.

Pesë të anketuar mendonin se një përshkallëzim në konfliktin Kosovë-Serbi mund të nxiste ose përkeqësonte qëndrimet ose sjelljet ekstremiste përgjatë linjave etnike ose nacionaliste. Përveç kësaj, një i anketuar raportoi qëndrime në lidhje me bashkimin e Kosovës dhe Shqipërisë si një formë e ekstremizmit etno-nacionalist.

Katër të anketuar përmendën incidente të nacionalizmit, që mund të nënkuptojnë ndjenja ekstreme patriotike, apo ndjenja që mund të çojnë në përjashtimin ose armiqësinë ndaj grupeve të tjera etnike. Tre të anketuar raportuan se ishin dëshmitarë të akteve të dhunës që ishin të motivuara në mënyrë specifike nga përkatësia etnike e viktimave. Të paktën një i anketuar tha se kishte qenë dëshmitar i një kërcënimi me vdekje në mënyrë specifike për shkak të përkatësisë etnike të dikujt. Një tjetër i anketuar evidentoi dhunë psikologjike, ku mund të përfshihet ngacmimi ose frikësimi për shkak të përkatësisë etnike.


Gjashtë të anketuar preferuan të mos specifikonin se cilat pakica kombëtare u bënë pre e sjelljeve negative në zonën ku ata jetojnë. Kur bëhet fjalë se cilat pakica kombëtare dhe etnike janë më të ekspozuara ndaj tendencave diskriminuese, tre të anketuar vunë në dukje se romët dhe egjiptianët ishin objekt diskriminimi. Dy të anketuar vunë në dukje tendenca diskriminuese ose gjuhë urrejtjeje të drejtuara kundrejt pakicave greke. Në të njëjtën linjë, dy të anketuar kanë vënë re sjellje diskriminuese ose gjuhë urrejtjeje që ka si objektiv serbët dhe dy të anketuar të tjerë kundër maqedonasve. Një i anketuar ishte dëshmitar i gjuhës së urrejtjes që kishte në shënjestër bullgarët.

**Pohimi:** Ju personalisht do ta mbështesnit një anëtar të familjes tuaj (motra/vëllezër ose fëmijët tuaj) po të martohej me një person të një përkatësie tjetër etnike?

Të pyetur nëse do ta mbështesnin një anëtar të familjes së tyre (motra/vëllezër ose fëmijët tuaj) po të martohej me një person të një përkatësie tjetër etnike, më pak se gjysma e të anketuarve ishin dakord se do ta mbështesnin një gjë të tillë, ku 47% e të anketuarve thanë "Po". 22.9% e të anketuarve thanë se do ta pranonin martesën, por nuk do ta mbështesnin apo inkurajojnë atë. Vetëm 10.5% do të kundërshtonin në çdo rast nëse një anëtar i familjes do të martohej me një person që i përket një etnie tjetër, dhe 14.9% nuk ishin të sigurt se si do të ndiheshin në rrethana të tilla. 4.7% e të anketuarve refuzuan të përgjigjen.



Grafiku 61. Përqindja e të anketuarve që do të mbështesnin një anëtar të familjes po të martohej me një person të një përkatësie tjetër etnike (N=1600)




**Pohimi:** Ka një komplot të madh për të shpopulluar Shqipërinë dhe për të zëvendësuar qytetarët e saj me emigrantë të huaj.

Të anketuarve iu kërkua të deklaronin nëse ishin dakord ose jo me pohimin duke përdorur një shkallë me katër pikë nga “aspak dakord” (1) deri në “plotësisht dakord”. Me këtë pohim kanë rënë dakord 38.9% e të anketuarve, ndërkohë që e kanë kundërshtuar 44.3%. 10.4% e kampionit thanë se nuk e dinin dhe 6.5% e të anketuarve e konsideruan pohimin si pa lidhje.

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike, të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (46%), bektashinjte (47%), ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (50%) dhe ata që luten/falen rregullisht (53%) ishin më shumë të prirur të binin dakord me pohimin. Perceptimi se ka një komplot të madh për të shpopulluar Shqipërinë dhe për të zëvendësuar qytetarët e saj me emigrantë të huaj u shpreh rëndom nga mbështetësit e Partisë së Lirisë (79%), Grupit të Rithemelimit të PD-së (78%) dhe Partisë Demokratike (56%).

Grafiku 62. Ka një komplot të madh për të shpopulluar Shqipërinë dhe për të zëvendësuar qytetarët e saj me emigrantë të huaj. (N=1600)




### Pohimi: Shqiptarët nuk duhet të përzihen me raca të tjera.

38% e të anketuarve janë dakord që shqiptarët nuk duhet të përzihen me racat e tjera. Gjysma e kampionit (50.5%) e kundërshton këtë pohim. 7.5% e të anketuarve e konsiderojnë atë si pa lidhje, ndërsa 4.1% nuk dinin të jepnin përgjigje.

Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (47%), ata të grupmoshës 55-64 vjeç (46%) dhe të anketuarit që identifikohen si bektashinj (49%) ose katolikë (43%) kishin më shumë gjasa të binin dakord se shqiptarët nuk duhet të përzihen me racat e tjera. Ky perceptim u shpreh më shpesh nga të anketuarit që kanë përfunduar arsimin e mesëm (44%) dhe ata që janë të papunë (44%). Mbështetësit politikë të Partisë Demokratike (56%), Partisë së Lirisë (50%) dhe Grupit të Rithemelimit të PD-së (45%) ishin po aq të prirur të binin dakord me pohimin. Mes besimtarëve praktikantë, ata që praktikojnë rregullisht të gjitha ritet e fesë së tyre (48%) dhe ata që praktikojnë ritet kryesore fetare (46%) prireshin më shumë të kishin të njëjtin mendim si ata më sipër.

Grafiku 63. Shqiptarët nuk duhet të përzihen me raca të tjera. (N=1600)




### Pohimi: Në zonën ku unë banoj, të jesh minoritar sjell përfitime të shumta sociale dhe ekonomike.

Sipas 21.7% të të anketuarve në zonën ku ata jetojnë, të qenurit anëtar i një grupi pakice sjell përfitime të shumta sociale dhe ekonomike. Rreth gjysma e kampionit (51.7%) treguan se nuk ishin dakord me pohimin. 20.1% e të anketuarve thanë se nuk e dinin dhe 6.5% të tjerë të kampionit e konsideruan pohimin të parëndësishëm. Kur u shqyrtuan të dhënat e kryqëzuara, nuk u vunë re dallime të mëdha mes grupeve demografike.




Grafiku 64. Në zonën ku unë banoj, të jesh minoritar sjell përfitime të shumta sociale dhe ekonomike. (N=1600)



Kur u pyetën nëse vënë vërejtur ndonjë diskriminim të hapur ose gjuhë urrejtjeje kundër individëve gjatë vitit të kaluar, një pjesë e vogël e kampionit, 9.8%, u përgjigj duke pohuar. Shumica e të anketuarve, me 67.9%, thanë se nuk kishin qenë dëshmitarë të incidenteve të tilla në 12 muajt e fundit. Një segment i kampionit (15.4%) ishte i pasigurt, ndërsa 7% zgjodhën të mos i përgjigjeshin pyetjes.

Grafiku 65. Forma të tjera të diskriminimit apo gjuhës së urrejtjes kundër një individi (N=1600)





Të anketuarve që iu përgjigjën “Po” pyetjes së mëparshme, iu kërkua më tej të specifikonin se kundër cilit grup shoqëror ishin bërë aktet diskriminuese. Nga kampioni i përgjithshëm, kësaj pyetjeje iu përgjigjën 140 të anketuar. Mes 83 përgjigjeve të vlefshme, romët/egjiptianët ishin komuniteti më i përmendur (29 të anketuar), të ndjekur nga partitë opozitare dhe mbështetësit e tyre (16 të anketuar) dhe myslimanët (11 të anketuar). 54 të anketuar preferuan të mos specifikojnë grupin social/etnik.

Duke qenë se diskriminimi shpesh nuk raportohet, ndryshimet e fundit në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkojnë mbrojtje specifike nga format e shumfishta, ndërsektoriale dhe strukturore të diskriminimit, gjuhës së urrejtjes, veçimit dhe ngacmimit seksual.<sup>83</sup> Raporti i vitit 2022 i Departamentit të Shtetit të SHBA-së mbi praktikën e të drejtave të njeriut në Shqipëri nxjerr në pah pretendimet për diskriminim që synojnë anëtarët e komunitetit rom dhe ballkano-egjiptian në Shqipëri, “përfshirë strehimin, punësimin, kujdesin shëndetësor dhe arsimin. Deri në gusht, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë 17 ankesa për diskriminim për shkak të racës dhe përkatësisë etnike, duke vendosur në favor të ankuesit në pesë raste.”<sup>84</sup> Nga personat që i përkasin pakicës maqedonase janë bërë më pak ankesa.<sup>85</sup>

Duke hedhur dritë mbi format e ndryshme të diskriminimit, pjesa më e madhe e të anketuarve dhanë shpjegime për përgjigjet e tyre, siç detajohet në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 8. Format e diskriminimit që kanë parë të anketuarit (N=114)*

Format e diskriminimit	Nr. i rasteve
Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes për shkak të përkatësisë politike	30
Diskriminimi për shkak të përkatësisë etnike	39
Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes për shkak të besimit fetar	19
Dhunë verbale	4
Diskriminimi për shkak të statusit social-ekonomik	9
Diskriminimi për shkak të orientimit seksual	6
Diskriminimi me bazë gjinore	2
Dhuna verbale për shkak të statusit social-ekonomik	2
Diskriminimi për shkak të moshës	3
<b>GJITHSEJ</b>	<b>114</b>

Forma e diskriminimit e raportuar më shpesh ishte përkatësia etnike, me 39 raste, që pasohet nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes për shkak të përkatësisë politike, me 30



83 Republika e Shqipërisë, Kuvendi, Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, marrë nga <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/11/LMD-i-perditesuar-1.pdf>

84 Departament Amerikan i Shtetit, Raporti mbi praktikën e të drejtave të njeriut: Shqipëria, <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>

85 Këshilli i Evropës, Opinioni i pestë për Shqipërinë, 6 qershor 2023, <https://rm.coe.int/5th-op-albania-en/1680acf90e>




raste. Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes për shkak të besimit fetar u raportuan 19 herë. Diskriminimi për shkak të statusit social-ekonomik dhe ai për shkak të orientimit seksual janë raportuar përkatësisht 9 dhe 6 herë. Diskriminimi me bazë gjinore, moshe dhe dhuna verbale për shkak të statusit social-ekonomik janë më pak të raportuarat, me dy, tre dhe dy përkatësisht.

*Pyetjet e sondazhit që trajtojnë ekstremizmin etno-nacionalist në Shqipëri tregojnë për një prirje relativisht të ulët, me vetëm 3.5% të të anketuarve që e pranojnë këtë lloj ekstremizmi në zonat e tyre. Kjo tregon një rënie nga sondazhet e mëparshme, pavarësisht shqetësimeve në rritje për etno-nacionalizmin në vend. Disa incidente të raportuara të nacionalizmit, dhunës etnike dhe diskriminimit sugjerojnë tensione që nuk dalin në sipërfaqe.*

*Në mënyrë të veçantë, episodet sporadike të diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe akteve të dhunës të motivuara nga përkatësia etnike, përfshirë këtu kërcënimet dhe dhunën psikologjike, nxjerrin në pah paragjykimet e vazhdueshme etnike. Aktorët shtetërorë dhe joshetërorë duhet të rrisin raportimin e rasteve të diskriminimit, për të mundësuar monitorimin e vazhdueshëm të situatës ndërmjet grupeve të ndryshme minoritare dhe të marginalizuara. Duke qenë shpesh një pararendës ose komponent i etno-nacionalizmit ose politikës së ekstremizmit të djathtë, modelet e diskriminimit duhet të analizohen dhe përdoren për të fuqizuar grupet e synuara nëpërmjet ndërhyrjeve të përshtatura sipas nevojave të tyre.*

*Parashikimi i konflikteve rajonale që i përkeqësojnë këto problematika është treguesi i pranisë së dinamikave të paqëndrueshme rajonale që mund të nxisin ekstremizmin. Megjithatë, shqetësimet shtrihen përtej tenseve etnike në çështjet e shoqërisë, siç janë pikëpamjet e ndryshme për martesat ndëretnike, gjë që sugjeron një qëndrim të ndarë për integrimin etnik. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve janë dakord me teorinë e konspiracionit për shpopullimin e vendit dhe zëvendësimin me emigrantë të huaj, duke reflektuar ksenofobinë dhe mungesën e besimit. Duke pasur parasysh numrin në rritje të emigrantëve në Shqipëri, këto gjetje përbëjnë sfida madhore për të ardhmen.*

*Të dhënat demografike tregojnë se të anketuarit mbi 65 vjeç, besimtarët bektashinj, simpatizantët e partive politike si Partia Demokratike, Partia e Lirisë dhe Grupi i Rithemelimit të PD-së, si dhe të papunët dhe individët që kanë përfunduar vetëm arsimin e mesëm, janë më të prirur ndaj qëndrimeve përjashtuese dhe konspirative.*



## 7. Përfundime dhe rekomandime

Vlerësimi kombëtar i vitit 2024 i nxitësve, formave dhe kërcënimeve të ekstremizmit të dhunshëm paraqet një përditësim të faktorëve në të cilat duhet të përqendrohet në vijim lufta e Shqipërisë kundër ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë një eksplorim të perceptimeve të ekstremizmit politik dhe kërcënimeve të tjera në zhvillim. Duke u mbështetur në këtë objektiv të zgjeruar, në raport jepen informacione dhe rekomandime që duhen zbatuar me qëllim përmirësimit të masave që ka ndërmarrë Shqipëria për parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (P/KEDH). Ky vlerësim ka si synim të informojë dhe plotësojë përpjekjet e qeverisë shqiptare dhe aktorëve të tjerë të P/KEDH për rritjen e qëndrësës ndaj spektrit të gjerë të ekstremizmit të dhunshëm dhe për të bërë të mundur një përgjigje proaktive dhe të përshtatshme në mbrojtje të shoqërisë shqiptare dhe vlerave të saj demokratike.

Ndërkohë që vendi po i afrohet një dekade në zbatimin e masave P/KEDH, është arritur progres i konsiderueshëm në trajtimin e ekstremizmit fetar. Megjithatë, natyra në zhvillim e ekstremizmit të dhunshëm vazhdon të krijojë sfida. Duke u thelluar në format dhe nxitësit kryesorë të ekstremizmit të dhunshëm, ky raport është strukturuar në tre kapituj kryesorë, të cilët analizojnë perceptimet e qytetarëve përmes prizmit të nxitësve social-ekonomikë, politikë dhe kulturorë të përdorur edhe në vlerësimet e mëparshme kombëtare, si dhe një sërë pyetjesh të reja që hedhin dritë mbi rreziqet e reja.

Shqetësimet për ekstremizmin politik mbizotërojnë ndaj atyre për ekstremizmin etno-nacionalist dhe fetar, me 43.4% të të anketuarve që e konsiderojnë atë si problem kombëtar. Në mënyrë të veçantë, në sjelljet e raportuara që identifikohen si ekstremizëm politik përfshihen fushatat negative, kërcënimi i votuesve dhe dhuna ndaj individit për shkak të përkatësisë politike, gjë që pasqyron një mjedis të tensionuar dhe të polarizuar politik. Në kontrast me këtë, shqetësimet për ekstremizmin fetar (30.6%) dhe etno-nacionalizmin (27%) janë në nivele më të ulëta se në vitet e mëparshme, ndonëse të anketuarit kanë qenë dëshmitarë të rasteve sporadike të diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe intolerancës fetare.

Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve ndihen të shkëputur nga shoqëria dhe të prirur drejt sjelljeve të rrezikshme. Një gjendje e tillë mund të rrisë mundësitë për ndërhyrje nga grupet e ekstremizmit të dhunshëm, të cilat ofrojnë ndjesinë e qëllimit në jetë. Të pyetur për praninë e individëve apo grupeve që nxisin ekstremizmin në zonën ku jetojnë, 16.3% e të anketuarve pranuan ekzistencën e grupeve që nxisin ekstremizmin politik. Ndërkohë, vetëm 3.5% raportuan raste të etno-nacionalizmit dhe 6.6% identifikuan grupe që nxisnin ekstremizmin fetar në zonën e tyre. Pavarësisht një rënieje të vogël të përqindjes së përgjithshme të raportimit të ekstremizmit të dhunshëm, në vend ka një skepticizëm të konsiderueshëm ndaj aftësive të sistemit arsimor për të përmbushur kërkesat e tregut të punës. Një përqindje e vogël e të anketuarve, që përbën shqetësim gjithsesi, treguan gatishmëri për t'u përfshirë në aktivitete të paligjshme për përfitime financiare, të detyruar nga vështirësitë e mëdha ekonomike. Po ashtu, gati gjysma e të anketuarve pohonin praninë e organizatave fetare që ofrojnë të mira materiale për ata që ushtrojnë besimin fetar, gjë që përbën tregues për shfrytëzimin e mundshëm të dobësive social-ekonomike nga grupe të caktuara.

Sondazhi nxjerr në pah një ndarje të konsiderueshme mes të anketuarve në Shqipëri për sa i përket respektimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve nga institucionet shtetërore, ku gati gjysma e të anketuarve mendojnë se këto të drejta e liri respektohen. Pothuajse gjysma e të anketuarve e konsideronin sistemin politik si të padrejtë dhe mbështesnin idenë e miratimit të ndryshimit edhe përmes dhunës nëse është e nevojshme. Mbështetja për këtë pohim mbetet



e qëndrueshme, duke nxjerrë në pah polarizimin për sa i përket të drejtave politike, lirive civile dhe efektivitetit të sistemit politik në Shqipëri. Për më tepër, rreth 1/4 e shqiptarëve i konsideronin institucionet e zbatimit të ligjit si më të ashpra ndaj myslimanëve praktikantë dhe ka një rritje të besimit në të drejtën për të bërë vetëgjyqësi kur institucionet shtetërore nuk arrijnë të mbrojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Ky është tregues i rritjes së mbështetjes për ndërmarrjen e veprimeve kundër padrejtësive të perceptuara, duke nënvizuar rëndësinë e trajtimit të barabartë nga institucionet e zbatimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të parandaluar radikalizimin dhe për të nxitur besimin e komunitetit tek institucionet shtetërore.

Gjetjet tregojnë se shumica e shqiptarëve e kundërshtojnë përfshirjen e civilëve në konfliktet e armatosura të huaja, ku vërehet një rënie në mbështetjen për aktivitete të tilla. Gjithashtu, një shumicë e konsiderueshme nuk është dakord me pikëpamjen se përfshirja ushtarake e Shqipërisë jashtë vendit është fyerje për myslimanët. Megjithatë, ka pasur një rënie në besimin se feja luan një rol në rritjen e drejtësisë dhe në lidhjen e fesë me rënieën e korrupsionit të qeverisë. Për më tepër, është mjaft e dukshme mungesa e besimit tek integriteti i qeverisë dhe për lidhjet e elitave politike me kriminelë, ndërkohë që kemi një optimizëm të vogël për sa i përket aftësisë së opozitës politike për të ofruar alternativa të qëndrueshme. Ky skepticizëm shtrihet edhe në arenën ndërkombëtare, ku një e katërta e të anketuarve i konsiderojnë strukturat politike dhe ekonomike globale si mjete të Perëndimit për të sunduar mbi vendet myslimane. Një e treta e të anketuarve e konsiderojnë BE-në dhe SHBA-në si të njëanshme ndaj disa vendeve të Ballkanit për shkak të përkatësisë fetare dhe interesave gjeopolitike. Këto opinione pasqyrojnë sfidat me të cilat përballet Shqipëria në sistemin e saj politike dhe të zbatimit të ligjit, gjë që thekson nevojën për një qasje më transparente e të barabartë ndaj qeverisjes si dhe angazhimit të komunitetit ndërkombëtar për të trajtuar këto shqetësime të përhapura.

Në Shqipëri, ekziston një konsensus i gjerë mes popullatës se në përgjithësi nuk është problem të jesh besimtar praktikant i fesë islame apo të krishterë, duke reflektuar një përmirësim në lirinë e ushtrimit të besimit fetar që nga viti 2021. Sfidat ende vazhdojnë për një pakicë, ku 11.6% e të anketuarve me përkatësi fetare myslimane dhe 7.1% të krishterë pranuan vështirësitë në këtë drejtim, ndonëse këto shifra janë me ulje prej 8.3 dhe 2.4 p.p. përkatësisht që nga sondazhi i mëparshëm. Perceptimi se në vend ka ndikime të huaja konservatore islame mbi besimtarët myslimanë është ulur me 14.3 p.p., edhe pse 24.8% e të anketuarve vazhdojnë ta ndiejnë këtë. Një pjesë mjaft e konsiderueshme e të anketuarve (71.7%) mendojnë se besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit të tyre fetar janë të sigurta, pavarësisht një rënieje të lehtë prej 6.8 p.p. që nga sondazhi i fundit. Ndonëse 64.7% e shqiptarëve nuk shprehën asnjë shqetësim për ekstremizmin fetar, 30.6% janë ende të shqetësuar, përqindje që ka një rënie minimale prej 1.2 p.p. nga viti 2021. Po ashtu, 79.9% hodhën poshtë mendimin se në zonën ku banojnë ka individë ose grupe që nxisin ekstremizmin fetar, me një rënie prej 5.5 p.p., duke lënë 6.6% të të anketuarve që janë dakord. Në sjelljet, veprimet dhe qëndrimet kryesore që u perceptuan nga të anketuarit si ekstremiste ose nxitëse të ekstremizmit përfshiheshin intoleranca fetare, islamofobia dhe efektet e konflikteve globale, gjë që thekson nevojën për dialog të ndërtuar mbi vlerat e përbashkëta kombëtare dhe fetare. Të dhënat tregojnë se është bërë progres, ndonëse nënvizojnë sfidat e vazhdueshme që hasen me ndikimet e huaja fetare, marginalizimin dhe ekstremizmin fetar, dhe theksojnë rolin parësor të autoriteteve fetare dhe të dialogut gjithëpërfshirës për nxitjen e kohezionit social dhe luftën kundër ndikimeve fundamentaliste.

Kapitulli i ri që u shtua për shtytësit politikë të ekstremizmit të dhunshëm dhe rreziqeve të tjera në zhvillim në Shqipëri nxjerr në pah shqetësime të mëdha. Në përgjithësi, pranohet përkufizimi për ekstremizmin dhe dhunshëm dhe seriozitetin e pasojave të tij, përfshirë këtu jo vetëm kërcënimet për jetët e individëve dhe sigurinë kombëtare, por edhe për ndikimin e tij në kohezionin social dhe funksionimin e shtetit. Rritja e ndërgjegjësimit dhe shqetësimet në rritje për ekstremizmin politik dhe etno-nacionalist tek të anketuarit sugjerojnë frikë në



rritje ndaj këtyre formave të ekstremizmit, duke reflektuar tensione më të gjera rajonale dhe, rrjedhimisht, rritje të ekspozimit të mundshëm ndaj tyre.

Rezultatet e sondazhit sugjerojnë se ndonëse perceptimi për nxitjen e ekstremizmit politik duket se po zvogëlohet, problematika të tilla si fushata negative, kërcënimi i votuesve dhe detyrimi për pjesëmarrje politike vazhdojnë të jenë të përhapura. Një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve raportuan keqpërdorimin e burimeve shtetërore për përfitime politike dhe e konsideruan punësimin në administratën publike si të kushtëzuar nga mbështetja për partinë në pushtet. Faktorë të tjerë rreziku për përkeqësimin e ekstremizmit të dhunshëm janë nxitja e drejtpërdrejtë e dhunës nga politikanët dhe zhgënjimi me opozitën politike, duke nxjerrë në pah nevojën për të zbutur polarizimin politik, për të garantuar integritetin e procesit zgjedhor dhe për të promovuar debatin gjithëpërfshirës politik.

Gjetjet e sondazhit sugjerojnë se ka rritje të shqetësimit për identitetin kombëtar, i cili shpesh është një pararendës ose faktor kontribuues për ideologjitë e ekstremizmit të dhunshëm. Gjetjet nxjerrin në pah shqetësimet në rritje midis të anketuarve për sa i përket identitetit kombëtar, ku 38.9% besojnë në ekzistencën e një komploti për të zëvendësuar qytetarët shqiptarë me emigrantë të huaj, ndërsa një përqindje e ngjashme (38%) kundërshtojnë përzierjen me raca të tjera. Megjithatë, rreth një në pesë të anketuar kanë deklaruar se kanë qenë dëshmitarë të përfitimeve sociale dhe ekonomike si anëtar i grupeve minoritare në zonën e tyre. Këto gjetje na bëjnë të mendojmë se kërcënimet e reja me të cilat do të përballet Shqipëria ka të ngjarë të lidhen me çështjet e ndryshimeve demografike, integritetit dhe të drejtave të pakicave, duke sugjeruar se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë shpreh shqetësime për diversitetin etnik dhe ndikimin e tij të mundshëm në strukturën sociale të Shqipërisë.

## Rekomandime


Është e rëndësishme t'u jepet përparësi hapave të mëposhtëm në krijimin e qasjes ndërsektoriale të nevojshme për të trajtuar nxitësit e ekstremizmit të dhunshëm dhe kërcënimet e reja në Shqipëri:

- ☞ Përmirësimi i kohezionit social dhe i qëndrësës në komunitete duke mbështetur dhe zbatuar programe komunitare ku angazhohen aktivisht grupe të ndryshme, përfshirë të rinjtë, gratë dhe grupet e marginalizuara, me qëllim uljen e diskriminimit shoqëror. Duke mbështetur nisma të tilla, aktorët e P/KEDH-së do të kontribuojnë në forcimin e lidhjeve sociale, gjë që e bën komunitetin më pak të prirur për t'u bërë objekt tërheqës ndaj ideologjive ekstremiste.
- ☞ Përmirësimi i mekanizmave të llogaridhënies është me rëndësi jetike në luftën kundër korrupsionit dhe për trajtimin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore. Praktika të tilla shpesh çojnë në pakënaqësi nga grupet e marginalizuara, gjë që krijon një mjedis ku mund të lulëzojnë ideologjitë ekstremiste. Me forcimin e masave të llogaridhënies, të tilla si transparenca dhe mbikëqyrja, qeveria mund të rikthejë gradualisht besimin dhe legjitimitetin, duke ngushtuar kështu hapësirat për propagandën ekstremiste që lulëzon në sajë të këtyre pakënaqësive.
- ☞ Për të trajtuar shkaqet bazë të zhgënjimit me politikën, është e rëndësishme të promovohet angazhimi qytetar. Duke nxitur një kulturë të përgjegjshmërisë qytetare dhe pjesëmarrjes aktive në proceset demokratike, me fokus në edukimin dhe fuqizimin e elektoratit shqiptar, aktorët joshetërorë (si organizatat e shoqërisë civile dhe drejtuesit me ndikim në komunitet) mund të jenë në pozicion më të favorshëm për të realizuar nisma inovatore të edukimit qytetar. Këto nisma duhet të synojnë orientimin e grupeve të ndryshme të synuara drejt rritjes së pjesëmarrjes qytetare dhe distancimit nga polarizimi politik. Kjo mund të bëhet në forma të tilla si edukimi i votuesve për



të ndihmuar popullatën, veçanërisht të moshuarit dhe të rinjtë - për të vlerësuar në mënyrë kritike mesazhet politike, duke rritur kështu qëndresën e tyre ndaj efekteve përçarëse të fushatave negative.

- ⇒ Është e nevojshme të monitorohet vazhdimisht perceptimi publik për format e ekstremizmit të dhunshëm dhe rreziqeve të reja dhe për të përshtatur ndërhyrjet P/KEDH sipas nevojës. Në këtë mënyrë do të bëhet e mundur që ndërhyrjet të shërbejnë në përgjigje të mjedisit dhe rreziqeve të reja, duke forcuar kështu qëndresën dhe qëndrueshmërinë e komuniteteve.
- ⇒ Dialogu gjithëpërfshirës ka një rol të pazëvendësueshëm për të luftuar ekstremizmin fetar dhe diskriminimin për shkaqe fetare, me qëllimin përfundimtar forcimin e kohezionit social në Shqipëri. Këtu përfshihet fuqizimi i komuniteteve fetare për të angazhuar besimtarët praktikantë dhe komunitetin e gjerë në promovimin e mirëkuptimit, për të zbutur ndikimet e huaja në çështjet fetare dhe për të luftuar propagandën ekstremiste dhe diskriminimin. Me nxitjen e dialogut që mbështetet në vlerat dhe traditat e përbashkëta kombëtare, Shqipëria mund të kultivojë një mjedis ku mbizotërojnë toleranca, respekti dhe qëndresa ndaj ideologjive përçarëse, duke forcuar kështu unitetin shoqëror dhe duke promovuar harmoninë ndërfaqetare.



## 8. Shtojcat

### 8.1 Shpërndarja e kampionit të sondazhit

Qarku	Madhësia e kampionit për qark		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Berat	32	33	65
Dibër	32	30	62
Durrës	85	83	168
Elbasan	72	74	146
Fier	78	79	157
Gjirokastrë	15	16	31
Korçë	55	57	112
Kukës	21	20	41
Lezhë	32	34	66
Shkodër	53	57	110
Tiranë	264	272	536
Vlorë	53	53	106
<b>Total</b>	<b>792</b>	<b>808</b>	<b>1,600</b>



## 8.2 Instrumenti i pyetësorit



Institute  
for Democracy  
and Mediation

# PYETËSOR I OPINIONIT PUBLIK

## mbi ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e Ambasadës së ShBA në Tiranë është duke zhvilluar një hulumtim mbi praninë e ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, në kuadër të së cilit po kryhet ky sondazh me qytetarë të përzgjedhur në mënyrë rastësore. Do të dëshironim t'ju bënim disa pyetje në lidhje me mendimet tuaja mbi faktorët socio-ekonomikë, politikë dhe kulturorë të cilët mund të ndikojnë në cenueshmërinë e komunitetit ku ju banoni ndaj ideologjive të dhunshme ose radikale.

Ju mund të vendosni të mos merrni pjesë në anketim, ose mund të më bëni me dije që preferoni të mos i përgjigjeni një pyetjeje specifike dhe unë do ta kapërcej atë pyetje.

Ju garantojmë që i gjithë informacioni që ju do të na jepni gjatë plotësimit të këtij pyetësori do të jetë konfidencial, duke garantuar privatësinë tuaj.

### PËR ANKETUESIN: SHËNO TË DHËNAT E INTERVISTËS

Anketues	Intervista nr.	Bashkia	Njësia administrative

### SEKSIONI 1: FAKTORËT SOCIO-EKONOMIKË

1. Duke pasur parasysh komunitetin ku jetoni, sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? *Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD.*

POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
a) Në përgjithësi, qytetarët e mirëarsimuar në zonën ku banoj kanë siguruar vende të mira pune.	1	2	3	4	88	99	
b) Burimi kryesor i të ardhurave për të rinjtë në zonën ku banoj është puna e ndershme.	1	2	3	4	88	99	



POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
c) Në zonën ku banoj, nepotizmi po e bën të vështirë gjetjen e mundësive të mira të punës.	1	2	3	4	88	99	
d) Në zonën ku banoj, institucionet shtetërore të ndihmës sociale dhe ekonomike punojnë në mënyrë profesionale, me drejtësi dhe pa abuzime.	1	2	3	4	88	99	
e) Mjaft të rinj kanë rënë pre e veseve (kumarit, alkoolit, drogës etj.) dhe/ose sjelljeve të rrezikshme (dhunës, veprime vandale, etj.)	1	2	3	4	88	99	
f) Për një jetesë më të mirë do të justifikoja çdo lloj aktiviteti ekonomik, qoftë edhe të paligjshëm.	1	2	3	4	88	99	
g) Pasurimi i shpejtë nuk është i gabuar, pavarësisht se si arrihet.	1	2	3	4	88	99	

**2. Sipas mendimit tuaj, a mund të cilësohen veprimet e mëposhtme si ekstremizëm i dhunshëm? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5, ku 1= ASNJËHERË dhe 5= GJITHMONË.**

POHIMI	Asnjëherë	Rrallëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë	Gjithmonë	Nuk e di
a) Pjesëmarrja në një protestë paqësore për arsye politike, fetare ose ideologjike	1	2	3	4	5	99
b) Bërja e komenteve poshtëruese për dikë për arsye politike, fetare ose ideologjike	1	2	3	4	5	99
c) Përfshirja në një akt kriminal për arsye politike, fetare ose ideologjike	1	2	3	4	5	99



POHIMI	Asnjëherë	Rrallëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë	Gjithmonë	Nuk e di
d) Shpërndarja ose pëlqimi i materialeve që promovojnë përdorimin e dhunës për arsye politike, fetare ose ideologjike	1	2	3	4	5	99
e) Sulm verbal ndaj një individi ose grupi për arsye politike, fetare ose ideologjike	1	2	3	4	5	99
f) Kërcënim fizik ndaj një individi ose grupi për arsye politike, fetare ose ideologjike	1	2	3	4	5	99

**3. 3. Deri në ç'masë jeni të shqetësuar për “.....” në Shqipëri? Ju lutem, përdorni një shkallë nga 1 (aspak i shqetësuar) deri në 4 (shumë i shqetësuar).**

	Aspak i shqetësuar	Shumë i shqetësuar	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di		
a) Ekstremizmin politik (përhapja e pikëpamjeve radikale të individëve ose grupeve që janë të gatshëm të përdorin dhunën ose mjete të tjera të paligjshme për të arritur qëllimet e tyre politike)	1	2	3	4	88	99
b) Ekstremizmin etno-nacionalist (përhapja e pikëpamjeve radikale të individëve ose grupeve që janë të gatshëm të përdorin dhunën ose mjete të tjera të paligjshme për të promovuar interesat e grupit të tyre etnik.)	1	2	3	4	88	99



	Aspak i shqetësuar				Shumë i shqetësuar				Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
c) Ekstremizmin fetar (përhapja e pikëpamjeve radikale të individëve ose grupeve që besojnë në epërsinë e fesë së tyre dhe janë të gatshëm të përdorin dhunën ose mjete të tjera të paligjshme për të arritur qëllimet e tyre fetare.)	1	2	3	4	1	2	3	4	88	99

4. Cila nga pasojat e mundshme të ekstremizmit të dhunshëm është më shqetësuesja në rastin e Shqipërisë:

Kërcënon jetën e qytetarëve	1
Cenon sigurinë kombëtare	2
Të drejtat dhe liritë e qytetarëve	3
Dhuna për motive politike	4
Dëmton ekonominë	5
Nxit urrejtje dhe mosbesim në shoqëri	6
Cenon imazhin e Shqipërisë	7
Marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet fqinje	8
Ekstremizmi i dhunshëm nuk është shqetësues	9
Tjetër (lutemi specifikoni: _____)	10
Nuk e di	88
Refuzim	99

5. 5. Në zonën ku unë banoj, ka individë ose grupe që nxisin” .....” Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD.

	Aspak dakord				Plotësisht dakord				Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
a) Ekstremizmin politik	1	2	3	4	1	2	3	4	88	99
b) Ekstremizmin etno-nacionalist	1	2	3	4	1	2	3	4	88	99



c) Ekstremizmin fetar	1	2	3	4	88	99
-----------------------	---	---	---	---	----	----

**5.1 Nëse zgjodhët (Dakord-3; ose Plotësisht dakord-4) për secilën nga format e ekstremizmit, ju lutem specifikoni çfarë sjelljesh, veprimesh apo qëndrimesh ekstremiste keni vënë re në zonën ku ju banoni.**

a) Ekstremizmi politik:

-----

b) Ekstremizmi etno-nacionalist: -----

-----

c) Ekstremizmi fetar: -----

-----

**6. Sipas përvojës tuaj, sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD**

POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
a. Në komunitetin ku banoj ka grupe fetare që u ofrojnë të mira materiale ose ekonomike praktikantëve të fesë së tyre.	1	2	3	4	88	99	
b. Personat e të njëjtit besim fetar si unë përfitojnë më pak nga mundësitë për zhvillim ekonomik dhe social pikërisht për shkak të besimit fetar.	1	2	3	4	88	99	
c. Mjekra e gjatë (për burrat) ose shamia (për gratë) tregojnë se kemi të bëjmë me ekstremistë fetarë.	1	2	3	4	88	99	
d. Komuniteti fetar të cilit i përkas është i përfaqësuar sa duhet në politikë dhe institucione shtetërore.	1	2	3	4	88	99	



## SEKSIONI 2: FAKTORËT (NDËR)SHTETËRORË / POLITIKË

7. Deri në ç'masë pohimet e mëposhtme reflektojnë qëndrimet tuaja? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!

POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
a) Përgjithësisht, të drejtat dhe liritë e qytetarit respektohen nga institucionet shtetërore.	1	2	3	4	88	99	
b) Në zonën ku banoj vërehet më shumë prezenca e shtetit si forcë ligjzbatuese sesa si ofrues i shërbimeve për qytetarët.	1	2	3	4	88	99	
c) Pandëshkueshmërisë së njerëzve me pozita të larta në Shqipëri gjithnjë e më shumë po i vjen fundi.	1	2	3	4	88	99	
d) Sistemi politik në Shqipëri është i padrejtë dhe duhet ndryshuar, madje edhe me dhunë po qe nevoja.	1	2	3	4	88	99	
e) Opozita politike në Shqipëri ofron alternativa dhe shpresë për më shumë mirëqeverisje.	1	2	3	4	88	99	
f) Disa anëtarë të elitës politike kanë lidhje me kriminelë dhe u shërbejnë interesave të njëritjetrit.	1	2	3	4	88	99	
g) Aktorë qeverisës në Shqipëri keqpërdorin institucionet dhe burimet shtetërore për interesa të ngushta politike.	1	2	3	4	88	99	
h) Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë vetëgjyqësi kur u mohohen liritë e të drejtat nga institucionet shtetërore.	1	2	3	4	88	99	
i) Institucionet ligjzbatuese (policia, gjykata, prokuroria) janë më të ashpra me besimtarët praktikantë myslimanë.	1	2	3	4	88	99	



**8. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!**

POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
a) Përfshirja ose nxitja e përfshirjes së civilëve në konflikte të armatosura jashtë kufijve të vendit nuk duhet lejuar.	1	2	3	4	1	88	99
b) Përfshirjet e Shqipërisë në misionet ushtarake në Afganistan e Irak kanë qenë një fyerje për myslimanët.	1	2	3	4	1	88	99
c) Çdo qytetar duhet të mbrojë ideologjinë e vet me çdo mjet dhe çmim.	1	2	3	4	1	88	99
d) Është detyrë e çdo besimtari të mbrojë vlerat dhe dinjitetin e vet fetar me çdo mjet dhe çmim.	1	2	3	4	1	88	99
e) Një besimtar i denjë nuk duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij që kanë bindje ekstremiste fetare.	1	2	3	4	1	88	99
f) Vendet me besim të fortë fetar kanë qeveri më pak të korruptuara.	1	2	3	4	1	88	99
g) Nëse më shumë njerëz do ishin besimtarë të fesë sime, në Shqipëri do kishte më shumë drejtësi.	1	2	3	4	1	88	99
h) Aktivitetet fetare nuk duhet të mbikëqyren nga shteti.	1	2	3	4	1	88	99



**9. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!**

POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
a) Strukturat politike dhe ekonomike globale (p.sh. OKB, FMN etj.) janë shpikje të Perëndimit për të sunduar vendet Islame.	1	2	3	4		88	99
b) Vendet me shumicë të krishterë në Ballkan kanë pasur më shumë mbështetje nga Perëndimi pikërisht për shkak të përkatësisë fetare.	1	2	3	4		88	99
c) Bashkimi Evropian ka qenë i padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut).	1	2	3	4		88	99
d) SHBA ka qenë e padrejtë me vendet e Ballkanit që kanë një popullsi të konsiderueshme myslimane (si Shqipëria, Kosova, Bosnja dhe Hercegovina & Maqedonia e Veriut).	1	2	3	4		88	99

### SEKSIONI 3: PRAKTIKIMI I FESË NË SHQIPËRI

**10. Ju personalisht do ta mbështesnit një anëtar të familjes tuaj (motra/vëllezër ose fëmijët tuaj) po të martohej me një person të një besimi tjetër fetar?**

Patjetër që po	1
Do ta pranoja por nuk do ta mbështesja / inkurajoja	2
Do ta kundërshtoja në çdo rast	3
Do ta kundërshtoja n.q.s. personi me të cilin/ën martohet është besimtar praktikant	4
Nuk jam i/e sigurt	5
Refuzim	99



**11. Ju personalisht do ta mbështesnit një anëtar të familjes tuaj (motra/vëllezër ose fëmijët tuaj) po të martohej me një person të një përkatësie tjetër etnike?**

Patjetër që po	1
Do ta pranoja por nuk do ta mbështesja / inkurajoja	2
Do ta kundërshtoja në çdo rast	3
Nuk jam i/e sigurt	4
Refuzim	99

**12. 12. Deri në ç'masë jeni dakord me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!**

POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
a) Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i fesë Islame.	1	2	3	4	88	99	
b) Sot në Shqipëri është e vështirë të jesh besimtar praktikant i krishterë.	1	2	3	4	88	99	
c) Besimtarët myslimanë në Shqipëri përballen me ndikime të huaja të Islamit konservator.	1	2	3	4	88	99	
d) Besimi, traditat dhe dinjiteti i komunitetit tim fetar në përgjithësi janë nën presion dhe kërcënim të vazhdueshëm.	1	2	3	4	88	99	

**13. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!**

POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
a) Qëndrimet e kreut të komunitetit tim fetar (në Tiranë) gëzojnë mbështetjen e plotë të besimtarëve të zonës ku jetoj.	1	2	3	4	88	99	
b) Kleriku i komunitetit fetar në zonën ku jetoj ka ndikim të lartë tek besimtarët.	1	2	3	4	88	99	





POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
c) Në komunitetin tim fetar ka klerikë pa arsimin / formimin e duhur fetar.	1	2	3	4		88	99
d) Njerëzit kanë të drejtë të ndjekin interpretime fetare jozyrtare nëse nuk pajtohen me bashkësitë përkatëse fetare.	1	2	3	4		88	99

#### SEKSIONI 4.

14. Sa dakord jeni me pohimet e mëposhtme? *Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 4 ku 1 – ASPAK DAKORD dhe 4 – PLOTËSISHT DAKORD!*

POHIMI	Aspak dakord				Plotësisht dakord	Jo relevante / S'ka lidhje	Nuk e di
a) Ka një komplot të madh për të shpopulluar Shqipërinë dhe për të zëvendësuar qytetarët e saj me emigrantë të huaj.	1	2	3	4		88	99
b) Shqiptarët nuk duhet të përzihen me raca të tjera.	1	2	3	4		88	99
c) Në zonën ku unë banoj, të qenurit minoritar sjell përfitime të shumta sociale dhe ekonomike.	1	2	3	4		88	99
d) Në zonën ku unë banoj, votimi për parti në pushtet është i domosdoshëm për të mbajtur një vend pune në administratën publike.	1	2	3	4		88	99
e) Në zonën ku unë banoj ka politikanë që shprehimisht bëjnë thirrje për dhunë ndaj kundërshtarëve politike.	1	2	3	4		88	99

15. Gjatë 12 muajve të fundit, a keni qenë dëshmitar i ndonjë forme të hapur diskriminimi



## apo gjuhë urrejtjeje ndaj një individi?

Po	VIJONI NË PYETJEN 16.1	1
Jo	VIJONI NË SEKSIONIN TJETËR	2
Nuk e di	VIJONI NË SEKSIONIN TJETËR	3
Refuzoj të përgjigjem	VIJONI NË SEKSIONIN TJETËR	99

15.1 Nëse u përgjigjët me “po”, lutemi të specifikoni ndaj cilit grupi shoqëror drejtoheshin akte të tilla diskriminuese?

## SEKSIONI 5. DEMOGRAFIA

## 16. Shëno gjininë e të anketuarit:

Mashkull	1
Femër	2
Tjetër	3

## 17. Mosha \_\_\_\_\_ (në vite)

## 18. Mosha \_\_\_\_\_ (në vite)

Pa arsim / Më pak se arsimi fillor (8/9 vjeçar)	1
Arsim fillor 8/9 vjeçar	2
Arsim i mesëm	3
Arsim i lartë	4
Arsim pasuniversitar	5
Refuzim	99

## 19. A jeni simpatizant i ndonjë grupimi politik?

Jo, nuk jam simpatizant	1
Po (Partia Socialiste)	2
Po (Partia Demokratike)	3
Po (PD Grupi i Rithemlimit)	4
Po (Partia e Lirisë)	5



Po (Tjetër) Specifiko _____	6
Refuzim	99

## 20. Statusi i punësimit

I/E Punësuar	1
I/E Vetëpunësuar	2
I/E Papunë	3
Student/e	4
Tjetër _____	5
Refuzim	99

## 21. Cila është përkatësia fetare e familjes suaj të origjinës?

Myslimane	1
Ortodokse	2
Katolike	3
Bektashi	4
Evangjelist	5
E përzier	6
Tjetër _____	7
Nuk e di/ Nuk jam i/e sigurt	88
Refuzim	99

## 22. Cilit besimi fetar i përkisni ju personalisht?

Mysliman	1
Ortodoks	2
Katolik	3
Bektashi	4
Evangjelist	5
Agnostik	6
Ateist	7
Tjetër (specifikoni: _____)	8
Refuzim	99

## 23. A jeni praktikant/e i/e rregullt i/e fesë?

PO – I praktikoj rregullisht ritet dhe rregullat fetare	1
Kryesisht PO – Praktikoj ritet kryesore fetare	2



JO – Jam besimtar por nuk i praktikoj fare rregullat dhe ritet fetare PYETËSORI	PËRFUNDON	3
JO, jam ateist	PËRFUNDON PYETËSORI	4
Tjetër (lutemi specifikoni:_____)		5
Refuzim	PËRFUNDON PYETËSORI	99

#### 24.Mund të më thoni sa shpesh luteni / faleni

Rregullisht (çdo ditë / javë)	1
Në festa fetare përgjatë vitit	2
Vetëm me raste, në ngjarje të veçanta fetare	3
Vetëm me raste, në kohë të vështira personale /familjare	4
Asnjëherë	5
Refuzim	99

JU FALEMINDERIT!



